



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 37

**Tiranë – E hënë, 16 shkurt 2026**

## PËRMBAJTJA

|                                                            | Faqe                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         |
|------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Ligj nr. 12/2026,<br>datë 28.1.2026                        | Për lobimin në Republikën e Shqipërisë..... 2847                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |
| Dekret i Presidentit<br>nr. 69, datë 12.2.2026             | Për shpallje ligji..... 2856                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Ligj nr. 13/2026,<br>datë 28.1.2026                        | Për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve..... 2856                                                                                                                                                                                                                                     |
| Dekret i Presidentit<br>nr. 55, datë 11.2.2026             | Për shpallje ligji..... 2880                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 97, datë 11.2.2026 | Për miratimin e marrëveshjes së grantit shoqërues ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) (agjencia e zbatimit të projektit) dhe <i>KfW, Frankfurt am Main (KfW)</i> , masat shoqëruese për projektin “Rehabilitimi i hidrocentralit të Fierzës”..... 2880 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave<br>nr. 98, datë 11.2.2026 | Për miratimin e marrëveshjes së grantit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) (agjencia e zbatimit të projektit), dhe <i>KfW, Frankfurt am Main (KfW)</i> , për financimin e projektit “Rehabilitimi i hidrocentralit të Fierzës”..... 2889 |





**LIGJ**  
**Nr. 12/2026**

**PËR LOBIMIN NË REPUBLIKËN**  
**E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**KREU I**  
**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Objekti**

Ky ligj rregullon mënyrën dhe kushtet për ushtrimin e veprimtarisë së lobimit, si dhe organizimin, regjistrimin dhe mbikëqyrjen e tij, me qëllim sigurimin e transparencës, integritetit dhe përgjegjshmërisë gjatë zhvillimit të kësaj veprimtarie.

**Neni 2**  
**Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është sigurimi i transparencës, integritetit dhe llogaridhënies në proceset e vendimmarrjes publike, duke rregulluar ushtrimin e aktiviteteve të lobimit pranë institucioneve publike të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 3**  
**Fusha e veprimit**

1. Ky ligj zbatohet për përfshirjen në veprimtari lobimi të:

- a) anëtarëve të Kuvendit gjatë ushtrimit të veprimtarisë legislative;
- b) anëtarëve të Këshillit të Ministrave dhe funksionarëve politikë pranë tyre;
- c) zyrtarëve të lartë dhe nëpunësve të organeve publike që ushtrojnë funksione vendimmarrëse;
- ç) funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar në nivel vendor, si dhe punonjësve të njëjësive të

vetëqeverisjes vendore që ushtrojnë funksione vendimmarrëse.

2. Zyrtarët e përfshirë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe në Forcat e Armatosura ndalohen të përfshihen në veprimtari lobimi, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

**Neni 4**  
**Përkufizime**

Në kuptim të këtij ligji, me termat e mëposhtëm nënkuptohet:

1. “Autoriteti përgjegjës” është Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMP), i caktuar për të regjistruar, mbikëqyrur dhe kontrolluar ushtrimin e veprimtarisë së lobimit, si dhe për të garantuar zbatimin e rregullave për transparencën dhe integritetin në proceset e lobimit.

2. “Lobim” është ushtrimi ose përpjekja për të ushtruar ndikim në proceset e vendimmarrjes publike përmes çdo forme komunikimi, iniciative apo çdo aktiviteti tjetër të ndërmarrë me synimin për të ndikuar në hartimin, ndryshimin, zbatimin ose shfuqizimin e politikave, legjislacionit ose vendimeve administrative nga persona fizikë ose juridikë që përfaqësojnë interesa të caktuara.

3. “Lobist” është çdo person fizik i regjistruar si lobist, si dhe çdo person juridik që ushtron veprimtari lobimi përmes një lobisti të regjistruar, i cili kundrejt shpërblimit ose në interes të drejtpërdrejtë zhvillon veprimtari me qëllim ndikimin në hartimin, miratimin, ndryshimin ose zbatimin e legjislacionit, politikave publike ose vendimmarrjeve administrative përmes komunikimit me zyrtarë publikë.

4. “Marrëdhënie e strukturuar lobimi” është çdo raport i formalizuar ndërmjet një lobisti dhe përfituesit të lobimit, i cili bazohet në një kontratë lobimi sipas këtij ligji dhe parashikon zhvillimin e veprimtarive të organizuara, të përsëritura ose të planifikuara të lobimit kundrejt shpërblimit ose interesit të drejtpërdrejtë.

5. “Përfitues i lobimit” është çdo person fizik ose juridik privat, përfshirë organizatat jofitimprurëse, në emër të të cilit ushtrohet veprimtari lobimi nga një lobist i regjistruar.

6. “Vendimmarrje publike” është çdo proces ligjvënës, politikëbërës, rregullator ose administrativ, i ndërmarrë nga autoritetet publike në nivel qendror



ose vendor, institucionet e pavarura dhe agjencitë autonome, që ka për qëllim miratimin, ndryshimin, zbatimin ose shfuqizimin e ligjeve, akteve nënligjore, politikave publike apo vendimeve që ndikojnë në interesin publik.

7. “Zyrtari publik” është çdo person i zgjedhur, i emëruar, nëpunës civil që ka kompetenca vendimmarrëse në organet ligjvënëse, ekzekutive ose administrative, në nivel qendror ose vendor.

## KREU II KUSHTET PËR USHTRIMIN E LOBIMIT DHE KRITERET NDALUESE

Neni 5

### Kushtet dhe kriteret detyruese për ushtrimin e veprimtarisë së lobimit

1. Veprimtaria e lobimit ushtrohet nga personi fizik ose juridik, i cili plotëson kushtet si më poshtë dhe është i regjistruar në Regjistrin e Lobimit, në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

2. Nuk mund të ushtrojnë asnjëherë veprimtari lobimi personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale, sipas neneve 73, 74, 75, 76, 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b dhe 79/c, 86, 87, 88 paragrafi i dytë, 89/a, 100, 101, 102, 102/a, 103, 104, 105, 106, 109, 109/b, 109/c, 110/a, 111, 114, 128/b, 135, 136, 140, 141, 143/a, 215, 216, 217, 218, 219, 220, 221, 222, 230, 230/a, 230/b, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 278, paragrafi i parë, i pestë e i gjashtë, 278/a, 282/a, 283, 283/a, 284/a, 287 i lidhur me kryerjen e një krimi të parashikuar në këtë paragraf, 333, 333/a e 334 të Kodit Penal.

3. Ndalohen të ushtrojnë veprimtari lobuese për 5 vjet personat të cilët janë dënuar me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për kryerjen e veprimeve apo mosveprimeve që përbëjnë vepër penale sipas neneve 110/a, 110/b, 110/c, 165, 244, 245, 248, 248/a, 259, 260, 319, 319/ç, apo në fushën e zgjedhjeve, të parashikuar në kreun X, “Vepra penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve”, të Kodit Penal. Të dënuarit me burgim me vendim të formës së prerë, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për çdo vepër tjetër penale të pacituar më

sipër ndalohen të ushtrojnë veprimtari lobuese sipas afateve të rehabilitimit, të përcaktuara në Kodin Penal

4. Detyrimi për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së lobimit zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrimi, drejtues ose mbikëqyrës i tij, aksionar ose ortak, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese ndaj tij.

5. Çdo person fizik ose juridik ndalohet të ushtrojë veprimtari lobimi për një periudhë prej 3 vjetësh kur nuk ka përmbushur detyrimin për pagimin e detyrimeve tatimore, si dhe të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, me përjashtim të rasteve kur:

a) ndodhet në një proces gjyqësor që ka për objekt detyrimet tatimore ose kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe nuk ka një vendim gjyqësor ose administrativ të formës së prerë sipas legjislacionit në fuqi;

b) i ka përmbushur detyrimet e tij duke paguar ose duke lidhur një marrëveshje të pagesës me këste me administratën tatimore, sipas parashikimeve të ligjit për procedurat tatimore, duke përfshirë, aty ku është e zbatueshme, çdo kamatëvonesë ose gjobë. Në çdo rast, marrëveshja detyruese me qëllim pagimin e detyrimeve tatimore duhet të jetë e nënshkruar përpara datës së shpalljes së procedurës së prokurimit.

c) nuk ka paguar detyrimet tatimore, si dhe kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore deri në vlerën 1 000 lekë.

Afati i ndalimit për ushtrimin e veprimtarisë së lobimit fillon nga data në të cilën është shlyer detyrimi për pagesën e taksave ose të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

6. Nuk mund të ushtrojë veprimtari lobimi personi juridik që:

a) është në proces falimentimi ose likuidimi;

b) ka asete të administruara sipas ligjit nr. 110/2016 “Për falimentimin”;

c) ka pezulluar veprimtarinë tregtare;

ç) ka fonde apo pasuri të konfiskuara sipas legjislacionit në fuqi;

d) është në listën e personave dhe entiteteve të shpallura për sa parashikohet në ligjin për masat kundër financimit të terrorizmit dhe ligjin për masat shtrënguese ndërkombëtare.



7. Nuk mund të ushtrojë veprimtari lobimi çdo person fizik ose juridik kur:

a) ka ushtruar veprimtari lobimi përpara regjistrimit në Regjistrin e Lobimit dhe nuk ka marrë masa për korrigjimin e kësaj shkeljeje sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë pune;

b) nuk ka përmbushur detyrimet për raportim dhe deklarim sipas nenit 18 të këtij ligji, pasi Regjistri i Lobimit është krijuar dhe vënë në funksion në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

#### Neni 6

#### **Veprimtari që nuk konsiderohen lobim**

1. Nuk konsiderohen veprimtari lobimi në kuptim të këtij ligji:

a) ushtrimi i lirive dhe të drejtave themelore demokratike nga individët, përfshirë të drejtën për informim, paraqitjen e kërkesave, rekomandimeve, peticioneve ose qëndrimeve publike, për sa kohë që këto veprimtari nuk zhvillohen përmes lobimit.

b) pjesëmarrja e hapur dhe transparente në proceset e konsultimit publik, dëgjesat publike apo takimet e organizuara nga institucionet shtetërore në zbatim të legjislacionit për njoftimin dhe konsultimin publik.

c) aktivitetet edukative, kërkimore, akademike ose analitike të zhvilluara në mënyrë të pavarur dhe për qëllime informuese, që nuk synojnë ndikim të drejtpërdrejtë në vendimmarrje përmes veprimtarisë së lobimit.

ç) komunikimi ndërmjet institucioneve publike, organeve të administratës publike ose përfaqësuesve të tyre gjatë ushtrimit të funksioneve dhe kompetencave të tyre ligjore.

d) komunikimet ose veprimtaritë e kryera nga partitë politike gjatë ushtrimit të funksioneve dhe të drejtave të tyre të përcaktuara me ligj.

dh) komunikimet e detyrueshme ose periodike të subjekteve të mbikëqyrura me autoritetet rregullatore dhe mbikëqyrëse, të kryera në zbatim të legjislacionit sektorial.

e) publikimet, shkrimet ose opinionet e botuara në media, si dhe shprehjet publike në rrjete sociale ose në aktivitete publike për sa kohë që nuk zhvillohen në kuadër të veprimtarisë së lobimit.

ë) veprimtaritë e zhvilluara në kuadër të procedurave administrative apo gjyqësore, përfshirë përfaqësimin ligjor ose procedural të palëve.

f) deklaratat dhe qëndrimet publike të organizatave jofitimprurëse për çështje që lidhen drejtpërdrejt me misionin e tyre statutor dhe janë pjesë e fushës së tyre të veprimtarisë dhe ekspertizës nuk konsiderohen veprimtari lobimi për sa kohë që organizata nuk vepron kundrejt pagesës për të përfaqësuar interesa private të një pale të tretë.

2. Veprimtaritë e parashikuara në pikën 1 të këtij neni nuk përjashtojnë zbatimin e këtij ligji kur ato kryhen me qëllim të ushtrimit të ndikimit në vendimmarrjen publike në kuadër të marrëdhënieve të strukturuar të lobimit, pa paragjykuar të drejtat e garantuara në legjislacionin për pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje.

#### KREU III

#### **KOMPETENCAT DHE ORGANIZIMI I AUTORITETIT MBIKËQYRËS**

#### Neni 7

#### **Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale**

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale është autoriteti kompetent për zbatimin e këtij ligji dhe ushtron këto funksione:

a) administron dhe publikon në kohë reale të dhënat në Regjistrin e Lobimit;

b) shqyrton dhe vendos për aplikimet për regjistrim të lobistëve në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë ligj;

c) mbikëqyr zbatimin e detyrimeve ligjore nga lobistët, përfituesit e lobimit dhe zyrtarët publikë;

ç) verifikon saktësinë e të dhënave dhe raporteve të dorëzuara përmes kontrolleve dhe hetimeve administrative;

d) vendos dhe, sipas rastit, zbaton masat administrative dhe ndëshkimet e parashikuara në këtë ligj;

dh) harton dhe miraton Kodin e Sjelljes për Lobistët dhe monitoron zbatimin e tij;

e) zhvillon dhe koordinon aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere për lobistët, zyrtarët publikë dhe publikun e gjerë, me qëllim rritjen e njohurive për rregullat e lobimit, detyrimet ligjore dhe masat për parandalimin e ndikimeve të papërshtatshme;

ë) krijon strukturën përgjegjëse për mbikëqyrjen, kontrollin dhe verifikimin e veprimtarive të lobimit,



si dhe zbatimin e detyrimeve të parashikuara në këtë ligj.

f) bashkëpunon me autoritetet kompetente, përfshirë autoritetet tatimore, autoritetin përgjegjës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe organet e tjera rregullatore, duke iu përcjellë rastet kur gjatë ushtrimit të kompetencave të tij lind dyshimi për shkelje të legjislacionit përkatës.

2. Autoritetet publike dhe institucionet e përfshira në procese vendimmarrëse janë të detyruara të bashkëpunojnë me KDIMDP-në për organizimin dhe zhvillimin e aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjëse, si dhe të sigurojnë pjesëmarrjen e punonjësve të tyre në këto veprimtari.

3. Format, temat dhe periudhat e zhvillimit të aktiviteteve informuese dhe ndërgjegjëse përcaktohen me urdhër të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke garantuar zhvillimin e tyre jo më pak se një herë në vit.

4. KDIMDP-ja përgatit dhe paraqet çdo vit në Kuvend një raport vjetor për veprimtarinë e tij, gjendjen e lobimit në vend dhe rekomandimet për përmirësim.

#### KREU IV REGJISTRIMI DHE ÇREGJISTRIMI NGA REGJISTRI I LOBIMIT

##### Neni 8 Regjistri i Lobimit

1. Regjistri i Lobimit mbahet dhe administrohet nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si autoriteti përgjegjës për monitorimin e veprimtarisë së lobimit dhe përbën një bazë të dhënash elektronike publike. Regjistri i Lobimit publikohet në faqen zyrtare të Komisionerit dhe është i aksesueshëm nga çdo person në përputhje me parimet e transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

2. Të dhënat në Regjistrin e Lobimit përditësohen rregullisht dhe jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e depozitimit të dokumentacionit përkatës pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

3. Regjistri përmban këto të dhëna:

a) emrin, mbiemrin dhe adresën e ushtrimit të veprimtarisë profesionale të personit fizik që

ushtron veprimtari lobimi ose emrin, selinë dhe numrin unik të identifikimit (NUIS) të personit juridik;

b) përfaqësuesin ligjor dhe në rastin e personit juridik personat e punësuar si lobistë;

c) fushën dhe tematikën e lobimit;

ç) përfituesin ose subjektin në emër të të cilit ushtrohet veprimtaria lobuese;

d) institucionet publike ose kategoritë e zyrtarëve publikë me të cilët janë vendosur kontakte lobimi;

dh) statusin aktual në regjistrë;

e) raportimet e zyrtarëve publikë për kontaktet e zhvilluara me lobistë.

4. Struktura, mënyra e administrimit, si dhe procedurat për përditësimin dhe publikimin e të dhënave në Regjistrin e Lobimit përcaktohen me udhëzim të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

##### Neni 9 Kërkesa për regjistrim

1. Çdo person fizik ose juridik, që kërkon të ushtrojë veprimtari lobimi, paraqet kërkesë për regjistrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në rrugë zyrtare, nëpërmjet formës elektronike ose shërbimit postar.

2. Kërkesa për regjistrim shoqërohet me:

a) të dhënat identifikuese të aplikantit;

b) vetëdeklarim të aplikantit për mungesën e ndalimeve sipas nenit 5 të këtij ligji;

c) përshkrim të fushës dhe temave kryesore në të cilat do të ushtrohet veprimtaria e lobimit.

3. Në rastin e personit juridik, kërkesa shoqërohet edhe me:

a) ekstraktin aktual të regjistrimit të personit juridik;

b) të dhënat identifikuese të përfaqësuesit ligjor dhe të personave të autorizuar që kryejnë veprimtari lobimi;

c) vetëdeklarim të përfaqësuesit ligjor për mungesën e ndalimeve ligjore.

4. Komisioneri e shqyrton kërkesën për regjistrim brenda 20 ditëve punë nga data e paraqitjes së saj. Brenda 5 ditëve punë nga marrja e kërkesës, nëse është e nevojshme, Komisioneri kërkon plotësim të dokumentacionit. Subjekti e plotëson dokumentacionin brenda 10 ditëve punë



nga marrja e njoftimit. Afati i shqyrtimit pezullohet deri në dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar.

5. Pas shqyrtimit, Komisioneri merr vendim për:

a) regjistrimin e kërkuarit në Regjistrin e Lobimit; ose

b) refuzimin e kërkesës kur konstatohet mosplotësimi i kushteve ligjore.

6. Vendimi për regjistrim publikohet në faqen zyrtare të Komisionerit. Vendimi për refuzim i komunikohet kërkuarit dhe arsyetohet në përputhje me legjislacionin procedural.

7. Format i dhe përmbajtja e kërkesës për regjistrim, si dhe mënyra e paraqitjes dhe shqyrtimit të saj përcaktohen me udhëzim të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, të nxjerrë në zbatim të këtij ligji.

#### Neni 10

##### Refuzimi i regjistrimit

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale e refuzon kërkesën për regjistrim në Regjistrin e Lobimit në rastet kur:

a) konstatohet ekzistenca e të paktën njërit prej kriterëve ndaluesë të përcaktuara në nenin 5 të këtij ligji;

b) kërkuari ka paraqitur të dhëna ose dokumente të pavërteta ose të pasakta;

c) për kërkuarin nuk ka përfunduar afati i ndalimit për ushtrimin e veprimtarisë së lobimit, sipas përcaktimeve të nenit 5 të këtij ligji;

ç) kërkuari nuk respekton afatin prej 10 ditësh për plotësimin e dokumenteve sipas pikës 4 të nenit 9 të këtij ligji.

2. Vendimi për refuzim duhet të jetë i arsyetuar dhe t'i komunikohet aplikantit sipas afateve të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji.

3. Kundër vendimit të refuzimit të regjistrimit, kërkuari ka të drejtë të paraqesë ankim administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale brenda 30 ditëve nga momenti i njoftimit.

4. Ankimi administrativ shqyrtohet nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në përputhje me procedurat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

#### Neni 11

##### Çregjistrimi nga regjistri

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale vendos çregjistrimin nga regjistri për lobimin në këto raste:

a) me kërkesë të lobistit;

b) kur ka vdekur personi fizik ose kur ka humbur zotësinë juridike për të vepruar;

c) kur personi juridik ka mbaruar ose ka nisur procedurat e falimentimit;

ç) kur nuk është bërë korrigjimi i të dhënave të pasakta pas kalimit të afatit të parashikuar në nenin 22 të këtij ligji;

d) kur lobisti ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 5 të ligjit;

dh) kur zbulohen të dhëna se lobisti ka ushtruar aktivitet lobimi pa qenë me parë i regjistruar;

e) në çdo rast tjetër të parashikuar në nenin 24 të këtij ligji.

2. Vendimi për çregjistrimin nga regjistri publikohet në faqen zyrtare të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale brenda 7 (shtatë) ditëve punë nga miratimi.

3. Subjekti ndaj të cilit është marrë vendimi për çregjistrim mund të paraqesë një kërkesë të re për regjistrim vetëm pas kalimit të një periudhe një 1-vjeçare nga data e çregjistrimit.

4. Në rastet kur çregjistrimi bëhet me kërkesë të vetë lobistit, reregjistrimi mund të bëhet menjëherë, pa periudhë pritjeje.

5. Kundër vendimit për çregjistrimin nga regjistri, lobisti ka të drejtë të paraqesë ankim administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale brenda 30 ditëve nga njoftimi. Ankimi administrativ shqyrtohet në përputhje me procedurat e përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative.

#### KREU V

##### KRYERJA E VEPRIMTARISË SË LOBIMIT, TË DREJTAT DHE DETYRIMET E LOBISTIT

#### Neni 12

##### Kontrata për lobim

1. Lobisti nuk mund të ushtrojë veprimtari lobimi pa lidhur më parë një kontratë me shkrim me



përfituesin e lobimit, përveç rasteve kur veprimtaria zhvillohet për interesa të tij të drejtpërdrejta. Lobisti njofton Komisionerin për lidhjen e kontratës brenda 15 ditëve punë nga data e lidhjes nëpërmjet paraqitjes së të dhënave kryesore të kontratës.

2. Të dhënat kryesore që paraqiten pranë Komisionerit përfshijnë:

- a) të dhënat identifikuese të palëve;
- b) objektin dhe qëllimin e veprimtarisë së lobimit;
- c) afatin e kontratës;
- ç) vlerën e përgjithshme të shpërblimit ose intervalin buxhetor;
- d) deklaratën e lobistit për mungesën e konfliktit të interesit.

3. Komisioneri mund të kërkojë kopjen e plotë të kontratës, si dhe informacion shtesë vetëm kur është e nevojshme për qëllime verifikimi, kontrolli apo hetimi administrativ, sipas këtij ligji.

4. Të dhënat e parashikuara në pikën 2 të këtij neni publikohen në Regjistrin e Lobimit në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Çdo ndryshim ose ndërprerje e kontratës njoftohet pranë Komisionerit brenda 7 ditëve punë, duke përditësuar të dhënat kryesore të kontratës.

#### Neni 13

##### Informacioni për përfituesin e lobimit

1. Lobisti që ushtron veprimtari lobimi është i detyruar të paraqesë pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale brenda 30 ditëve nga data e lidhjes së kontratës së lobimit informacion, për:

- a) të dhënat identifikuese të përfituesit të lobistit;
- b) burimet financiare të planifikuara për veprimtarinë e lobimit;
- c) deklaratë për mungesën e konfliktit të interesit;
- ç) vetëdeklarimin e përfituesit se nuk është i dënuar për vepra penale të parashikuara në pikën 1 të nenit 5 të këtij ligji.

2. Çdo ndryshim në kontratë ose në objektin e lobimit duhet të raportohet pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të përditësohet në Regjistrin e Lobimit brenda 30 ditëve nga data e ndryshimit.

3. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale administron informacionin për përfituesin e lobimit në përputhje me parashikimet e këtij ligji dhe e publikon në

Regjistrin e Lobimit në përputhje me ligjin nr. 124/2024, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, sipas përcaktimeve të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji.

#### Neni 14

##### Detyrimi për bashkëpunim dhe përgjegjësia e përfituesit të lobimit

1. Përfituesi i lobimit është i detyruar t’i sigurojë lobistit dokumentacionin dhe informacionin e nevojshëm për përmbushjen e kontratës së lobimit, si dhe të bashkëpunojë me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për qëllime verifikimi dhe kontrolli.

2. Përfituesi i lobimit mban përgjegjësi për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave të dorëzuara pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

3. Në rast të paraqitjes së të dhënave të pasakta ose të pavërteta, përfituesi i lobimit u nënshtrohet masave administrative dhe sanksioneve të parashikuara në këtë ligj.

#### Neni 15

##### Mbledhja dhe përdorimi i informacionit

1. Lobisti e ushtron veprimtarinë e tij/saj në përputhje me parimet e transparencës, integritetit, paanshmërisë dhe mbrojtjes së interesit publik, si dhe në zbatim të këtij ligji dhe Kodit të Sjelljes për Lobistët.

2. Lobisti nuk duhet të mbledhë, të përdorë apo të përhapë informacion të përfituar në mënyrë të paligjshme dhe as të nxisë të tjerët ta sigurojnë një informacion të tillë.

3. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në ushtrim të kompetencave mbikëqyrëse, mund t’i kërkojë lobistit çdo informacion të nevojshëm për verifikimin e zbatimit të këtij ligji.

4. Lobisti mban përgjegjësi administrative dhe civile për dhënien me dashje të informacionit të rremë ose të pasaktë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së lobimit.





## Neni 16

**Të drejtat e lobistit**

1. Çdo lobist ka të drejtën të ushtrojë veprimtarinë e lobimit në përputhje me të drejtat dhe detyrimet e përcaktuara në këtë ligj.

2. Lobisti ka të drejtë:

a) të kërkojë qasje të barabartë dhe transparente në takime me institucione publike sipas rregullave të këtij ligji;

b) të paraqesë ankesa ose të kërkojë rishikim nëse e drejta për të ushtruar veprimtari të ligjshme lobimi i mohohet;

c) të kërkojë nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale udhëzime dhe sqarime për zbatimin e këtij ligji dhe Kodit të Sjelljes për Lobistët.

## Neni 17

**Detyrimet e lobistit**

1. Lobisti është i detyruar:

a) të deklarojë qëllimin e lobimit, fushën, temat dhe subjektin për llogari të të cilit vepron në çdo kontakt me zyrtarin publik;

b) të mos përdorë forma ndikimi të paligjshme ose korruptive, përfshirë dhurata, favore, premtime apo shpërblime të ndaluara;

c) të respektojë Kodin e Sjelljes për Lobistin, rregullat e etikës profesionale dhe transparencës në komunikimin me institucionet publike;

ç) të njoftojë përpara çdo komunikimi zyrtarin publik se është lobist i regjistruar;

d) të dorëzojë raportet periodike sipas afateve të përcaktuara në këtë ligj;

dh) të ruajë dhe të mbajë dokumentacionin për aktivitetet e lobimit për një periudhë jo më pak se 5 (pesë) vjet dhe ta vendosë në dispozicion të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale kur kërkohet;

e) të bashkëpunojë me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale gjatë procedurave të verifikimit ose hetimit administrativ;

ë) të mos përdorë dhe të mos shpërndajë informacione të përfituara në mënyrë të paligjshme, si dhe të respektojë parashikimet në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, për informacionin e klasifikuar dhe sekretin tregtar;

f) të heqë dorë nga ushtrimi i veprimtarisë së lobimit në rastet kur ndodhet në konflikt interesi, si dhe në çdo rast tjetër të parashikuar nga ky ligj për ndalimin ose ndërprerjen e veprimtarisë së lobimit.

2. Në zbatim të pikës 1 të këtij neni, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcakton me udhëzim kategoritë e dokumentacionit që lobisti është i detyruar të ruajë, mënyrën e administrimit dhe afatet përkatëse të ruajtjes së tij.

## Neni 18

**Deklarata e veprimtarisë së lobimit**

1. Lobisti ka detyrimin të paraqesë pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale një deklaratë të veprimtarisë së lobimit çdo 6 (gjashtë) muaj për burimet financiare dhe shumat e shpenzuara për veprimtarinë e lobimit gjatë periudhës përkatëse.

2. Deklarata e veprimtarisë së lobimit përmban të dhëna për:

a) burimet financiare të planifikuara për lobim;

b) vlerën totale të shpenzimeve të realizuara për lobim gjatë periudhës së deklaruar;

c) natyrën dhe qëllimin e veprimtarive të lobimit, si dhe subjektin në emër të të cilit është kryer lobimi;

ç) institucionin publik apo zyrtarin publik me të cilin janë zhvilluar kontakte lobuese;

d) formën dhe datën e kontaktit me zyrtarin publik;

dh) burimin e fondeve të përdorura për lobim dhe çdo mbështetje financiare nga palë të treta.

3. Deklarata e veprimtarisë së lobimit dorëzohet pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe publikohet në Regjistrin e Lobimit në përputhje me nenin 9 të këtij ligji duke respektuar parimet e transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

4. Forma, përmbajtja dhe mënyra e dorëzimit të deklaratës përcaktohen me udhëzim të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.



## KREU VI

NDALIMET DHE KONFLIKTI I  
INTERESIT GJATË USHTRIMIT  
TË VEPRIMTARISË SË LOBIMIT

## Neni 19

**Ndalimi i lobimit për zyrtarin publik**

1. Për të garantuar integritetin e vendimmarrjes publike, ish-zyrtarët publikë u nënshtrohen periudhave të ndryshme të ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë së lobimit, në varësi të nivelit të funksionit të ushtruar, si më poshtë:

a) ish-anëtarët e Këshillit të Ministrave dhe ish-deputetët ndalohen të ushtrojnë veprimtari lobimi për një periudhë 2-vjeçare nga përfundimi i mandatit.

b) krerët e institucioneve të pavarura, sekretarët e përgjithshëm të ministrive, drejtorët e përgjithshëm të agjencive rregullatore dhe drejtues të tjerë të lartë me kompetenca vendimmarrëse ndalohen të ushtrojnë veprimtari lobimi për një periudhë 1-vjeçare nga përfundimi i mandatit ose marrëdhënies së punës.

2. Ndalimi i ushtrimit të lobimit zbatohet vetëm në:

a) institucionin ku ish-zyrtari ka ushtruar funksionin;

b) çështjet për të cilat ai ka pasur përgjegjësi ose kompetenca vendimmarrëse, mbikëqyrëse apo rregullatore;

c) subjektet me të cilat ish-zyrtari ka pasur marrëdhënie kontraktuale, mbikëqyrëse ose kontrolluese gjatë periudhës së funksionit.

3. Ish-zyrtarët publikë nuk mund të përdorin informacione jopublike, konfidenciale ose të mbrojtura të përfituara gjatë ushtrimit të funksionit për qëllime lobimi.

4. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale publikon dhe përditëson në një rubrikë të posaçme të Regjistrit të Lobimit një listë të zyrtarëve, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, dhe mbikëqyr zbatimin e periudhës së ndalimit në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

## Neni 20

**Parandalimi i konfliktit të interesit në  
veprimtarinë e lobimit**

1. Lobisti nuk mund të ushtrojë veprimtari lobimi në çështje ku ai vetë, anëtarët e familjes së tij ose subjektet me të cilat ka lidhje ekonomike, profesionale apo kontraktuale ushtrojnë funksione publike, funksione vendimmarrëse ose këshilluese në autoritetin publik përkatës.

2. Lobisti ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit kur përfaqëson ose angazhohet për dy ose më shumë përfitues lobimi që kanë interesa të kundërta në të njëjtën çështje.

3. Lobisti ka detyrimin të deklarojë paraprakisht çdo rrethanë që mund të përbëjë konflikt interesi pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

4. KDIMDP-ja përcakton me udhëzim procedurat për identifikimin, deklarimin, shqyrtimin dhe menaxhimin e situatave të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së lobimit.

## KREU VII

## MBIKËQYRJA DHE SANKSIONET

## Neni 21

**Veprimtaria kontrolluese e autoritetit  
përgjegjës për lobimin**

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbikëqyr zbatimin e dispozitave të këtij ligji dhe përpunueshmërinë e veprimtarive të lobimit me të dhënat e regjistruara.

2. Për këtë qëllim, KDIMDP-ja ka të drejtë:

a) të kërkojë informacion nga lobistët dhe përfituesit e lobimit;

b) të verifikojë dokumentet dhe raportet e dorëzuara;

c) të kërkojë sqarime nga zyrtarët publikë për kontaktet e zhvilluara me lobistë.

3. Kur konstaton shkelje, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr masa administrative sipas këtij ligji.

4. KDIMDP-ja raporton në Kuvend një herë në vit për rezultatet e mbikëqyrjes dhe masat e marra, duke e bërë publik raportin në faqen e tij zyrtare. Raporti vjetor përfshin edhe një seksion për kontaktet e zhvilluara me lobistë nga vetë



Komisioneri në përputhje me parashikimet e këtij ligji.

#### Neni 22

### **Verifikimi i të dhënave në Regjistrin e Lobimit**

1. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale verifikon saktësinë e të dhënave të regjistruara dhe përditësimin e tyre.

2. Në rast konstatimi të pasaktësive ose mospërputhjeve, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale njofton menjëherë lobistin, i cili është i detyruar të marrë masat e nevojshme për korrigjimin e të dhënave brenda një afati prej 30 ditësh.

3. Procedurat dhe afatet për kryerjen e verifikimeve sipas këtij neni përcaktohen me udhëzim të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

#### Neni 23

### **Transparenca, kontrolli dhe administrimi i raporteve për aktivitetet e lobimit**

1. Çdo zyrtar publik, që zhvillon kontakt me një lobist të regjistruar, në kuptim të këtij ligji, është i detyruar ta raportojë këtë kontakt pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale brenda 10 ditëve punë nga data e kontaktit.

2. Raporti përmban vetëm informacionin thelbësor për:

- a) identitetin e lobistit;
- b) datën, mënyrën dhe pjesëmarrësit në kontakt;
- c) temën ose çështjen e diskutuar.

3. Komisioneri verifikon raportet e paraqitura dhe kontrollon përputhshmërinë e tyre me këtë ligj, përfshirë rregullat për transparencën, konfliktin e interesit dhe ndalimin e lobimit në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji.

4. Raportet regjistrohen në Regjistrin e Lobimit dhe publikohen në faqen zyrtare të Komisionerit, duke respektuar parimet e transparencës dhe mbrojtjes së të dhënave personale dhe informacionit të klasifikuar.

#### Neni 24

### **Sanksionet administrative**

Shkelja e dispozitave të këtij ligji ndëshkohet me masa administrative në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe natyrën e shkeljes si më poshtë:

a) ushtrimi i veprimtarisë së lobimit pa u regjistruar dënohet me gjobë në masën 500 000 lekë dhe shoqërohet me ndalimin për regjistrimin si lobist deri në 1 vit.

b) mosdeklarimi i të dhënave të sakta nga lobisti ose përfituesi i lobimit dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë.

c) moskorrigjimi i të dhënave të pasakta brenda afatit të përcaktuar dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

ç) mosraportimi i kontakteve lobuese nga zyrtari publik dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë.

d) zyrtari publik që vijon komunikimin me një person që ushtron lobim, i cili nuk deklaron qëllimin e lobimit ose refuzon të japë informacionin e nevojshëm për deklarimin e kontaktit, dënohet me gjobë nga 200 000 deri në 400 000 lekë.

dh) raportimi i pasaktë ose i pjesshëm i kontakteve lobuese nga zyrtari apo ish-zyrtari publik, përfshirë paraqitjen e të dhënave të rreme ose të shtrembëruara, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 200 000 lekë.

e) mosparaqitja e deklaratës së veprimtarisë së lobimit dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë.

ë) mosrespektimi i Kodit të Sjelljes nga lobisti dënohet me gjobë nga 50 000 deri në 100 000 lekë.

f) refuzimi pa shkak të ligjshëm për të bashkëpunuar, si dhe mosdhënia e informacionit ose dokumentacionit të kërkuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale brenda afateve të përcaktuara në këtë ligj dënohet me gjobë 100 000 lekë.

#### Neni 25

### **Ankimi**

Vendimet e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ankimohen në gjykatën administrative kompetente sipas legjislacionit në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.



Neni 26

**Detyrimi i autoriteteve publike për zbatimin e ligjit**

Autoritetet publike qendrore dhe vendore bashkëpunojnë me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për zbatimin e këtij ligji, duke i vënë në dispozicion informacionin e kërkuar dhe dokumentet përkatëse.

KREU VIII

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 27

**Aktet nënligjore**

Ngarkohet Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale që brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji të miratojë aktet nënligjore në zbatim të nenit 7, pika 3; të nenit 8, pika 3; të nenit 9, pika 7; të nenit 17, pika 2; të nenit 18, pika 4; të nenit 20, pika 4, dhe të nenit 22, pika 3, të këtij ligji.

Neni 28

**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 28.1.2026.

**Shpallur me dekretin nr. 69, datë 12.2.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**

DEKRET

Nr. 69, datë 12.2.2026

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 12/2026, “Për lobimin në Republikën e Shqipërisë”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

LIGJ

Nr. 13/2026

**PËR IMPORTIN, EKSPORTIN DHE  
TRANSITIN E ARMËVE TË ZJARRIT,  
TË KOMPONENTËVE TË TYRE  
KRYESORË DHE TË MUNICIONEVE<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I  
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

**Qëllimi**

Ky ligj ka për qëllim vendosjen e një regjimi të posaçëm kontrolli mbi importin, eksportin dhe transitin e mallrave të listuara, sipas shtojcës I bashkëlidhur këtij ligji, me qëllim shmangien e prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, të pjesëve e të komponentëve të tyre dhe të municioneve.

Neni 2

**Objekti**

Ky ligj ka si objekt përcaktimin e rregullave për dhënien e autorizimeve për importin dhe eksportin

<sup>1</sup> Ky ligj është përafshuar pjesërisht me rregulloren (BE) 2025/41 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 19 dhjetor 2024, “Për masat për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit, komponentëve kryesorë dhe municioneve, që zbaton nenin 10 të Protokollit të Kombeve të Bashkuara kundër prodhimit të paligjshëm dhe trafikimit të armëve të zjarrit, pjesëve të tyre, komponentëve dhe

Faqe | 2856

municioneve, dhe plotëson Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar (Protokolli i OKB-së për armët e zjarrit)”, numri CELEX 32025R0041, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 2025/41, datë 22.1.2025, ELI: <http://data.europa.eu/eli/reg/2025/41/oj>.



e mallrave të listuara, sipas shtojcës I bashkëlidhur këtij ligji, dhe marrjen e masave për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit, të pjesëve e të komponentëve të tyre dhe të municioneve.

### Neni 3 Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Armë zjarri” është një armë zjarri sipas legjislacionit në fuqi për armët.

2. “Armë zjarri gjysmë të përfunduara” janë armët e zjarrit që nuk janë gati për t’u përdorur në mënyrë të drejtpërdrejtë, kanë formë apo strukturë të përafërt me armët përkatëse të zjarrit të përfunduara, përdoren, përveçse në raste të jashtëzakonshme, vetëm për të prodhuar armët përkatëse të zjarrit të përfunduara;

3. “Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve” është Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE);

4. “Mallra të listuara” janë armët e zjarrit, komponentët kryesorë, municionet, armët për alarm dhe sinjalizim, armët e zjarrit të çaktivizuara, armët e zjarrit gjysmë të përfunduara, komponentët kryesorë gjysmë të përfunduar, si dhe zbutësit e zhurmës, sipas legjislacionit në fuqi për armët, të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji;

5. “Zbutës i zhurmës” është një pajisje që i bashkëngjitet tytës apo është pjesë e saj, me qëllim zvogëlimin e zhurmës e të flakës së krijuar nga qitja me armë zjarri, sipas legjislacionit në fuqi për armët;

6. “Komponent kryesor” është një pjesë kryesore sipas legjislacionit në fuqi për armët;

7. “Komponentë kryesorë gjysmë të përfunduar” janë komponentët kryesorë që nuk janë gati për t’u përdorur në mënyrë të drejtpërdrejtë, kanë formë apo strukturë të përafërt me komponentët kryesorë përkatës të përfunduar dhe mund të përdoren, përveçse në raste të jashtëzakonshme, vetëm për të prodhuar komponentët kryesorë përkatës të përfunduar;

8. “Municione” janë municionet sipas legjislacionit në fuqi për armët;

9. “Armë zjarri të çaktivizuara” janë armët e zjarrit të çaktivizuara sipas legjislacionit në fuqi për armët;

10. “Armë për alarm dhe sinjalizim” janë armët për alarm dhe sinjalizim sipas legjislacionit në fuqi për armët;

11. “Person” është një person fizik apo juridik ose një shoqatë personash që nuk mban statusin e personit juridik, por njihet se ka kapacitetin për të kryer veprime ligjore, sipas legjislacionit në fuqi;

12. “Territor doganor” është territori doganor i parashikuar në legjislacionin doganor në fuqi;

13. “Mallra shqiptare” janë mallrat sipas legjislacionit doganor në fuqi;

14. “Mallra joshqiptare” janë të gjitha mallrat sipas legjislacionit doganor në fuqi;

15. “Autoritete doganore” janë autoritetet doganore sipas legjislacionit doganor në fuqi;

16. “Legjislacion doganor” është legjislacioni sipas legjislacionit doganor në fuqi;

17. “Formalitete doganore” janë formalitetet doganore sipas legjislacionit doganor në fuqi;

18. “Kontrolle doganore” janë kontrollet doganore sipas legjislacionit doganor në fuqi;

19. “Deklaratë doganore” është një deklaratë doganore sipas legjislacionit doganor në fuqi;

20. “Hyrje” është hyrja fizike e mallrave joshqiptare në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

21. “Import” është hyrja e mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë dhe vendosja e mallrave në qarkullim të lirë, sipas legjislacionit doganor në fuqi, ose vendosja e tyre në një regjim të posaçëm, sipas legjislacionit doganor në fuqi;

22. “Importues” është çdo person fizik apo juridik që bën një deklaratë doganore importi në emër të tij ose në emër të të cilit bëhet një deklaratë e tillë apo, në rastin e transitit, mbajtësi i regjimit.

23. “Eksport” është një procedurë eksporti sipas legjislacionit doganor në fuqi;

24. “Rieksport” është procedura e rieksportit sipas legjislacionit doganor në fuqi;

25. “Dalje” është dalja fizike e mallrave nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë;

26. “Eksportues” është:

a) një person fizik i cili nxjerr mallra jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, kur këto mallra mbahen në bagazhin personal të personit;

b) në raste të tjera nga ato të përmendura në shkronjën “a” të kësaj pike:

i. një person i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, i cili ka kompetencat për



të caktuar dhe ka caktuar që mallrat të nxirren jashtë territorit doganor;

ii. në raste të tjera nga ato të përmendura në nënndarjen “i” të kësaj shkronje, “eksportues” është çdo person i vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, i cili është palë në kontratën sipas së cilës nxirren mallrat nga ai territor doganor.

27. “Deklarues” është një deklarues sipas legjislacionit doganor në fuqi;

28. “Tregtar” është një tregtar sipas legjislacionit në fuqi për armët;

29. “Ndërmjetësues” është një ndërmjetësues sipas legjislacionit në fuqi për armët;

30. “Ekspozitë” është një panair tregtar ose ngjarje e ngjashme, siç përshkruhet në legjislacionin doganor në fuqi, që nuk përfshin shitje të mallrave të listuara nga dhe në drejtim të vendeve të tjera;

31. “Eksport i përkohshëm” është eksporti i mallrave të listuara nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, me qëllim riimportimin e këtyre mallrave në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

32. “Përpunim aktiv” është përpunimi aktiv sipas legjislacionit doganor në fuqi;

33. “Transit” është procedura e transitit sipas legjislacionit doganor në fuqi;

34. “Lejim i përkohshëm” është lejimi i përkohshëm sipas legjislacionit doganor në fuqi;

35. “Transbord” është një lëvizje që përfshin veprimtarinë fizike të shkarkimit të mallrave të listuara nga një mjet transporti në një mjet tjetër transporti;

36. “Trafikim i paligjshëm” është importi, eksporti, shitja, dërgimi, lëvizja ose transferimi i mallrave të listuara nga ose nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë në drejtim të shteteve të tjera, nëse zbatohet një prej rasteve në vijim:

a) shteti shqiptar nuk e autorizon veprimin në përputhje me këtë ligj;

b) mallrat e listuara nuk janë markuar sipas kërkesave për markim, të parashikuara në pikën 1, të nenit 7, të këtij ligji;

c) mallrat e listuara janë deklaruar për t’u hedhur në qarkullim të lirë pa markimin e nevojshëm, sipas pikës 2 të nenit 7 të këtij ligji, përveçse kur këto mallra përjashtohen në përputhje me pikat 2 e 3 të nenit 7 të këtij ligji;

37. “Sistem elektronik i licencimit” është sistemi i përshkruar në nenin 32 të këtij ligji;

38. “Pjesë” është çdo element ose element zëvendësues i projektuar posaçërisht për një armë zjarri, përfshirë komponentët thelbësorë, si dhe çdo pajisje e projektuar ose e përshtatur për të zvogëluar zhurmën e shkaktuar nga qitja e një arme zjarri;

39. “NUIS”/“NIPT” është numri unik i identifikimit të subjektit/numri i identifikimit të personit të tatueshëm.

#### Neni 4

#### Përjashtimet nga fusha e zbatimit

Përjashtohen nga fusha e zbatimit të këtij ligji:

a) transaksionet ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe një shteti tjetër ose transferimet shtetërore;

b) mallrat e listuara të kategorisë “A” në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, në rastet kur janë pjesë e listës ushtarake, sipas legjislacionit në fuqi, të eksportuara apo të rieksporuara nga territori doganor, përveçse kur janë eksportuar apo rieksportuar përkohësisht, në përputhje me nenin 18 të këtij ligji;

c) mallrat e listuara të kategorisë “B” në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, në rastet kur janë pjesë e listës ushtarake, sipas legjislacionit në fuqi, të eksportuara apo të rieksporuara nga territori i Republikës së Shqipërisë dhe të destinuara për forcat e armatosura, policinë apo autoritetet publike;

ç) mallrat e listuara të kategorive “A”, “B” dhe “C” në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, të destinuara për forcat e armatosura, policinë ose autoritetet publike;

d) armët e zjarrit antike, siç parashikohet në legjislacionin në fuqi, me kusht që armët e zjarrit antike të mos përfshijnë armë zjarri të prodhuara pas vitit 1899.

#### Neni 5

#### Formalitetet doganore

Në kuptim të këtij ligji, mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji nuk duhet:

a) të vendosen nën një procedurë doganore, bazuar në një deklaratë të thjeshtuar të përcaktuar sipas nenit 152 të Kodit Doganor;

b) t’i nënshtrohen një shënimi në regjistrin e deklaruesit, sipas nenit 165 të Kodit Doganor;

c) t’i nënshtrohen vetëvlerësimit, sipas nenit 167 të Kodit Doganor;



ç) të deklarohen në një deklaratë doganore për çlirim të lirë dërgese me vlerë të ulët, në përputhje me vendimin nr. 651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar;

d) të deklarohen në një deklaratë doganore që përmban të dhënat e reduktuara, të përmendura në nenin 316 të vendimit nr. 651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar; ose

dh) të jenë të deklaruara me anë të një deklarate me gojë ose me anë të çdo akti tjetër, siç përmendet në nenet 304 deri në 311 të vendimit nr. 651, datë 10.11.2017, të Këshillit të Ministrave “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar.

## KREU II KËRKESAT DHE PROCEDURA E IMPORTIT

### Neni 6 Detyrat e importuesve

1. Importuesit përmbushin këto detyra:

a) sigurohen që mallrat e listuara, të destinuara për import, të jenë në përputhje me:

i. rregullat për markimin, të parashikuara në nenin 7 të këtij ligji;

ii. rregullat për çaktivizimin, të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji, sipas rastit;

iii. rregullat për pakonvertueshmërinë, të parashikuara në nenin 8 të këtij ligji, sipas rastit;

b) mbajnë të gjitha dokumentet, sipas parashikimeve të përcaktuara në shkronjën “a” të kësaj pike, si dhe dokumentacionin përkatës, sipas neneve 10, 12 e 13 të këtij ligji, për t’i vendosur në dispozicion të autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve gjatë periudhës së përmendur në nenin 27 të këtij ligji;

c) pas marrjes së një kërkesë nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve i dorëzojnë autoritetit autorizimin për eksport të vendit eksportues ose, sipas rastit, përjashtimin nga ky autorizim;

ç) kur kanë arsye të justifikuara se mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji mund të mos jenë në përputhje me këtë ligj ose me legjislacionin në fuqi për armët, informojnë menjëherë autoritetin përgjegjës për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të

mallrave ushtarake dhe të artikujve e të teknologjive me përdorim të dyfishtë lidhur me këto dyshime;

d) bashkëpunojnë me autoritetin përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve pas marrjes së një kërkesë, për të garantuar marrjen e veprimeve të menjëhershme, të nevojshme dhe korrigjuese, për të trajtuar çdo rast të papajtueshmërisë me kërkesat e parashikuara në aktet e përmendura në shkronjën “ç” të kësaj pike.

2. Detyrimet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni për importuesit nuk ndikojnë në detyrimet e tyre, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për armët ose në aktet në zbatim të tij.

### Neni 7

#### Markimi në momentin e importit

1. Armët e zjarrit të pamarkuara sipas përcaktimeve të protokollit të OKB-së për armët e zjarrit, të cilat hyjnë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, nuk importohen ose rieksporthen.

2. Mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji çlirohen për qarkullim të lirë vetëm nëse përmbushin kërkesat për markimin, të parashikuara në legjislacionin në fuqi për armët dhe në Protokollin e OKB-së për armët e zjarrit, përveçse kur këto mallra janë importuar nga tregtarë që kanë autorizim për t’i përmbushur këto kërkesa menjëherë pas çlirimit të mallrave për qarkullim të lirë.

3. Pikat 1 dhe 2 të këtij neni nuk zbatohen për mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji të cilat kanë rëndësi të veçantë historike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për armët.

### Neni 8

#### Armët e zjarrit të çaktivizuara

1. Pajisjet e deklaruara si armë zjarri të çaktivizuara çlirohen për qarkullim të lirë ose pranim të përkohshëm, sipas nenit 11 të këtij ligji, vetëm nëse janë të shoqëruara nga certifikata përkatëse e çaktivizimit dhe të markuara sipas legjislacionit në fuqi për armët.

2. Importuesi i dorëzon autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve një kopje të certifikatës së çaktivizimit nëpërmjet sistemit elektronik të licencimit.



## Neni 9

**Armët për alarm dhe sinjalizim**

1. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve lëshon autorizimin për import për armët për alarm dhe sinjalizim vetëm nëse pajisja përmbush specifikimet teknike, sipas legjislacionit në fuqi për armët, ose është e një modeli të listuar si armë e pakonvertueshme për alarm dhe sinjalizim në vendimin e Këshillit të Ministrave.

2. Këshilli i Ministrave përcakton një listë të hapur të modeleve të armëve të pakonvertueshme për alarm dhe sinjalizim, të përmendura në pikën 1 të këtij neni, si dhe një listë të hapur të pajisjeve që janë deklaruar si armë për alarm dhe sinjalizim, por që janë të konvertueshme.

## Neni 10

**Autorizimi për import**

1. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve lëshon autorizime për import për hyrjen në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave joshqiptare të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji.

2. Autorizimi për import përmban informacionin e renditur në shtojcën II bashkëlidhur këtij ligji dhe lëshohet nëpërmjet sistemit elektronik të licencimit në një nga format e mëposhtme:

a) autorizim i vetëm për një dërgesë të një apo më shumë mallrave të listuara, i vlefshëm për maksimumi 1 vit;

b) autorizim i shumëfishtë për dërgesa të shumëfishta të një apo më shumë mallrave të listuara, i vlefshëm për maksimumi 3 vjet;

c) autorizim i përgjithshëm për mallrat e listuara të kategorive “B” ose “C” të shtojcës I bashkëlidhur këtij ligji, i disponueshëm për operatorët ekonomikë të autorizuar për sigurinë dhe mbrojtjen, sipas legjislacionit doganor në fuqi, i vlefshëm për importet nga vendet e specifikuar të origjinës.

3. Çdo person fizik ose juridik që sipas legjislacionit në fuqi për armët është i pajisur me licencë për të prodhuar, blerë, mbajtur ose tregtuar mallra të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, me përjashtim të armëve të zjarrit gjysmë të përfunduara dhe komponentëve kryesorë gjysmë të përfunduar, ka të drejtë të aplikojë për një autorizim për import.

4. Vetëm tregtarët dhe ndërmjetësuesit kanë të drejtë të aplikojnë për autorizim për import për armët e zjarrit gjysmë të përfunduara dhe komponentët kryesorë gjysmë të përfunduar.

5. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve nuk pranon aplikime nga personat fizikë ose juridikë të cilët nuk kanë të drejtë të aplikojnë për një autorizim për import, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij neni.

## Neni 11

**Procedura e autorizimit për import**

1. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve trajton aplikimet për autorizime për import brenda një periudhe jo më të gjatë se 90 ditë pune nga data kur i janë dërguar të gjitha informacionet e nevojshme. Për arsye të justifikuara dhe në rastin e një aplikimi lidhur me mallrat e listuara të kategorisë “A” në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, kjo periudhë mund të zgjatet deri në 110 ditë pune.

2. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve refuzon dhënien e një autorizimi për import në rast se:

a) kërkuesi është një person fizik, ndaj të cilit ka filluar procedimi penal ose është dënuar për një vepër penale të parashikuar me një dënim penal maksimal prej të paktën 4 vitesh burgim;

b) kërkuesi është një person juridik dhe një nga personat e lidhur me këtë person juridik të përcaktuar si më poshtë, ndodhet në kushtet e shkronjës “a” të kësaj pike:

i. kërkuesi;

ii. personat përfaqësues për kërkuemin;

iii. personat që ushtrojnë kontroll mbi menaxhimin e veprimtarisë së kërkuemit.

c) arma që importohet është deklaruar e humbur apo e vjedhur, është objekt hetimi ose për të ka një kërkesë sekuestrimi në bazat e të dhënave përkatëse kombëtare ose ndërkombëtare;

ç) ka indicie të qarta që sugjerojnë se një nga personat e përfshirë në transaksion përbën kërcënim ndaj sigurisë ose një kërcënim ndaj sigurisë publike apo se personat e përmendur në shkronjat “a” ose “b” të kësaj pike nuk plotësojnë detyrimet që u ngarkohen nga legjislacioni në fuqi për armët, nga ky ligj ose nga autorizimet e lëshuara lidhur me armët e tyre të zjarrit.





3. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve përpara marrjes së vendimit për dhënien e një autorizimi për import merr në konsideratë të gjithë faktorët me rëndësi, duke përfshirë faktorët e politikës së jashtme dhe të sigurisë së brendshme, sipas përcaktimeve të nenit 20 të këtij ligji.

4. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, për qëllime të pikës 2 të këtij neni, merr informacion për dënimet e mëparshme penale të kërkuarit në shtete të tjera, sipas legjislacionit në fuqi për bashkëpunimin në fushën penale.

5. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve për qëllime të shkronjës “c” të pikës 2 të këtij neni kryen verifikime për t’u siguruar që arma e zjarrit nuk është e listuar në sistemet elektronike në përdorim të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit.

6. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve anulon, pezullon, ndryshon ose revokon autorizimin për import, nëse kushtet për dhënien e tij nuk janë përmbushur ose nuk përmbushen më. Në rastet kur autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve merr një vendim të tillë, informon menjëherë autoritetet doganore dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit rreth këtij vendimi përmes sistemit elektronik të licencimit.

7. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, kur refuzon dhënien e një autorizimi për import, vendimi përfundimtar dhe arsyetimi përkatës regjistrohen në sistemin elektronik të licencimit.

8. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve mbikëqyr përmbushjen e kushteve për autorizimet e importit në bazë të menaxhimit të riskut. Kushtet e autorizimeve të importit, të dhëna për një kohëzgjatje më të gjatë se 2 vjet, do të monitorohen pas 2 vitesh.

#### Neni 12

### **Autorizimi për import për mallrat joshqiptare që hyjnë përkohësisht në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë**

1. Mallrat joshqiptare të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji mund të hyjnë përkohësisht në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, nëse shoqërohen nga një autorizim vetëm për import, i kërkuar nga një importues që nuk është i

vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Importuesve që nuk janë të vendosur në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë mund t’u jepet një autorizim i vetëm për import për mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji vetëm në situatat e mëposhtme:

a) pranim i përkohshëm për vlerësim, për ekspozim ose për përpunim aktiv për riparim, me kusht që mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji të mbeten në pronësi të një personi të vendosur jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe këto mallra t’i rieksporthen atij personi;

b) pranim i përkohshëm nga gjuetarët, rikrijuesit e ngjarjeve historike ose qitësit sportivë, nëse mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji janë pjesë të objekteve të tyre personale, me kusht që t’i paraqesin autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve:

i. arsyet e udhëtimit, veçanërisht duke paraqitur një ftesë ose prova të tjera për veprimtaritë e gjuetisë, të rikrijimeve historike ose të qitjes sportive në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

ii. një përshkrim të mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, të synuara për t’u sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, si dhe arsyet për llojin dhe shumën e këtyre mallrave, të cilat janë të përshtatshme për arsye të pranimit të përkohshëm. Në çdo rast, sasia e municionit kufizohet deri në maksimumi 800 fishekë për gjuetarët dhe maksimumi 1200 fishekë për qitësit sportivë;

iii. informacionin për pikën e planifikuar të daljes dhe për datën e daljes së këtyre mallrave.

c) mallrat joshqiptare që hyjnë dhe kalojnë përmes territorit doganor të Republikës së Shqipërisë të vendosura nën një regjim doganor të transitit me destinacion përfundimtar një vend tjetër.

3. Kërkesa për autorizim për import, sipas pikës 2 të këtij neni, shoqërohet me elementet ose dokumentacionin e mëposhtëm:

a) një vërtetim nga organet kompetente për ndjekjet penale apo dënimet penale për vepra penale të parashikuara me një dënim penal maksimal prej të paktën 4 vjetësh burgim;

b) identifikimin e një prej tri qëllimeve të listuara në shkronjat “a”, “b” dhe “c” të pikës 2 të këtij neni;

c) datën dhe numrin unik të referencës së autorizimit ose të dhëna të barasvlershme për të



zotëruar apo për të mbajtur një armë zjarri, si dhe të autorizimit për eksport nga vendi eksportues ose, sipas rastit, vërtetimin e përjashtimit nga ky autorizim; dhe

ç) të dhënat e armëve të zjarrit, duke përfshirë emrin e prodhuesit ose markën, shtetin ose vendin e prodhimit, numrin e serisë dhe modelin, kur është e mundur.

4. Për lëshimin e autorizimit për import të përmendur në pikën 2 të këtij neni zbatohen parashikimet e pikave 1, 2, 3, 5, 6 dhe 7 të nenit 11 të këtij ligji.

5. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, pavarësisht parashikimeve të pikës 2 të këtij neni, jep një autorizim kombëtar të përgjithshëm për import, që autorizon drejtpërdrejt importin e përkohshëm të mallrave të listuara të kategorisë “C” të shtojcës I bashkëlidhur këtij ligji në territorin e Republikës së Shqipërisë, për qëllimet e përmendura në shkronjën “b” të pikës 2 të këtij neni, në rastet specifike kur gjuetarët, rikrijuesit e ngjarjeve historike ose qitësit sportivë janë ftuar në një aktivitet në ambientet e organizatorit. Importuesit duhet të përmbushin detyrimet e parashikuara në këtë ligj, me përjashtim të detyrimeve të lidhura me kërkesën për një autorizim të vetëm për import, si dhe të zbatojnë kushtet e përcaktuara në autorizimin kombëtar të përgjithshëm për import.

6. Kërkesat minimale për kushtet që përfshihen në autorizimet kombëtare të përgjithshme për import përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### Neni 13

#### Lehtësira administrative

1. Çdo person që zotëron një licencë për armë zjarri ose që në përputhje me legjislacionin në fuqi për armët lejohet të prodhojë, të blejë, të mbajë ose të tregtojë mallra të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji mund të importojë mallra të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji në territorin doganor shqiptar pa pasur një autorizim për import, në përputhje me parashikimet e nenit 10 të këtij ligji, në rastet e:

a) importit të mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, të cilat janë eksportuar përkohësisht më parë, në përputhje me nenet 18, pika 1, shkronja “a”, dhe 19, pika 1, shkronja “c”, të këtij ligji, me kusht që:

i. numri i referencës ose numri i autorizimit të thjeshtuar për eksport i lëshuar nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, në përputhje me nenet 18, pika 2, ose 19, pika 1, të këtij ligji, i komunikohet përsëri këtij autoriteti përmes sistemit elektronik të licencimit të paktën 10 ditë pune përpara datës së planifikuar të rihyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

ii. mallrat e importuara të jenë gjithashtu mallrat e eksportuara;

iii. mallrat të importohen brenda 90 ditëve pas eksportit;

iv. koha dhe pika e planifikuar e hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë i raportohen autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, përmes sistemit elektronik të licencimit, të paktën 10 ditë pune përpara datës së planifikuar të rihyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

b) importit të mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, të përfshira në Listën e Mallrave Ushtarake të përcaktuara në zbatim të ligjit nr. 46/2018, “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”, nëse janë eksportuar përkohësisht më parë për qëllime vlerësimi, ekspozimi dhe riparimi, me kusht që:

i. licenca e dhënë për eksport të përkohshëm, në përputhje me legjislacionin në fuqi për transferimet ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë, i komunikohet autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve nëpërmjet sistemit elektronik të licencimit, të paktën 10 ditë pune përpara datës së planifikuar të rihyrjes në territorin doganor shqiptar;

ii. mallrat e importuara të jenë gjithashtu mallrat e eksportuara;

iii. mallrat të importohen brenda 90 ditëve pas eksportit;

iv. koha dhe pika e planifikuar e hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë t'i raportohen autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë përmes sistemit elektronik të licencimit të paktën 10 ditë pune përpara datës së planifikuar të rihyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

c) rihyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë të mallrave shqiptare, të cilat janë vendosur më parë nën një regjim doganor të transitit për kalimin përmes një vendi ose territori jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe kanë destinacion përfundimtar në Republikën e Shqipërisë.

2. Personi që importon mallra në përputhje me këtë nen duhet të jetë i njëjti person që i ka eksportuar mallrat, si dhe duhet të paraqesë në deklaratën doganore numrin e referencës së deklaratës doganore të përdorur për nxjerrjen e përkohshme të mallrave jashtë territorit doganor shqiptar dhe numrin e referencës ose numrin e autorizimit të thjeshtuar për eksport të lëshuar nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, në përputhje me pikën 2 të nenit 18 ose me pikën 1 të nenit 19 të këtij ligji.

3. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve refuzon importin dhe e regjistron menjëherë këtë refuzim në sistemin elektronik të licencimit, nëse:

a) kërkuesi nuk përmbush kriteret për lehtësirat administrative të parashikuara në këtë nen;

b) ka indicie të bazuara që tregojnë se një nga personat e përfshirë në situatat e përmendura në shkronjat “a” ose “b” të pikës 1 të këtij neni, duke përfshirë personin që e ka ftuar kërkuenin në veprimtarinë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, përbëjnë kërcënim për sigurinë apo kërcënim për sigurinë publike.

Neni 14

### **Kufizimet kombëtare për importin**

Ky ligj nuk cenon dhe nuk përjashton miratimin ose zbatimin e kufizimeve sasiore për importet, të cilat janë të nevojshme për arsye të politikës publike, sigurisë publike ose për arsye të pronësisë industriale dhe tregtare.

## **KREU III**

### **KËRKESAT DHE PROCEDURA PËR EKSPORTIN, RIEKSPORTIN**

Neni 15

### **Autorizimi për eksport**

1. Autorizimi për eksport ka si objekt nxjerrjen e mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij

ligji jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

2. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve lëshon autorizime për eksport me kërkesë të çdo eksportuesi të licencuar, sipas legjislacionit në fuqi për armët, për të prodhuar, blerë, mbajtur ose tregtuar mallra të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji.

3. Autorizimi për eksport përmban informacionin e parashikuar sipas shtojcës III bashkëlidhur këtij ligji dhe lëshohet nëpërmjet sistemit elektronik të licencimit në një nga format e mëposhtme:

a) një autorizim apo licencë e vetme që i jepet një eksportuesi të caktuar për një dërgesë të një apo më shumë mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji të një marrëse ose përfituesi i identifikuar si fundor;

b) një autorizim apo licencë e shumëfishtë që i jepet një eksportuesi të caktuar për dërgesa të shumëfishta të një apo më shumë mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji të një apo disa marrëse ose përfituesi të identifikuar fundorë në një apo në disa vende;

c) një autorizim kombëtar i përgjithshëm për eksport që autorizon drejtpërdrejt eksportin e mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji nga eksportuesi të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë, nëse eksportuesi plotëson kërkesat e përcaktuara në këtë ligj dhe përmbush kushtet e përgjithshme të parashikuara në autorizimin kombëtar të përgjithshëm për eksport.

4. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve nuk e pranon aplikimin kur një person nuk gëzon të drejtën të kërkojë një autorizim për eksport, sipas pikës 2 të këtij neni.

Neni 16

### **Procedura e autorizimit për eksport**

1. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve përpunon kërkesat për autorizim për eksport brenda një periudhe jo më të gjatë se 90 ditë pune nga data kur i janë dërguar të gjitha informacionet e nevojshme. Për arsye të justifikuara kjo periudhë mund të zgjatet deri në 110 ditë pune.

2. Kërkuesi i paraqet autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve dokumentet e nevojshme që vërtetojnë se:

a) vendi importues e ka autorizuar importin;



b) vendi ose vendet e transitit, nëse ka, nuk kanë kundërshtime për transitin.

3. Për qëllimin e këtij neni, shkronja “b” e pikës 2 të këtij neni nuk zbatohet:

a) për dërgesat në rrugë ajrore ose detare dhe përmes porteve ose aeroporteve të vendeve, me kusht që të mos ketë transbordin ose ndryshim të mjeteve të transportit;

b) në rastin e eksporteve të përkohshme për qëllime të ligjshme dhe të verifikueshme, ku përfshihet gjuetia, rikrijimet historike, qitja sportive, vlerësimi, ekspozimi dhe riparimi.

4. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve përpara lëshimit të një autorizimi për eksport dhe parashikuar në nenin 14 të këtij ligji verifikon dokumentet e dorëzuara, sipas pikave 2 dhe 3 të këtij neni.

5. Vendi ose vendet e transitit të konsultuara kanë afat 20 ditë pune nga data e kërkesës me shkrim për t’u shprehur në rast se nuk merret asnjë kundërshtim ndaj transitit, sipas shkronjës “b” të pikës 2 të këtij neni, konsiderohen se nuk kanë asnjë kundërshtim ndaj transitit.

6. Kërkuesi i paraqet autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve certifikatën e çaktivizimit për armët e zjarrit të çaktivizuara, sipas legjislacionit në fuqi për armët.

7. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve lëshon autorizime për eksport për armët e zjarrit të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji vetëm në rast se aplikimi për autorizim shoqërohet nga një deklaratë e përdoruesit, në përputhje me shtojcën IV bashkëlidhur këtij ligji, të lëshuar nga importuesi i vendit të destinacionit përfundimtar. Në rastin e eksportit drejt një shoqërie private që i rishet mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji në një treg vendas kjo shoqëri do të konsiderohet si përdoruesi për qëllime të këtij ligji. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve ka të drejtë të vlerësojë kërkesat për autorizim për eksport të lidhura me eksportet drejt rishitësve në mënyrë të ndryshme nga kërkesat për autorizim për eksport të lidhura me eksportet drejt përdoruesve.

8. Autorizimi i vetëm i lëshuar për eksport është i vlefshëm për sa kohë nuk e tejkalon periudhën e vlefshmërisë së autorizimit për import të lëshuar nga vendi importues. Në çdo rast periudha e vlefshmërisë së një autorizimi të shumëfishtë për eksport nuk i tejkalon 3 vjet. Në rastet kur autorizimi

për import i lëshuar nga vendi importues nuk e specifikon periudhën e vlefshmërisë periudha e vlefshmërisë për autorizimin për eksport konsiderohet se nuk e tejkalon afatin e 1 viti, me përjashtim të rrethanave të jashtëzakonshme dhe kur ka arsye të justifikuara.

#### Neni 17

#### **Gjurmueshmëria e autorizimit të armëve të zjarrit**

1. Autorizimi për eksport ose import i lëshuar nga vendi përkatës dhe dokumentacioni shoqërues përmbajnë së bashku informacionet e mëposhtme:

- a) datat e lëshimit dhe të përfundimit, sipas rastit;
- b) vendin e lëshimit;
- c) vendin ose vendet e eksportit dhe të daljes;
- ç) vendin e destinacionit;
- d) sipas rastit, çdo vend, vende ose territore përmes së cilave transportohen mallrat e listuara;
- dh) marrësin;
- e) përfutuesin fundor, nëse specifikohet në kohën e dërgesës;

ë) të dhënat që mundësojnë identifikimin e mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, si dhe sasinë e tyre, duke përfshirë, të paktën para dërgimit, markimin e vendosur në armët e zjarrit ose në komponentët kryesorë;

f) zotëruesin e mallrave që mbulohen nga autorizimi për eksport dhe nga autorizimi për import, të lëshuara nga vendet përkatëse, nëse eksportuesi është një ndërmjetës.

2. Eksportuesi i informon paraprakisht dhe të paktën përpara dërgesës vendit importues, vendeve ose territoreve përmes së cilave transportohen mallrat, informacionet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, nëse këto informacione janë pjesë e autorizimit për import të lëshuar nga vendi përkatës.

3. Mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji eksportohen vetëm nëse janë të markuara, në përputhje me legjislacionin në fuqi për armët.

#### Neni 18

#### **Përjashtimi nga kërkesa për një autorizim për eksport**

1. Përjashtohen nga fusha e zbatimit të pikës 1 të nenit 15 të këtij ligji autorizimet për eksport, për eksportin e përkohshëm ose për riekспортin e mallrave të listuara në rastet e:



a) eksportit të përkohshëm nga gjuetarët, rikrijuesit e ngjarjeve historike ose qitësit sportivë të armëve të zjarrit që mbahen në mënyrë të ligjshme prej tyre, si pjesë e objekteve të tyre personale, gjatë udhëtimit në një vend tjetër, me kusht që ata t'i paraqesin autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve nëpërmjet sistemit elektronik të licencimit, të paktën 10 ditë pune përpara nxjerrjes së mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë, sa më poshtë:

i. arsyet e udhëtimit të tyre, veçanërisht duke treguar një ftesë ose prova të tjera për veprimtaritë e gjetisë, të rikrijimeve historike ose të qitjes sportive në vendin e destinacionit;

ii. autorizimin për mbajtjen e armëve të zjarrit, që mbulon armët e zjarrit sipas legjislacionit në fuqi për armët;

iii. informacionin që tregon se armët e zjarrit të renditura në lejen e armëve të zjarrit, si dhe mallrat e tjera krahas armëve të zjarrit, mallra të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, synohen të nxirren jashtë territorit doganor shqiptar, si dhe arsyet që justifikojnë llojin dhe sasinë e këtyre mallrave, të cilat duhet të jenë të përshtatshme në raport me arsyet e udhëtimit. Në çdo rast, sasia e municionit kufizohet deri në maksimumi 800 fishekë për gjuetarët dhe maksimumi 1200 fishekë për qitësit sportivë.

b) riekportit nga gjuetarët, rikrijuesit e ngjarjeve historike ose qitësit sportivë, si pjesë e objekteve të tyre personale, pas pranimit të përkohshëm për aktivitetet e gjetisë, të rikrijimeve historike ose të qitjes sportive, me kusht që:

i. mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji të mbeten në pronësi të një personi rezident jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe këto mallra t'i riekportohen atij personi;

ii. mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji të riekportohen brenda 90 ditëve nga momenti i hyrjes në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë;

iii. numri i referencës së autorizimit për import t'i jepet autoritetit doganor në dalje dhe eksportuesi të përshkruajë numrin e referencës së deklaratës për pranim të përkohshëm në deklaratën e riekportit.

c) mallrave joshqiptare që dalin nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë pas kalimit përmes territorit të një ose më shumë shteteve të tjera, ndërkohë që janë subjekt i një regjimi doganor

të transitit, në rastet kur zyrat doganore të nisjes dhe destinacionit ndodhen të dyja në një vend tjetër;

ç) mallrave shqiptare që dalin përkohësisht nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, të vendosura nën një regjim doganor të transitit, dhe kalojnë përmes një vendi ose territori jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë me destinacion përfundimtar në Republikën e Shqipërisë, me kusht që:

i. transferimi të jetë i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për armët, kur është e nevojshme;

ii. lëvizja e planifikuar t'i njoftohet autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve 10 ditë pune para nëpërmjet sistemit elektronik të licencimit.

2. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve nëpërmjet sistemit elektronik të licencimit i jep një numër reference personit që dorëzon informacionin sipas shkronjës "a" të pikës 1 të këtij neni.

3. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve pezullon procesin e eksportit ose, nëse është e nevojshme, ndalon daljen e mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë për një periudhë jo më të gjatë se 10 ditë pune kur ka dyshime të bazuara se rastet e përmendura në shkronjën "a" të pikës 1 të këtij neni, të paraqitura nga gjuetarët, rikrijuesit e ngjarjeve historike ose qitësit sportivë, nuk janë në përputhje me aspektet dhe detyrimet përkatëse të parashikuara në nenin 19 të këtij ligji. Për arsye të justifikuara kjo periudhë pezullimi mund të zgjatet nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve deri në 30 ditë pune. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve i komunikon autoritetit doganor vendimin për të lejuar çlirimin e mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji ose për të marrë masa të mëtejshme nëpërmjet sistemit elektronik të licencimit.

#### Neni 19

#### Autorizimi i thjeshtuar për eksport

1. Autorizimi i thjeshtuar për eksport kërkohet vetëm në rastet e mëposhtme:

a) riekport brenda 180 ditëve i mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji pas pranimit të tyre të përkohshëm për vlerësim, ekspozim ose përpunim aktiv për riparim, me kusht



që ato mallra të mbeten në pronësi të një personi rezident jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë dhe t'i rieksporthen po atij personi dhe eksportuesi të përshkruajë numrin e referencës së deklaratës për pranim të përkohshëm ose për përpunim aktiv në deklaratën e rieksporit;

b) riekporti i mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji që mbahen në magazinim të përkohshëm brenda afatit kohor të parashikuar në legjislacionin doganor në fuqi;

c) eksport i përkohshëm i mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji me qëllim vlerësimin, ekspozimin ose riparimin, me kusht që eksportuesi të vërtetojë mbajtjen e ligjshme të këtyre mallrave.

2. aplikimi për t'u pajisur me autorizim të thjeshtuar për eksport dërgohet përmes sistemit elektronik të licencimit dhe përfshin të dhënat si më poshtë:

a) përshkrimin e njërit nga rastet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni;

b) emrin, numrin e identifikimit, adresën dhe të dhënat e kontaktit të eksportuesit;

c) të dhënat e çdo arme zjarri, duke përfshirë emrin e prodhuesit ose markën, shtetin ose vendin e prodhimit, numrin e serisë dhe, kur është e mundur, modelin e vitin e prodhimit;

ç) datën dhe numrin unik të referencës së autorizimit për zotërimin ose mbajtjen e një arme zjarri dhe të autorizimit për import nga vendi importues ose, sipas rastit, një referencë për autorizimin, sipas legjislacionit në fuqi për armët, për të prodhuar, blerë, mbajtur ose tregtuar mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji;

d) në rastin e rieksporit të mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, të cilat janë importuar përkohësisht më parë, referencën e deklaratës doganore mbi bazën e së cilës këto mallra janë sjellë në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë.

3. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve trajton aplikimet për autorizim të thjeshtuar për eksport brenda një periudhe jo më të gjatë se 20 ditë pune nga data e dërgimit të të gjithë informacionit të nevojshëm. Për arsye të justifikuara kjo periudhë mund të zgjatet deri në 40 ditë pune. Autorizimi i thjeshtuar për eksport lëshohet përmes sistemit elektronik të licencimit.

4. Për t'u pajisur me autorizimin e thjeshtuar për eksport zbatohen kushtet e mëposhtme:

a) vendi ose vendet e transitit të mos kenë kundërshtime për transitin, sipas pikave 2, 3 dhe 5 të nenit 16 të këtij ligji;

b) autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve të ketë kryer verifikimin sipas pikës 4 të nenit 16 të këtij ligji;

c) kërkuesi të ketë dorëzuar certifikatën e çaktivizimit pranë autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve sipas pikës 6 të nenit 16 të këtij ligji.

5. Autorizimi i thjeshtuar për eksport, i lëshuar sipas shkronjës "c" të pikës 1 të këtij neni, është i vlefshëm për sa kohë nuk tejkalon periudhën e vlefshmërisë së autorizimit për import të lëshuar nga vendi importues ose nuk tejkalon 1 vit kur vendi importues në fjalë nuk specifikon një periudhë vlefshmërie apo kur zbatohet një përjashtim nga kërkesa për autorizim për import.

#### Neni 20

#### Detyrimet e autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve

1. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, në marrjen e vendimit për dhënien ose jo të një autorizimi për eksport ose të një autorizimi të thjeshtuar për eksport sipas këtij ligji, analizon të gjithë faktorët përkatës, duke përfshirë:

a) detyrimet dhe angazhimet e Republikës së Shqipërisë, si palë në marrëveshjet ndërkombëtare përkatëse për kontrollin e eksportit ose në traktatet ndërkombëtare përkatëse;

b) faktorët e politikës së jashtme dhe të sigurisë së brendshme, duke përfshirë ata që mbulohen nga legjislacioni në fuqi për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave dhe teknologjisë ushtarake;

c) faktorët e lidhur me përdorimin e synuar fundor, marrësin, përfituesin e identifikuar fundor dhe rrezikun e devijimit.

2. Krahas faktorëve të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni, kur vlerëson një aplikim për autorizim për eksport ose autorizim të thjeshtuar për eksport, autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve merr në konsideratë nëse eksportuesi zotëron mjete dhe procedura proporcionale dhe të përshtatshme për të garantuar pajtueshmërinë me dispozitat dhe objektivat e këtij ligji dhe me kushtet e përgjithshme të autorizimit.



3. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, në marrjen e vendimit për dhënien ose jo të një autorizimi për eksport ose një autorizimi të thjeshtuar për eksport sipas këtij ligji, respekton çdo detyrim lidhur me masat kufizuese të vendosura nga vendimet e miratuara nga Këshilli i Bashkimit Evropian ose përmes një vendimi të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), ose nga një rezolutë detyruese e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, veçanërisht për sa u përket embargoeve të armëve, si dhe legjislacionit të brendshëm në zbatim të atyre detyrimeve.

4. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve kryen mbikëqyrjen lidhur me përmbushjen e kushteve për autorizimet për eksport dhe autorizimet e thjeshtuara për eksport në bazë të menaxhimit të riskut. Për autorizimet e dhëna për më shumë se 2 vjet kushtet kontrollohen pas 2 vjetësh.

#### Neni 21

### **Refuzimet, anulimet, pezullimet, ndryshimet ose revokimet e autorizimeve për eksport**

1. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve refuzon dhënien e autorizimeve për eksport ose të autorizimeve të thjeshtuara për eksport, nëse ekziston një nga kushtet e renditura, si më poshtë:

a) nuk plotësohen detyrimet dhe aspektet e parashikuara në pikën 1 të nenit 20 të këtij ligji;

b) kërkuesi është një person fizik ndaj të cilit ka filluar ndjekja penale ose është i dënuar për një vepër penale të parashikuar me një dënim penal maksimal prej të paktën 4 vjetësh burgim;

c) arma e zjarrit që do të eksportohet është deklaruar e humbur, e vjedhur ose për të ka një kërkesë sekuestrimi;

ç) kërkuesi është një person juridik ose një nga personat e mëposhtëm të lidhur me këtë person juridik ndodhet në kushtet e shkronjës “b” të këtij neni:

i. kërkuesi;

ii. personat përfaqësues për kërkuesin ose personat që ushtrojnë kontroll mbi menaxhimin e tij.

d) ka indicie të bazuara që sugjerojnë se një nga personat e përfshirë në transaksion përbën një kërcënim ndaj sigurisë ose një kërcënim ndaj sigurisë

publike apo personat e përmendur në shkronjat “b” ose “ç” të kësaj pike nuk mund të plotësojnë detyrimet që u ngarkohen nga legjislacioni në fuqi për armët, nga ky ligj ose nga autorizimet e lëshuara lidhur me armët e zjarrit.

2. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, me qëllim verifikimin e kushteve të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni, merr informacion për dënimet e mëparshme penale të kërkuesit në shtete të tjera, sipas legjislacionit në fuqi për bashkëpunimin në fushën penale.

3. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, me qëllim verifikimin e kushteve të përcaktuara në shkronjën “c” të pikës 1 të këtij neni, kryen verifikime për t’u siguruar që arma e zjarrit nuk është e listuar në sistemet e informacionit në përdorim nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.

4. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve anulon, pezullon, ndryshon ose revokon autorizimin për eksport ose autorizimin e thjeshtuar për eksport, nëse kushtet për dhënien e tij nuk janë përmbushur ose nuk përmbushen më. Në rastin kur autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve merr një vendim të tillë, ia vë menjëherë në dispozicion informacionin autoritetit doganor nëpërmjet sistemit elektronik të licencimit.

5. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, kur pezullon një autorizim për eksport ose një autorizim të thjeshtuar për eksport, ia vë menjëherë në dispozicion vendimin përfundimtar autoriteteve të tjera kompetente shqiptare në fund të periudhës së pezullimit përmes sistemit elektronik të licencimit.

6. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, kur refuzon dhënien e një autorizimi për eksport ose një autorizimi të thjeshtuar për eksport, e regjistron menjëherë vendimin përfundimtar në sistemin elektronik të licencimit.

7. Informacionet e marra sipas këtij neni shkëmbehen sipas nenit 24 të këtij ligji, në kuadër të konfidencialitetit të tyre.

#### Neni 22

### **Vërtetimi i marrjes**

1. Eksportuesi i paraqet autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve që lëshoi autorizimin për eksport përmes sistemit elektronik të licencimit brenda 45 ditëve prej daljes nga territori



doganor i Republikës së Shqipërisë vërtetimin e marrjes së ngarkesës së dërguar të mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji në vendin e importit, duke dorëzuar dokumentet përkatëse doganore të importit.

2. Në mungesë të vërtetimit të marrjes së ngarkesës së dërguar nga eksportuesi, sipas pikës 1 të këtij neni, autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve i kërkon menjëherë autoritetit doganor të eksportit një konfirmim që janë kryer formalitetet doganore lidhur me daljen e mallrave të listuara në shtojcën I dhe që këto mallra të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji kanë dalë jashtë territorit doganor të Republikës së Shqipërisë.

3. Autoritetet doganore, në rast se konfirmojnë kryerjen e formaliteteve doganore dhe të daljes së mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, njoftojnë autoritetin përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, i cili i kërkon autoritetit përkatës të vendit importues të konfirmojë hyrjen e mallrave brenda territorit të tij doganor.

4. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, në rast se nuk merr një konfirmim të hyrjes nga vendi importues, siç parashikohet në pikën 3 të këtij neni, e regjistron këtë informacion në sistemin elektronik të licencimit.

#### KREU IV MBIKËQYRJA DHE KONTROLLET

##### Neni 23

##### **Kontrollet pas dërgesës**

1. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, pas lëshimit të autorizimit për eksport për mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, mund të kryejë kontrole pas dërgesës për t'u siguruar që eksporti i tyre është në përputhje me angazhimet e bëra në deklaratën e përdoruesit, sipas shtojcës IV bashkëlidhur këtij ligji dhe që mallrat kanë mbërritur në destinacionin përfundimtar të planifikuar.

2. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve dhe autoritetet doganore bashkëpunojnë me njëra-tjetrën dhe, nëse është e nevojshme, me autoritetet e vendeve të tjera për të verifikuar pajtueshmërinë me angazhimet e bëra në deklaratën e përdoruesit, sipas shtojcës IV bashkëlidhur këtij ligji dhe mbërritjen e mallrave në destinacionin

përfundimtar të planifikuar. Kontrollet pas dërgesës mund të kryhen, sipas rastit, në vendet e tjera, nëpërmjet bashkëpunimit me autoritetet administrative të vendeve të tjera, me kusht që këto vende të japin pëlqimin e tyre.

##### Neni 24

##### **Shkëmbimi i informacionit dhe bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve**

1. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe autoritetet doganore bashkëpunojnë ngushtësisht dhe shkëmbejnë informacione për të garantuar zbatimin e saktë të këtij ligji.

2. Informacionet për riskun, duke përfshirë analizën e riskut dhe rezultatet e kontrollit, që janë të rëndësishme për zbatimin e kësaj ligji dhe veçanërisht lidhur me dyshimet për trafikimin e paligjshëm të mallrave të listuara, shkëmbehen sipas legjislacionit në fuqi.

3. Shkëmbimi dhe përpunimi i informacionit, i parashikuar në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, kryhet nëpërmjet sistemit të krijuar për këto qëllime nga legjislacioni në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Në rastet kur autoritetet shkëmbejnë informacion të klasifikuar si “konfidencial”, ato e komunikojnë këtë informacion në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi.

4. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet autoriteteve doganore dhe autoriteteve kompetente kryhet nëpërmjet informacionit të përcjellë në rrugë zyrtare nga autoritetet kompetente ose nëpërmjet sistemit elektronik të licencimit.

##### Neni 25

##### **Procedurat për importin dhe eksportin**

1. Me përfundimin e formaliteteve doganore për mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, deklaruesi paraqet në deklaratën doganore ose në deklaratën e rieksporit një referencë të autorizimit të dhënë nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, sipas neneve 10, 12, 15 ose 19 të këtij ligji, ose numrin e referencës së dhënë nga autoriteti kompetent sipas nenit 18 të këtij ligji. Kur përdoret një dokument për përmbushjen e formaliteteve doganore, ky informacion jepet në një nga pjesët e këtij dokumenti.





2. Të gjitha informacionet dhe dokumentacionet e nevojshme për vërtetimin e pajtueshmërisë së mallrave të listuara me këtë ligj jepen nga importuesi ose eksportuesi në përputhje me kërkesën e autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve në gjuhën shqipe.

3. Kur ndërlidhja e përmendur në pikën 4 të nenit 24 të këtij ligji është funksionale, autoriteti doganor verifikon vlefshmërinë e autorizimit nëpërmjet informacionit të përcjellë në rrugë zyrtare nga autoritetet kompetente, pas pranimit të deklaratës doganore ose të deklaratës së rieksporit për mallrat e listuara. Verifikimi kryhet në mënyrë elektronike dhe automatike.

4. Kur autoriteti doganor i çliron mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, në një regjim doganor ose për riekспорт, ky çlirim i mallrave komunikohet në mënyrë elektronike dhe automatike në sistemin elektronik të licencimit. Kur mallrat e listuara vendosen nën një regjim të përkohshëm pranimi ose eksportohen përkohësisht ose riekportohen, duke përdorur një dokument, autoriteti doganor e regjistron informacionin për lëshimin e mallrave në sistemin elektronik të licencimit.

5. Për situata specifike, të cilat nuk janë të parashikuara në legjislacionin doganor në fuqi, autoriteti doganor në zbatim të këtij ligji nuk i çliron mallrat e listuara në një regjim doganor ose për riekспорт, si dhe informon brenda 24 orëve autoritetin përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve nëpërmjet mjeteve të përcaktuara kombëtare ose nëpërmjet sistemit elektronik të licencimit, i cili merr vendim për trajtimin e atyre mallrave, në rast se autoriteti doganor ka dyshime se mallrat janë pjesë e objektit të këtij ligji ose nëse ka dyshime të bazuara, se:

- a) informacioni përkatës nuk është marrë në konsideratë në momentin e dhënies së autorizimit;
- b) rrethanat kanë ndryshuar në mënyrë thelbësore që nga momenti i dhënies së autorizimit;
- c) në rrethana të tjera, mallrat e listuara nuk janë në përputhje me këtë ligj.

6. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve i përgjigjet autoritetit doganor nëpërmjet mjeteve të përcaktuara kombëtare ose nëpërmjet sistemit elektronik të licencimit brenda 10 ditësh punë pas marrjes së informacionit të përmendur në pikën 5 të këtij neni. Për arsye të justifikuara, kjo periudhë mund të zgjatet deri në 30 ditë pune. Në

rast se autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve nuk kthen përgjigje brenda afatit kohor përkatës, autoriteti doganor i çliron mallrat e listuara në përputhje me parashikimet e legjislacionit doganor në fuqi.

Neni 26

### **Zbulimi i një dërgese të papajtueshme**

1. Autoriteti doganor, në rastet kur zbulon një dërgesë të mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, që nuk përputhet me detyrimet e parashikuara në këtë ligj, merr masat e duhura për të garantuar që këto mallra të mbeten nën mbikëqyrje doganore dhe informon autoritetin përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve rreth këtij fakti brenda 24 orëve.

2. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve merr vendim brenda 10 ditësh punë për trajtimin e këtyre mallrave të listuara dhe informon autoritetin doganor për vendimin e tij për të lejuar lëshimin e këtyre mallrave ose për të marrë masa të mëtejshme. Për arsye të justifikuara, kjo periudhë mund të zgjatet deri në 30 ditë pune.

3. Autoriteti doganor sigurohet që vendimi i autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve lidhur me mallrat e listuara nën mbikëqyrje doganore ekzekutohet në përputhje me legjislacionin doganor në fuqi.

4. Në rast se dërgesa e mallrave të listuara që janë të papajtueshme e ka origjinën nga ose destinacionin në Republikën e Shqipërisë, autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve informon menjëherë, nëpërmjet sistemit elektronik të licencimit, autoritetin doganor për masat e marra lidhur me këto mallra dhe për arsyet përkatëse për marrjen e masave.

5. Në rastet kur ka dyshime të arsyeshme për trafikim të paligjshëm të mallrave të listuara, atëherë mallrat sekuestrohen ose mbahen dhe autoriteti doganor ndan menjëherë informacionin lidhur me mallrat e sekuestruara ose të mbajtura gjatë kontrolleve doganore me:

a) autoritetin përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve;

b) autoritetet kompetente të Policisë së Shtetit, të cilat shkëmbejnë informacionin nëpërmjet rrjeteve të shkëmbimit të informacionit në përdorim të saj.



6. Të dhënat e sekuestruara ose të mbajtura përfshijnë informacionin e mëposhtëm, sapo ky informacion të jetë i disponueshëm:

a) të dhënat e armës ose të armëve të zjarrit, duke përfshirë emrin e prodhuesit ose markën, shtetin ose vendin e prodhimit, numrin e serisë dhe vitin e prodhimit, nëse nuk janë pjesë e numrit të serisë, si dhe modelin, kur është e mundur, dhe sasitë;

b) kategorinë ose kategoritë e armës ose armëve të zjarrit, sipas mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji;

c) nëse disponohet, informacionin rreth prodhimit, duke përfshirë mbi riaktivizimin e armëve të zjarrit të çaktivizuara, konvertimin e armëve për alarm dhe sinjalizim, armët e zjarrit artizanale ose të prodhuara me dorë, armët e zjarrit të prodhuara përmes prodhimit aditiv, si dhe çdo informacion tjetër me interes;

ç) vendin e origjinës;

d) vendin e dërgesës;

dh) vendin e destinacionit;

e) mjetet e transportit, duke përfshirë, sipas rastit, “kontejnerë”, “kamionë ose furgonë”, “automjete private”, “autobusë urbanë ose ndërqytetës”, “trena”, “avionë tregtarë”, “avionë civilë” ose “pako mallrash dhe pako postare”, si dhe, sipas rastit, numrin e regjistrimit të mjeteve të përdorura të transportit dhe kombësinë e shoqërisë ose të personit që realizon transportin; dhe

ë) vendin e llojit të sekuestrimit ose të mbajtjes, duke përfshirë, sipas rastit, “territori i brendshëm”, “pikë e kalimit kufitar”, “kufi tokësor”, “aeropot” ose “port detar”.

7. Parashikimi i pikës 1 të nenit 7 të këtij ligji nuk e pengon autoritetin doganor që të zbatojë parashikimet e legjislacionit doganor në fuqi, në rastet kur autoriteti doganor kryen asgjësimin e mallrave të listuara sipas vendimit të autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve. Kostot e asgjësimit mbulohen sipas parashikimeve të legjislacionit doganor në fuqi.

## KREU V

### ADMINISTRIMI, DIGJITALIZIMI DHE BASHKËPUNIMI

#### Neni 27

#### **Ruajtja e informacioneve të lidhura me importin, eksportin dhe riekportin e mallrave të listuara**

1. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve ruan për të paktën 20 vjet të gjitha informacionet që lidhen me importin, eksportin dhe riekportin e mallrave të listuara, gjë që është e nevojshme për të gjurmuar dhe identifikuar ato mallra, si dhe për të parandaluar e zbuluar trafikimin e paligjshëm të tyre.

2. Informacioni i përmendur në pikën 1 të këtij neni përfshin, rast pas rasti, informacionin sipas pikës 1 të nenit 17 të këtij ligji.

3. Pika 1 e këtij neni nuk zbatohet për importet ose eksportet e përmendura në nenet 13, pika 1, shkronja “a”, ose 18, pika 1, shkronjat “a” dhe “b”, të këtij ligji.

#### Neni 28

#### **Statistikat dhe raporti vjetor**

1. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve harton çdo vit, brenda datës 31 janar, një raport vjetor për vitin pararendës për zbatimin e këtij ligji dhe e publikon këtë raport. Raporti përfshin informacionet e mëposhtme:

a) numrin e autorizimeve për import dhe eksport të dhëna gjatë vitit të mëparshëm në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, në nivel kombëtar;

b) sasinë e mallrave të listuara të importuara dhe të eksportuara nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë gjatë vitit të kaluar, sipas kategorive dhe nënkategorive të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, sipas vendit të origjinës dhe të destinacionit, në nivelin kombëtar;

c) vlerën doganore të importeve dhe eksporteve të përmendura në shkronjën “b” të këtij neni në nivel kombëtar;

ç) numrin e refuzimeve të autorizimeve gjatë vitit të mëparshëm dhe arsyet përkatëse;

d) numrin e sekuestrimeve, sasinë e mallrave të listuara, që janë sekuestruara ose janë mbajtur, sipas kategorisë, gjatë vitit të mëparshëm;



dh) sasinë dhe rezultatet e kontrolleve pas dërgesës në nivel kombëtar gjatë vitit të mëparshëm; dhe

e) numrin e shkeljeve dhe sanksioneve lidhur me zbatimin e këtij ligji, në nivel kombëtar, gjatë vitit të mëparshëm.

2. Statistikat dhe raporti vjetor i përmendur në pikën 1 të këtij neni nuk përfshijnë asnjë të dhënë personale, informacion sensitiv tregtar apo informacion të mbrojtur për qëllime të mbrojtjes, të politikës së jashtme ose të sigurisë kombëtare.

#### Neni 29

##### **Tarifat administrative**

1. Çdo aplikim për pajisje me autorizim pranë Autoritetit të Kontrollit Shtetëror të Eksporteve shoqërohet me tarifat përkatëse.

2. Tarifat për të mbuluar kostot administrative të trajtimit të aplikimeve për autorizime caktohen nga Këshilli i Ministrave.

#### Neni 30

##### **Shkeljet e legjislacionit në fushën e kontrollit shtetëror të eksporteve**

Shkeljet e mëposhtme, të kryera nga personat fizikë ose juridikë, kur nuk përbëjnë vepër penale, sipas Kodit Penal, përbëjnë kundërvajtje administrative:

a) kryerja e transferimit ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara në mungesë të autorizimit sipas procedurave ligjore;

b) kryerja e transferimit ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara në bazë të autorizimeve të lëshuara në bazë të dokumenteve false ose të dokumenteve që përmbajnë informacion të rremë;

c) kryerja e transferimeve ndërkombëtare të mallrave të kontrolluara në kundërshtim me kushtet e parashikuara në autorizim, duke përfshirë ndërhyrjen dhe bërjen e ndryshimeve në marrëveshjen/kontratën ekonomike me vendet e huaja pa dijeninë e autoritetit përgjegjës të kontrollit shtetëror të eksporteve, si dhe tek emrat e kushtet e vendosura nga eksportuesi, importuesi, ndërmjetësi dhe përdoruesi i fundit dhe të përshkrimi i mallrave, zotimet për përdorimin e fundit dhe dhënien e garancive;

ç) ndryshimi i destinacionit të mallrave të kontrolluara gjatë transferimeve ndërkombëtare dhe

përdorimi për qëllime të ndryshme apo nga përdoruesi i fundit të tjerë, të ndryshëm nga ajo që është deklaruar në marrëveshjen ose kontratën ekonomike me vendet e huaja dhe në dokumentet e tjera që lidhen me të, në bazë të të cilave është lëshuar autorizimi;

d) fshehja e qëllimshme e informacionit, që mund të ndikojë në marrjen e vendimeve për dhënien e autorizimit;

dh) shkatërrimi i qëllimshëm i dokumenteve që lidhen me transferimin ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara, në bazë të të cilave është lëshuar autorizimi përpara afatit të parashikuar në legjislacionin në fuqi për kontrollin shtetëror të eksporteve;

e) krijimi i pengesave në ushtrimin e detyrës zyrtare nga punonjësit e autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve dhe organet e tjera shtetërore, që kryejnë kontrollin shtetëror të eksporteve, sipas kompetencave ligjore të legjislacionit në fuqi;

ë) refuzimi i pabazuar për dhënien e informacionit dhe të dokumenteve të kërkuara nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve ose nga ndonjë organ tjetër, që kryen kontrollin shtetëror të eksporteve brenda kompetencave të tij ligjore dhe shtrembërimin me dashje apo fshehje të tyre;

f) mosinformimi me shkrim i autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve brenda një afati prej 15 ditësh për çdo ndryshim lidhur me autorizimin e lëshuar;

g) moskthimi i autorizimit që nuk është zbatuar në autoritetin përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve brenda një afati prej 15 ditësh nga data e skadimit të tij.

#### Neni 31

##### **Sanksionet administrative**

1. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve vendos dënim kryesor me gjobë ndaj subjekteve tregtare të përfshira në transferimet ndërkombëtare të produkteve si më poshtë:

a) për shkelje të parashikuara nga shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të nenit 30 të këtij ligji nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë;

b) për shkelje të parashikuara nga shkronjat “d”, “dh” dhe “e” të nenit 30 të këtij ligji nga 200 000



(dyqind mijë) lekë deri në 2 000 000 (dy milionë) lekë;

c) për shkelje të parashikuara nga shkronjat “ë” dhe “p” të nenit 30 të këtij ligji nga 100 000 (njëqind mijë) lekë deri në 1 000 000 (një milion) lekë;

ç) për shkelje të parashikuara nga shkronja “g” të nenit 30 të këtij ligji nga 10 000 (dhjetë mijë) lekë deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë.

2. Subjekteve të pikës 1, përsëritëse të shkeljeve të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni, përveç gjobës, mund t’u caktohet një masë shtesë që ndalon kryerjen e transferimit ndërkombëtar të mallrave të kontrolluara. Masa shtesë e përcaktuar vendoset për një periudhë deri në 3 vjet nga data e vendimit përfundimtar.

3. Vendimi për kundërvajtjen administrative, që parashikon dënimin me gjobë, i vendosur nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, përbën titull ekzekutiv dhe për ekzekutimin e tyre ngarkohet shërbimi përmbarimor.

4. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, përveç sanksioneve administrative, të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij ligji, mund të shfuqizojë autorizimin e dhënë këtyre subjekteve kur ata përsërisin shkeljet apo nuk marrin masa për t’i korrigjuar ato.

5. Në rastet e hetimit penal në lidhje me vepra penale të lidhura me aktivitetin e transferimeve ndërkombëtare apo me sigurinë kombëtare, autorizimi i lëshuar nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve mund të pezullohet deri në përfundim të hetimit të çështjes penale.

#### Neni 32

#### Sistemi elektronik i licencimit

1. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve krijon dhe mirëmban një sistem elektronik licencimi të sigurt dhe të enkriptuar për autorizimet e lëshuara për import, eksport dhe për autorizimet e thjeshtuara për eksport, si dhe për regjistrimet, informacionet dhe vendimet e marra që lidhen me to.

2. Sistemi elektronik i licencimit i përmendur në pikën 1 të këtij neni ofron të paktën funksionalitetet e mëposhtme:

a) mundëson regjistrimin e personave, që gëzojnë të drejtën të kërkojnë autorizime, përjashtime ose

lehtësira administrative, sipas këtij ligji, përpara dërgimit të aplikimit të parë dhe, sipas rastit, përfshirjen e numrit të regjistrimit dhe identifikimit të operatorëve ekonomikë NUIS/NIPT në profilin e regjistrimit, sipas parashikimeve të legjislacionit doganor në fuqi;

b) mundëson që përmes procedurës elektronike të kërkohet, të jepet, të lëshohet dhe të ruhet një autorizim për përjashtim ose lehtësi administrative sipas këtij ligji;

c) mundëson ndërlidhjen me sistemet kombëtare elektronike të licencimit, përmes së cilave mund të kërkohen, të jepen dhe të lëshohen autorizime për përjashtime ose lehtësira administrative;

ç) mundëson ndërlidhjen me autoritetet kombëtare doganore dhe Policinë e Shtetit, duke përfshirë menaxhimin e sasisë së mallrave të autorizuar;

d) mundëson profilizimin e riskut nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve dhe autoritetet doganore të personave të autorizuar ose të regjistruar sipas këtij ligji për të importuar, eksportuar ose rieksportuar mallra të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, si dhe profilizimin e këtyre mallrave, duke përfshirë paralajmërimet automatike lidhur me dokumentacionin e munguar të vërtetimit të marrjes;

dh) Mundëson dhënien e ndihmës administrative dhe bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente për shkëmbimin e informacionit dhe statistikave lidhur me përdorimin e sistemit elektronik të licencimit;

e) mundëson shkëmbimin e informacionit, duke përfshirë atë për refuzimet dhe arsyet për refuzimin e autorizimeve, ndërmjet autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve dhe autoriteteve kompetente të vendeve të tjera në kuadër të zbatimit të këtij ligji;

ë) mundëson komunikimin ndërmjet autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve dhe personave që kërkojnë një autorizim për përjashtim ose lehtësi administrative, si dhe ngarkimin e vërtetimeve të marrjes;

f) mundëson komunikimin ndërmjet autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve dhe autoriteteve doganore në kuadër të zbatimit të këtij ligji;

g) mundëson aksesin në statistika, si: numri i autorizimeve, sasisë dhe vlerat e importeve dhe eksporteve faktike, numri i refuzimeve për dhënien



e një autorizimi lidhur me mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, si dhe arsyet përkatëse, duke përfshirë sipas origjinës dhe destinacionit, me përjashtim të të dhënave personale.

3. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve siguron akses në sistemin elektronik të licencimit për:

a) autoritetet shtetërore, Policinë e Shtetit dhe autoritetet doganore, me qëllim përmbushjen e detyrimeve të tyre sipas këtij ligji dhe sipas legjislacionit doganor;

b) personat që kërkojnë një autorizim për përjashtim ose lehtësi administrative, të cilët kanë akses vetëm në informacionin që lidhet me ta.

4. Përpunimi i të dhënave personale brenda sistemit elektronik të licencimit kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

## KREU VI PARANDALIMI I SHKELJEVE DHE PËRGJEGJËSITË E AUTORITETIT TË KONTROLLIT SHTETËROR TË EKSPORTEVE

### Neni 33 Procedurat e sigurta

1. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve merr masat e nevojshme për të siguruar që procedurat e autorizimit janë të sigurta dhe se vërtetësia e dokumenteve të autorizimit mund të verifikohet ose të vërtetohet.

2. Autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, sipas rastit, siguron verifikimin dhe vërtetimin e procedurave e të dokumenteve nëpërmjet kanaleve diplomatike.

### Neni 34 Detyrat e autoritetit përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve

1. Për të siguruar zbatimin e duhur të këtij ligji, autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve ka këto detyra:

a) garanton përmes të gjitha masave të nevojshme zbatimin e këtij ligji, duke përfshirë, sipas rastit, konfiskimin dhe shitjen ose asgjësimin e

mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji;

b) mbledh informacion për çdo porosi ose transaksion, që përfshin mallrat e listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji;

c) përcakton nëse po përmbushen siç duhet detyrimet e një personi, në kuadër të këtij ligji, çka përfshin, në veçanti, kompetencën për të hyrë në ambientet e personit në fjalë ose të personave të tjerë me interes në transaksionin përkatës.

2. Pas marrjes së vendimit përfundimtar nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, në përputhje me kompetencat e saj ligjore, ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi. Zbatimi konsiston në marrjen dhe ekzekutimin e masave të përcaktuara, përfshirë konfiskimin e mallrave, objekt shkeljeje, si dhe, sipas rastit dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, shkatërrimin ose shitjen e tyre, duke garantuar respektimin e procedurave ligjore dhe mbrojtjen e interesit publik.

3. Me kërkesë të një shteti eksportues, që është palë në Protokollin e OKB-së për armët e zjarrit në momentin e eksportit, autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve lëshon autorizimin për import, që është përdorur për eksport nga vendi eksportues, konfirmon importin ose ruajtjen e përkohshme të mallrave të listuara në shtojcën I bashkëlidhur këtij ligji, të paraqitura në autorizimin për import.

### Neni 35 E drejta e ankimit

Vendimi i marrë nga autoritetet e përcaktuara në nenet 21 dhe 34, pika 2, të këtij ligji për të vendosur gjobë, konfiskim, shkatërrim, shitje, pezullim, anulim, ndryshim ose revokim të autorizimit, ankimohet në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative.

## KREU VII DISPOZITA TË FUNDIT DHE TRANZITORE

### Neni 36 Nxjerrja e akteve nënligjore

Këshilli i Ministrave brenda 6 muajve nga miratimi i këtij ligji miraton aktet nënligjore të



parashikuara në nenet 9, pika 2, 12, pika 6, dhe 29, pika 2, të këtij ligji.

Neni 38  
**Hyrja në fuqi**

Neni 37  
**Dispozitë tranzitore**

Deri në ngritjen e infrastrukturës së dedikuar për autorizimet e lëshuara për import, eksport dhe për autorizimet e thjeshtuara për eksport, si dhe për regjistrimet, informacionet dhe vendimet e marra, autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve do të operojë nëpërmjet portalit “e-Albania” për licencimin e subjekteve.

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 28.1.2026.

**Shpallur me dekretin nr. 55, datë 11.2.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.**

**SHTOJCA I**

**I. Lista e armëve të zjarrit dhe municioneve**

| PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                                                                    | KODI NK                                                                                         |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Kategoria “A” – Armët e ndaluara të zjarrit                                                                                                                                                                                                                                                                   |                                                                                                 |
| (1) Predhat ushtarake plasëse dhe sistemet për lëshim.                                                                                                                                                                                                                                                        | 9301 10 00<br>9301 20 00<br>9306 90 10                                                          |
| (2) Armët e zjarrit automatike.                                                                                                                                                                                                                                                                               | 9301 90 00                                                                                      |
| (3) Armët e zjarrit të kamufluara në formë të një mjeti tjetër.                                                                                                                                                                                                                                               | ex 9302 00 00<br>ex 9303 10 00<br>ex 9303 90 00<br>9301 90 00<br>ex 9303 20 10<br>ex 9303 20 95 |
| (4) Municioni me shkallë të lartë depërtuese, municioni me predha shpërthyes ose me predha ndezëse si dhe predhat për një municion të tillë.                                                                                                                                                                  | 9306 30 30<br>9306 90 10<br>ex 9306 21 00                                                       |
| (5) Municioni për pistoletë dhe pistoletë me mull me predhë shpërndarëse dhe hapëse, si dhe predhat për një municion të tillë, përveç rasteve të armëve për gjueti ose ato sportive të personave që kanë të drejtë t’i përdorin ato.                                                                          | ex 9306 30 10<br>9306 30 30                                                                     |
| (6) Armët e zjarrit automatike që janë konvertuar në armë zjarri gjysmautomatike.                                                                                                                                                                                                                             | 9301 90 00<br>ex 9302 00 00                                                                     |
| (7) Secila nga armët e zjarrit gjysmautomatike me ndezje qendrore, më poshtë:                                                                                                                                                                                                                                 | ex 9302 00 00                                                                                   |
| a) armë zjarri të shkurtra që shkrepin më shumë se 21 fishekë pa rimbushje, nëse:<br>- krehri me kapacitet mbi 20 fishekë është pjesë e kësaj arme zjarri, ose<br>- krehri i çmontueshëm me kapacitet mbi 20 fishekë futet në armën e zjarrit;                                                                |                                                                                                 |
| b) armë zjarri të gjata që shkrepin më shumë se 11 fishekë pa rimbushje, nëse:<br>- krehri me kapacitet mbi 10 fishekë është pjesë e kësaj arme zjarri, ose<br>- krehri i çmontueshëm me kapacitet mbi 10 fishekë futet në armën e zjarrit.                                                                   | ex 9303 30 00<br>9301 90 00<br>ex 9303 90 00<br>ex 9303 20 10<br>ex 9303 20 95                  |
| (8) Armë zjarri të gjata gjysmautomatike, si p.sh.: armët e zjarrit që fillimisht janë synuar të mbështeten në sup, të cilat mund të reduktohen në një gjatësi nën 60 cm, pa humbur funksionalitetin, me anë të një baze me palosje ose teleskopike ose një baze që mund të hiqet pa përdorur vegla të tjera. | 9301 90 00<br>ex 9303 20 10<br>ex 9303 20 95<br>ex 9303 30 00<br>ex 9303 90 00                  |
| (9) Çdo armë zjarri në këtë kategori që është konvertuar për të shkrepur fishekë manovre, substanca irrituese, substanca të tjera aktive ose fishekë piroteknike ose armë të sinjalizimit akustik.                                                                                                            | 9301 90 00<br>ex 9302 00 00<br>ex 9303 20 10                                                    |



| PËRSHKRIMI                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | KODI NK                                                                           |
|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|
|                                                                                                              |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | ex 9303 20 95<br>ex 9303 30 00<br>ex 9303 90 00                                   |
| Kategoria “B” – Armët e zjarrit që i nënshtrohen autorizimit                                                 |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |                                                                                   |
| (1)                                                                                                          | Armë zjarri të shkurtra me përsëritje.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | ex 9302 00 00                                                                     |
| (2)                                                                                                          | Armë zjarri të shkurtra për një qitje, me ndezje qendrore.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | ex 9302 00 00                                                                     |
| (3)                                                                                                          | Armë zjarri të shkurtra me ndezje anësore, për një qitje, me gjatësi të përgjithshme deri në 28 cm.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                         | ex 9302 00 00                                                                     |
| (4)                                                                                                          | Armë zjarri të gjata gjysmautematike, me pajisje mbushëse dhe fole fishekësh, që së bashku mund të mbajnë më tepër se tre fishekë në rastin e armëve të zjarrit me ndezje anësore dhe më tepër se tre, por më pak se dymbëdhjetë fishekë në rastin e armëve të zjarrit me ndezje qendrore.                                                                                                                                  | ex 9303 20 10<br>ex 9303 20 95<br>ex 9303 30 00<br>ex 9303 90 00                  |
| PËRSHKRIMI                                                                                                   |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             | KODI NK                                                                           |
| (5)                                                                                                          | Armë zjarri të shkurtra gjysmautematike, përveç atyre të renditura në pikën 7 (a) të kategorisë “A”.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                        | ex 9302 00 00                                                                     |
| (6)                                                                                                          | Armë zjarri të gjata gjysmautematike, të renditura në pikën 7 (b) të kategorisë A, me pajisje mbushëse dhe fole fishekësh që së bashku, mund të pranojnë deri në tre fishekë, në rastin kur mbushësi i tyre mund të ndërrohet ose nëse nuk është e sigurt që këto armë nuk mund të konvertohen, me mjete të zakonshme, në një armë, mbushësi dhe foleja e fishekëve të së cilës pranojnë së bashku më tepër se tre fishekë. | ex 9303 20 10<br>ex 9303 20 95<br>ex 9303 30 00<br>ex 9303 90 00                  |
| (7)                                                                                                          | Armë zjarri të gjata me përsëritje dhe gjysmautematike me tytë të pavjaskuar me gjatësi deri në 60 cm.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | ex 9303 20 10<br>ex 9303 20 95                                                    |
| (8)                                                                                                          | Çdo armë zjarri në këtë kategori që është konvertuar për të shkrepur fishekë manovre, substanca irrituese, substanca të tjera aktive ose fishekë piroteknikë ose armë të sinjalizimit akustik.                                                                                                                                                                                                                              | ex 9302 00 00<br>ex 9303 20 10<br>ex 9303 20 95<br>ex 9303 30 00<br>ex 9303 90 00 |
| (9)                                                                                                          | Armë zjarri gjysmautematike për përdorim civil të ngjashme me armët me mekanizma automatikë përveç atyre të renditura në pikat 6, 7 ose 8 të kategorisë “A”.                                                                                                                                                                                                                                                                | ex 9302 00 00<br>ex 9303 20 10<br>ex 9303 20 95<br>ex 9303 30 00<br>ex 9303 90 00 |
| Kategoria “C” – Armët e zjarrit që i nënshtrohen deklarimit                                                  |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |                                                                                   |
| (1)                                                                                                          | Armë zjarri të gjata me përsëritje përveç atyre të renditura në pikën 7 të kategorisë “B”.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | ex 9303 20 95<br>ex 9303 30 00<br>ex 9303 90 00                                   |
| (2)                                                                                                          | Armë zjarri të gjata me një qitje, me tytë të vjaskuar.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                     | ex 9303 20 95<br>ex 9303 30 00<br>ex 9303 90 00                                   |
| (3)                                                                                                          | Armë zjarri të gjata gjysmautematike, përveç atyre të renditura në kategorinë “A” ose “B”.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                  | ex 9303 30 00<br>ex 9303 20 10<br>ex 9303 20 95<br>ex 9303 90 00                  |
| (4)                                                                                                          | Armë zjarri të shkurtra me një qitje me ndezje anësore, me gjatësi të përgjithshme jo më pak se 28 cm.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                      | ex 9302 00 00                                                                     |
| (5)                                                                                                          | Çdo armë zjarri në këtë kategori që është konvertuar për të shkrepur fishekë manovre, substanca irrituese, substanca të tjera aktive ose fishekë piroteknikë ose armë të sinjalizimit akustik.                                                                                                                                                                                                                              | ex 9303 20 10<br>ex 9303 20 95<br>ex 9303 30 00<br>ex 9303 90 00                  |
| (6)                                                                                                          | Armët e zjarrit të klasifikuara në kategorinë “A” ose “B” ose në këtë kategori, të cilat janë çaktivizuar, në përputhje me ligjin 74/2014, “Për armët”.                                                                                                                                                                                                                                                                     | ex 9304 00 00                                                                     |
| (7)                                                                                                          | Armë zjarri të gjata me një qitje me tytë të pavjaskuar të vendosura në treg më ose pas datës 14 shtator 2018.                                                                                                                                                                                                                                                                                                              | 9303 10 00<br>ex 9303 20 10<br>ex 9303 20 95                                      |
| II. Armët e zjarrit dhe municionet, përveç atyre të renditura në pjesën I dhe komponentët kryesorë përkatës. |                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                             |                                                                                   |
| (1)                                                                                                          | Koleksionet dhe pjesët e koleksionistëve me interes historik.                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                               | ex 9705 10 00<br>ex 9706 10 00<br>ex 9706 90 00                                   |



| PËRSHKRIMI                                                                                                                                                                                                                                                          | KODI NK                                                                                                                           |
|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| (2) Municion: e gjithë shtimja apo bashkimi i komponentëve të saj, duke përfshirë gëzhhojen, kapsollën, barutin, plumbin ose predhën që përdoren në një armë zjarri, me kusht që edhe vetë këta komponentë të jenë objekt i autorizimit në shtetin anëtar përkatës. | ex 3601 00 00<br>9306 21 00<br>ex 9306 29 00<br>ex 9306 30 10<br>ex 9306 30 30<br>ex 9306 30 90<br>ex 9306 90 10<br>ex 9306 90 90 |
| (3) Çdo komponent kryesor i armëve të zjarrit, qoftë edhe gjysmë i përfunduar, duke përfshirë armët e zjarrit gjysmë të përfunduara.                                                                                                                                | ex 9305 10 00<br>ex 9305 20 00<br>ex 9305 91 00<br>ex 9305 99 00                                                                  |
| III. Armët e pakonvertueshme për alarm dhe sinjalizim                                                                                                                                                                                                               |                                                                                                                                   |
| (1) Armët e pakonvertueshme për alarm dhe sinjalizim të përmendura në nenin 8 të këtij ligji.                                                                                                                                                                       | ex 9303 90 00<br>ex 9304 00 00                                                                                                    |
| IV: Zhurmëmbytesit                                                                                                                                                                                                                                                  |                                                                                                                                   |
| (1) Zhurmëmbytesit.                                                                                                                                                                                                                                                 | ex 9305 10 00                                                                                                                     |

Për qëllime të kësaj shtojce:

a) “Armë zjarri e shkurtër” është arma e zjarrit me tytë me gjatësi deri në 30 centimetra ose me gjatësi të përgjithshme deri në 60 centimetra;

b) “Armë zjarri e gjatë” është çdo armë zjarri, përveç armëve të zjarrit të shkurtra;

c) “Armë zjarri automatike” është arma e zjarrit, e cila mbushet automatikisht sa herë që shkrepët fisheku dhe që mund të shkrepë më shumë se një fishek me një tërheqje të këmbëzës;

ç) “Armë zjarri gjysmautomatike” është arma e zjarrit, e cila mbushet automatikisht sa herë që shkrepët fisheku dhe që mund të shkrepë vetëm një fishek me një tërheqje të këmbëzës;

d) “Armë zjarri me përsëritje” është arma e zjarrit, e cila, pas shkrepjes së fishekut, duhet të rimbushet manualisht nga krehri apo nga mulliri;

dh) “Armë zjarri me një qitje” është arma e zjarrit pa krehër, e cila mbushet para çdo shkrepjeje, përmes futjes me dorë të fishekut në fole apo në hapjen për mbushje në të prerën e tytës.

(1) Bazuar në Nomenklaturën e Kombinuar të mallrave, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për nomenklaturën tarifore dhe statistikore dhe për tarifat doganore.

(2) Kur përpara kodit të Nomenklaturës së Kombinuar (NK) jepet një kod “ex”, objekti përcaktohet duke u bazuar bashkërisht në kodin NK dhe përshkrimin përkatës.

## SHTOJCA II

(referuar në nenin 10 të këtij ligji)

Kur jep autorizime për import, AKSHE-ja duhet të bëjë përpjekje për të garantuar vizibilitetin e natyrës së autorizimit në formularin e lëshuar.

Ky është një autorizim për import, i vlefshëm deri në datën e tij të skadimit.

|                                                                           |                                                                                                                                            |
|---------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| REPUBLIKA E SHQIPËRISË                                                    | IMPORTI I ARMËVE TË ZJARRIT (ligji nr. ____/____ <sup>(2)</sup> )                                                                          |
| Lloji i autorizimit                                                       |                                                                                                                                            |
| I vetëm <input type="checkbox"/>                                          | I shumëfishtë <input type="checkbox"/> Kombëtar i përgjithshëm <input type="checkbox"/>                                                    |
| A zbatohen lëvizjet përpara importit? Po <input type="checkbox"/>         | A zbatohet regjimi i transitit për mallrat jo të BE-së? Po <input type="checkbox"/>                                                        |
| Armë të pakonvertueshme për alarm dhe sinjalizim <input type="checkbox"/> | Armë zjarri të çaktivizuara me certifikatë <input type="checkbox"/><br>Armë zjarri të çaktivizuara pa certifikatë <input type="checkbox"/> |

<sup>2</sup> Ligji nr. ...., datë ....., “Për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit, komponentëve të tyre kryesorë dhe municioneve”.





|                                                                                      |                                                                                                                                              |                                                                                                 |                                                        |
|--------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------|
| 1.                                                                                   | 1. Nr. i importuesit<br>(Numri NUIS/NIPT, sipas rastit)                                                                                      | 2. Numri i identifikimit të autorizimit ()                                                      | 3. Data e skadimit                                     |
| Autorizimi                                                                           | 4. Të dhënat e pikës së kontaktit                                                                                                            |                                                                                                 |                                                        |
|                                                                                      | 5. Marrësi(t) (Numri NUIS/NIPT, sipas rastit)                                                                                                | 6. Autoriteti lëshues                                                                           |                                                        |
|                                                                                      | 7. Nr. i agjentit(ëve)/përfaqësuesit(ve)<br>(Nëse është i ndryshëm nga eksportuesi)<br>(Numri NUIS/NIPT, sipas rastit)                       | 8. Vendet e importit                                                                            | Kodi                                                   |
|                                                                                      |                                                                                                                                              | 9. Vendet e eksportit dhe numrat e autorizimeve për eksport                                     | Kodi                                                   |
|                                                                                      | 10. Përfituesit fundorë (nëse dihen në kohën e dërgesës) (numri NUIS/NIPT, sipas rastit)                                                     | 11. Vendet përmes së cilave kalon dërgesa (sipas rastit)                                        | Kodi                                                   |
|                                                                                      |                                                                                                                                              | 12. Piken doganore ku do kryhet importi                                                         | Kodi                                                   |
|                                                                                      | 13. Përshkrimi i artikujve                                                                                                                   | 14. Kodi i sistemit të harmonizuar ose i nomenklaturën e kombinuar (sipas rastit - me 8 shifra) |                                                        |
|                                                                                      | 13.a. Markim<br>Në përputhje me Protokollin e Kombeve të Bashkuara për armët e zjarrit.<br>Në përputhje me legjislacionin në fuqi për armët. | 15. Monedha dhe vlera                                                                           | 16. Sasia e artikujve                                  |
|                                                                                      | 17. Përdorimi fundor                                                                                                                         | 18. Data e kontratës (sipas rastit)                                                             | 19. Procedura doganore                                 |
|                                                                                      | 20. Informacion shtesë i kërkuar nga legjislacioni kombëtar (të specifikohet në formular)                                                    |                                                                                                 |                                                        |
| Disponohet për informacione të printuara paraprakisht në gjykimin e shteteve anëtare |                                                                                                                                              |                                                                                                 |                                                        |
|                                                                                      |                                                                                                                                              | Për t'u plotësuar nga autoriteti lëshues                                                        |                                                        |
|                                                                                      |                                                                                                                                              | Nënshkrimi                                                                                      | Vula                                                   |
|                                                                                      |                                                                                                                                              | Autoriteti lëshues                                                                              |                                                        |
|                                                                                      |                                                                                                                                              | Vendi dhe data                                                                                  |                                                        |
| REPUBLIKA E SHQIPËRISË                                                               |                                                                                                                                              |                                                                                                 |                                                        |
| 1a.                                                                                  | 1. Importuesi                                                                                                                                | 2. Numri i identifikimit                                                                        | 9. Vendi i importit dhe numri i autorizimit për import |
| Autorizimi                                                                           |                                                                                                                                              | 5. Marrësi                                                                                      |                                                        |
|                                                                                      | 13.1. Përshkrimi i artikujve                                                                                                                 | 14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)                                                   |                                                        |
|                                                                                      | 13.a. Markim                                                                                                                                 | 15. Monedha dhe vlera                                                                           | 16. Sasia e artikujve                                  |
|                                                                                      | 13.2. Përshkrimi i artikujve                                                                                                                 | 14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)                                                   |                                                        |
|                                                                                      | 13.a. Markim                                                                                                                                 | 15. Monedha dhe vlera                                                                           | 16. Sasia e artikujve                                  |
|                                                                                      | 13.3. Përshkrimi i artikujve                                                                                                                 | 14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)                                                   |                                                        |
|                                                                                      | 13.a. Markim                                                                                                                                 | 15. Monedha dhe vlera                                                                           | 16. Sasia e artikujve                                  |
|                                                                                      | 13.4. Përshkrimi i artikujve                                                                                                                 | 14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)                                                   |                                                        |
|                                                                                      | 13.a. Markim                                                                                                                                 | 15. Monedha dhe vlera                                                                           | 16. Sasia e artikujve                                  |



|                                                                                                                                                                                                                             |                                          |                                                                                 |                                                         |
|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------|
|                                                                                                                                                                                                                             | 13.5. Përshkrimi i artikujve             | 14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)                                   |                                                         |
|                                                                                                                                                                                                                             | 13.a. Markim                             | 15. Monedha dhe vlera                                                           | 16. Sasia e artikujve                                   |
|                                                                                                                                                                                                                             | 13.6. Përshkrimi i artikujve             | 14. Kodi i mallit (sipas rastit, me 8 shifra)                                   |                                                         |
|                                                                                                                                                                                                                             | 13.a. Markim                             | 15. Monedha dhe vlera                                                           | 16. Sasia e artikujve                                   |
| Shënim: Për çdo marrës plotësohet një formular i veçantë, në përputhje me formatin 1a. Në pjesën 1 të kolonës 22, tregoni sasinë ende të disponueshme dhe në pjesën 2 të kolonës 22, tregoni sasinë e zbritur në këtë rast. |                                          |                                                                                 |                                                         |
| 21. Sasia/vlera neto (masa neto/njësi tjetër e specifikuar)                                                                                                                                                                 |                                          | 24. Dokumenti doganor (lloji dhe numri) ose ekstrakti (Nr.) dhe data e zbritjes | 25. Shteti anëtar, emri dhe nënshkrimi, vula e zbritjes |
| 22. Në shifra                                                                                                                                                                                                               | 23. Me fjalë për sasinë/vlerën e zbritur |                                                                                 |                                                         |
| 1.                                                                                                                                                                                                                          |                                          |                                                                                 |                                                         |
| 2.                                                                                                                                                                                                                          |                                          |                                                                                 |                                                         |
| 1.                                                                                                                                                                                                                          |                                          |                                                                                 |                                                         |
| 2.                                                                                                                                                                                                                          |                                          |                                                                                 |                                                         |
| 1.                                                                                                                                                                                                                          |                                          |                                                                                 |                                                         |
| 2.                                                                                                                                                                                                                          |                                          |                                                                                 |                                                         |
| 1.                                                                                                                                                                                                                          |                                          |                                                                                 |                                                         |
| 2.                                                                                                                                                                                                                          |                                          |                                                                                 |                                                         |
| 1.                                                                                                                                                                                                                          |                                          |                                                                                 |                                                         |
| 2.                                                                                                                                                                                                                          |                                          |                                                                                 |                                                         |
| 1.                                                                                                                                                                                                                          |                                          |                                                                                 |                                                         |
| 2.                                                                                                                                                                                                                          |                                          |                                                                                 |                                                         |
| 1.                                                                                                                                                                                                                          |                                          |                                                                                 |                                                         |
| 2.                                                                                                                                                                                                                          |                                          |                                                                                 |                                                         |

## SHTOJCA III

(e përmendur në nenin 15 të këtij ligji)

Kur jep autorizime për eksport, AKSHE-ja duhet të bëjë përpjekje për të garantuar vizibilitetin e natyrës së autorizimit në formularin e lëshuar.

Ky është një autorizim për eksport i vlefshëm në Republikën e Shqipërisë deri në datën e tij të skadimit.

|                                                                            |                                                                  |                                                          |                    |
|----------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------|--------------------|
| REPUBLIKA E SHQIPËRISË                                                     |                                                                  | EKSPORTI I ARMËVE TË ZJARRIT ligji nr. ____.             |                    |
| Lloji i autorizimit                                                        |                                                                  |                                                          |                    |
| I vetëm <input type="checkbox"/>                                           |                                                                  | I shumëfishtë <input type="checkbox"/>                   |                    |
| A zbatohet transiti brenda BE-së pas eksportit Po <input type="checkbox"/> |                                                                  |                                                          |                    |
| Armë të pakonvertueshme për alarm dhe sinjalizim <input type="checkbox"/>  |                                                                  | Armët e zjarrit të çaktivizuara <input type="checkbox"/> |                    |
| 1. Pronari (sipas rastit)                                                  | 1. Nr. i aplikantit/eksportuesit (numri NUIS/NIPT, sipas rastit) | 2. Numri i identifikimit të autorizimit ()               | 3. Data e skadimit |
|                                                                            |                                                                  | 4. Të dhënat e pikës së kontaktit                        |                    |
|                                                                            | 5. Marrësi(t) (Numri NUIS/NIPT, sipas rastit)                    | 6. Autoriteti lëshues                                    |                    |



|                   |                                                                                                                                            |                                                                                                 |                                   |      |
|-------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------|------|
| <b>Autorizimi</b> | 7. Nr. i agentit(ëve)/përfaqësuesit(ve)<br>(Nëse është i ndryshëm nga aplikanti/mbajtësi i autorizimit)<br>(Numri NUIS/NIPT, sipas rastit) | 8. Vendet e eksportit                                                                           |                                   | Kodi |
|                   |                                                                                                                                            | 9. Vendet e importit dhe numrat e autorizimeve për import                                       |                                   | Kodi |
|                   | 10. Përfituesit fundorë (nëse dihen në kohën e dërgesës)<br>(numri NUIS/NIPT, sipas rastit)                                                | 11. Vendet e përmes së cilave kalon dërgesa (sipas rastit)                                      |                                   | Kodi |
|                   |                                                                                                                                            | 12. Piken doganore ku do kryhet eksporti                                                        |                                   | Kodi |
|                   | 13. Përshkrimi i artikujve                                                                                                                 | 14. Kodi i sistemit të harmonizuar ose i nomenklaturës e kombinuar (sipas rastit - me 8 shifra) |                                   |      |
|                   | 13.a. Markim                                                                                                                               | 15. Monedha dhe vlera                                                                           | 16. Sasia e artikujve             |      |
|                   | 17. Përdorimi fundor                                                                                                                       | 18. Data e kontratës (sipas rastit)                                                             | 19. Procedura e eksportit doganor |      |
|                   | 20. Informacion shtesë i kërkuar nga legjislacioni kombëtar (të specifikohet në formular)                                                  |                                                                                                 |                                   |      |
|                   | Disponohet për informacione të printuara paraprakisht në gjykimin e AKSHE                                                                  |                                                                                                 |                                   |      |
|                   |                                                                                                                                            | Për t'u plotësuar nga autoriteti lëshues                                                        |                                   |      |
|                   |                                                                                                                                            | Nënshkrimi                                                                                      | Vula                              |      |
|                   |                                                                                                                                            | Autoriteti lëshues                                                                              |                                   |      |
|                   |                                                                                                                                            | Vendi dhe data                                                                                  |                                   |      |

## SHTOJCA IV

## Formulari i deklaratës së përdoruesit

Deklarata e përdoruesit duhet të përfshijë të paktën informacionin e mëposhtëm:

- a) të dhënat e eksportuesit (duke përfshirë emrin, adresën, emrin e biznesit dhe, nëse disponohet, NUIS/NIPT-in e shoqërisë);
- b) të dhënat e përdoruesit (duke përfshirë emrin, adresën, emrin e biznesit dhe, nëse disponohet, NUIS/NIPT-in e shoqërisë);
- c) vendin e destinacionit përfundimtar;
- ç) një përshkrim të mallrave, duke përfshirë, nëse disponohet, numrin e kontratës ose numrin e porosisë;
- d) sipas rastit, sasinë ose vlerën e mallrave të destinuara për eksport;
- dh) nënshkrimin, emrin dhe titullin e përdoruesit;
- e) autoritetin kombëtar kompetent në vendin e destinacionit përfundimtar;
- ë) një autorizim për import ose certifikatë të lëshuar nga autoritetet përkatëse kombëtare (duke përfshirë datën, emrin, titullin dhe nënshkrimin origjinal të zyrtarit autorizues), kur diçka e tillë kërkohej nga legjislacioni kombëtar ose praktika e vendit të importues;
- f) datën e lëshimit të deklaratës së përdoruesit;
- g) sipas rastit, një numër unik identifikimi ose numrin e kontratës që lidhet me deklaratën e përdoruesit;
- gj) një angazhim se produktet do të përdoren vetëm për qëllime civile; dhe
- h) sipas rastit, të dhënat e ndërmjetësit përkatës (duke përfshirë emrin, adresën, emrin e biznesit dhe, nëse disponohet, NUIS/NIPT-in e shoqërisë).

**DEKRET**

Nr. 55, datë 11.2.2026

**PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

**DEKRETOJ:**

Shpalljen e ligjit nr. 13/2026, “Për importin, eksportin dhe transitin e armëve të zjarrit, të komponentëve të tyre kryesorë dhe të municioneve”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS  
SË SHQIPËRISË  
**Bajram Begaj**

**VENDIM**

Nr. 97, datë 11.2.2026

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË  
GRANTIT SHOQËRUES NDËRMJET  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
(MARRËSI), TË PËRFAQËSUAR  
NGA MINISTRIA E FINANCIVE,  
DHE KORPORATËS  
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE  
(KESH) (AGJENCIA E ZBATIMIT TË  
PROJEKTIT) DHE *KfW, FRANKFURT  
AM MAIN (KfW)*, MASAT SHOQËRUESE  
PËR PROJEKTIN “REHABILITIMI I  
HIDROCENTRALIT TË FIERZËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Miratimin e marrëveshjes së grantit shoqërues ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) (agjencia e zbatimit të projektit) dhe *KfW, Frankfurt am Main (KfW)*, masat shoqëruese për projektin

“Rehabilitimi i hidrocentralit të Fierzës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**

**MARRËVESHJE SHOQËRUESE GRANTI  
E DATËS 15.12.2025 NDËRMJET KfW,  
FRANKFURT AM MAIN (“KfW”) DHE  
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (“MARRËSI”)  
TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E  
FINANCIVE DHE KORPORATËS  
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE  
(KESH) (“AGJENCIA EKZEKUTUESE E  
PROJEKTT”) PËR SHUMËN  
1,000,000.00 EURO**

**- Masat Shoqëruese për Projektin Rehabilitimi  
i Hidrocentralit të Fierzës -  
BMZ-Nr. 2023 70 245**

**PËRMBAJTJA**

Neni

1. Shuma dhe qëllimi i Grantit
  2. Kanalizimi i Grantit tek Agjencia Ekzekutuese e Projektit
  3. Disbursimi
  4. Pezullimi i Disbursimit dhe Shlyerja
  5. Kostot dhe Tarifatat Publike
  6. Deklaratat Kontraktuale dhe Autoriteti i Përfaqësimit
  7. Shërbimet e Ekspertit
  8. Publikimi dhe Transferimi i Informacionit të lidhur me Shërbimet e Ekspertit
  9. Dispozita të ndryshme
- Angazhimet e Pajtueshmërisë së Marrësit  
Angazhimet e Pajtueshmërisë së Agjencisë Ekzekutuese të Projektit

Kjo marrëveshje shtesë shoqëruese e grantit është pjesë e projektit Rehabilitimi i Hidrocentralit të Fierzës” (“**Projekti**”).

Kjo rezulton në vijim të një marrëveshjeje huaje të lidhur ndërmjet KfW-së, Marrësit dhe Agjencisë Ekzekutuese të Projektit më 23 dhjetor 2021, për shumën 40 milionë euro, për Rehabilitimin e Hidrocentralit të Fierzës (“**Marrëveshja e Parë e Huas**”) dhe një marrëveshjeje shoqëruese granti, të datës 28 janar 2022, për shumën 2 milionë euro



(“**Marrëveshja e Parë Shoqëruese e Grantit**”) dhe shoqëron një marrëveshje shtesë huaje me vlerën 40 milionë euro (BMZ-Nr. 2023 68 256) të datës 15.12.2025 (“**Marrëveshja e Dytë e Huas**”).

Palët e kësaj marrëveshjeje shtesë shoqëruese të grantit dakordësohen që kjo marrëveshje konsiderohet të jetë një marrëveshje e veçantë, që lidhet me Marrëveshjen e Parë Shoqëruese të Grantit, brenda kuptimit të nenit 4.1 b) të Marrëveshjes së Parë Shoqëruese të Grantit.

Gjithashtu, Kuadri i Investimeve në Ballkanin Perëndimor (“KIBP”) bashkëfinancon Projektin. Këto fonde të KIBP-së i vihen në dispozicion Huamarrësit, përmes KfW-së, nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta të grantit. Si rrjedhojë, KfW-ja ka lidhur, gjithashtu, një marrëveshje të veçantë granti me Huamarrësin, të datës 28 janar 2022 (WB-IG05-ALB-ENE-01) dhe synon të lidhë një marrëveshje shtesë granti (KIBP nr. WB-IG10E-ALB-ENE-02), në lidhje me Projektin e financuar nga KIBP-i (marrëveshja e grantit KIBP e datës 28 janar 2022 dhe marrëveshja e mundshme e ardhshme e grantit KIBP (nëse ka), në vijim të referuara bashkërisht si “**Marrëveshja/t e Grantit KIBP**”).

Në bazë të sa më sipër dhe marrëveshjes së datës 27 janar 2021 ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Qeverisë së Republikës të Shqipërisë mbi Bashkëpunimin Financiar (“**Marrëveshja Qeveritare**”) dhe notave verbale nr. 262/2023 të datës 24 tetor 2023 dhe nr. 125/2024, të datës 12 qershor 2024, të Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, Marrësit, Agjencia Ekzekutuese e Projektit dhe KfW-ja, me anë të kësaj Marrëveshjeje, lidhin marrëveshjen e mëposhtme të grantit (“**Marrëveshja**”):

### 1. Shuma dhe qëllimi i Grantit

1.1 KfW-ja i ofron Marrësit një grant që nuk tejkalon 1.000,000.00 (me fjalë: një milionë euro) (“**Granti**”).

Ky Grant nuk është i shlyeshëm, përveç kur përcaktohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Marrësi kanalizon Grantin plotësisht tek Agjencia Ekzekutuese e Projektit, në përputhje me kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia Ekzekutuese e Projektit përdor Grantin ekskluzivisht për shërbimet e ekspertit për Projektin (“**Shërbimet e Ekspertit**”) dhe kryesisht për të paguar kostot e këmbimit të huaj. Hollësitë e Shërbimeve të Ekspertit do të financohen me një

marrëveshje të veçantë, që do të nënshkruhet nga Agjencia Ekzekutuese e Projektit dhe KfW-ja dhe do të nënshkruhet, gjithashtu, si e lexuar dhe e pranuar nga Marrësi, të përfaqësuar nga Ministria e Financave (“**Marrëveshja e Veçantë**”).

1.3. Agjencia Ekzekutuese e Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë me hollësi kontributet plotësuese që duhet të jepen nga Agjencia Ekzekutuese e Projektit në Marrëveshjen e Veçantë. Agjencia Ekzekutuese e Projektit jep kontributet e saj plotësuese plotësisht dhe në kohën e duhur. Agjencia Ekzekutuese e Projektit i jep KfW-së me kërkesë, dëshmi që tregojnë masat e marra në këtë drejtim.

1.4 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të mbulohen nga Marrësi dhe Agjencia Ekzekutuese e Projektit dhe detyrimet e importit nuk do të financohen nga Granti.

### 2. Kanalizimi i Grantit tek Agjencia Ekzekutuese e Projektit

2.1. Marrësi kanalizon Grantin tek Agjencia Ekzekutuese e Projektit, si një grant jo të shlyeshëm, të dhënë sipas një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2. Para fillimit të disbursimit nga Granti, Marrësi do t'i dërgojë KfW-së një përkthim të vërtetuar të marrëveshjes, të specifikuar në nenin 2.1.

2.3. Kanalizimi i Grantit nuk përbën ndonjë përgjegjësi të Agjencisë Ekzekutuese të Projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje.

### 3. Disbursimi

3.1 KfW-ja e disburson Grantin në përputhje me ecurinë e Shërbimeve të Ekspertit dhe me kërkesë të Agjencisë Ekzekutuese të Projektit. Me anë të Marrëveshjes së Veçantë, Agjencia Ekzekutuese e Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti dëshmitë që vërtetojnë se fondet e disbursuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

3.2 KfW-ja ka të drejtën të refuzojë që të kryejë disbursime pas datës 30 dhjetor 2030.

### 4. Pezullimi i disbursimeve dhe shlyerja

4.1 KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, nëse:

a) Marrësi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për pagesat kur kërkohet kryerja e tyre;

b) detyrimet në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të veçanta të lidhura me këtë Marrëveshje, janë shkelur;



c) Agjencia Ekzekutuese e Projektit nuk mund të provojë që shumat e disbursuara janë përdorur për qëllimin e përcaktuar;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje shkel ligjin e zbatueshëm;

e) lindin rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë ndjeshëm ekzekutimin ose qëllimin e Shërbimeve të Ekspertit;

f) ka ndodhur një arsye për ndërprerje, ose ka ndodhur një incident që do të bëhej shkak për ndërprerje me anë të njoftimit ose skadimit ose konstatimit ose përmbushjes së një kushti (arsye e mundshme për ndërprerje), sipas Marrëveshjes së Parë të Huas ose Marrëveshjes së Dytë të Huas, ose është bërë e paligjshme për KfW-në të kryejë ndonjë nga detyrimet e saj, siç parashikohet nga Marrëveshja e Parë e Huas ose Marrëveshja e Dytë e Huas ose të financojë ose mbajë ndonjë nga huat sipas tyre; ose

g) ka ndodhur një arsye për pezullim ose refuzim disbursimi sipas ndonjë Marrëveshjeje/ve të Grantit KIBP ose sipas Marrëveshjes së Parë Shoqëruese të Grantit;

h) Marrëveshja e Dytë e Huas ka hyrë në fuqi dhe efekt.

4.2 Nëse ndonjë nga situatat e specifikuar në nenin 4.1 b) deri në (h) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila, megjithatë, duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja mund të:

a) në rastin e nenit 4.1 b), d), f), g) ose h), do të kërkojë kthimin e menjëhershëm të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e nenit 4.1 c), do të kërkojë kthimin e menjëhershëm të shumave të tilla që Marrësi nuk mund të provojë se janë përdorur për qëllimin e përcaktuar.

### 5. Kostot dhe detyrimet publike

Marrësi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që bëhen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, për lidhjen dhe ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe konvertimit që lindin në lidhje me disbursimin e Grantit.

### 6. Deklaratat kontraktuale dhe Autoriteti i Përfaqësimit

6.1 Ministri i Financave përfaqëson Marrësin në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Agjencisë Ekzekutuese të Projektit dhe personat e caktuar prej tij ose saj për

KfW-në dhe të autorizuar nga nënshkrime model të vërtetuara prej tij ose saj, do të përfaqësojnë Agjencinë Ekzekutuese të Projektit në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Autoriteti i Përfaqësimit nuk do të skadojë deri në marrjen nga ana e KfW-së, të revokimit të tij të shprehur nga përfaqësuesi i autorizuar në atë kohë.

6.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje, si dhe njoftimet dhe deklaratat e lëshuara nga palët kontraktuese në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje bëhen me shkrim. Ministri i Financave është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim, i cili para nënshkrimit duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet në këtë Marrëveshje që ndikojnë vetëm në periudhën e disponueshmërisë (neni 3.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë konsiderohet e marrë, sapo të ketë arritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse, ose në atë adresë tjetër të palës kontraktuese përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW-në: KfW  
Postfach 11 11 41  
60046 Frankfurt am Main  
Federal Republic of Germany (Republika Federale e Gjermanisë)  
Faks: +49 7431-2944

Për Marrësin: Ministria e Financave  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3  
1001 Tiranë, Shqipëri

Për Agjencinë Ekzekutuese të Projektit: Korporata Elektroenergjetike  
Shqiptare (KESH)  
Blloku "Vasil Shanto"  
1001 Tiranë, Shqipëri

### 7. Shërbimet e Ekspertit

#### 7.1. Agjencia Ekzekutuese e Projektit:

a) do të përgatisë dhe kryejë Shërbimet e Ekspertit, në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, sipas standardeve mjedisore dhe sociale, dhe kryesisht në përputhje me konceptin e dakordësuar ndërmjet Agjencisë Ekzekutuese të Projektit dhe KfW-së për Shërbimet e Ekspertit dhe në këtë drejtim shfrytëzon shërbimet konsulente të inxhinierëve të pavarur, të kualifikuar;

b) do të realizojë në çdo kohë dispozitat e prokurimit të përcaktuara në Marrëveshjen e



Veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

c) do të sigurojë financimin e plotë të Shërbimeve të Ekspertit dhe do t'i paraqesë KfW-së, sipas kërkesës, dëshmi që vërtetojnë se të gjitha kostot që nuk do të paguhen nga Granti janë të mbuluara;

d) do të mbajë, ose sigurojë mbajtjen e librave dhe regjistrave që specifikojnë qartë të gjitha kostot e lindura, në lidhje me Shërbimet e Ekspertit, dhe që identifikojnë qartë shërbimet e financuara nga ky Grant financiar;

e) do të mundësojë për përfaqësuesit e KfW-së në çdo kohë librat dhe regjistrat e lartpërmendur, si dhe çdo dokumentacion tjetër që lidhet me ekzekutimin e Shërbimeve të Ekspertit;

f) do t'i japë KfW-së ndonjë dhe të gjitha informacionet dhe raportet për Shërbimet e Ekspertit dhe mbi ecurinë e tyre të mëtejshme sipas kërkesës së KfW-së;

g) me nismën e saj, do të informojë menjëherë KfW-në për çdo rrethanë që e bën të pamundur ose rrezikon ndjeshëm ekzekutimin e Shërbimeve të Ekspertit, ose qëllimin e tyre.

7.2. Agjencia Ekzekutuese e Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë lidhur me nenin 7.1 me një Marrëveshje të Veçantë.

7.3. Marrësi, nëpërmjet MIE-s, dhe Agjencia Ekzekutuese e Projektit:

a) do të sigurojnë financimin e plotë të Shërbimeve të Ekspertit dhe i japin KfW-së, me kërkesë, dëshmi që tregojnë se janë mbuluar kostot e paguara nga ky Grant;

b) me porosi të tyre do të informojnë menjëherë KfW-në për çdo dhe të gjitha rrethanat që përjashtojnë ose rrezikojnë ndjeshëm zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Projektit ose Shërbimet e Ekspertit.

7.4. Marrësi, nëpërmjet MIE-s, ndihmon Agjencinë Ekzekutuese të Projektit në përputhje me praktikën e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në zbatimin e Shërbimeve të Projektit dhe përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë Ekzekutuese të Projektit, sipas kësaj Marrëveshjeje, dhe në veçanti, do t'i japë Agjencisë Ekzekutuese të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Projektit dhe Shërbimet e Ekspertit.

## 8. Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me Shërbimet e Ekspertit

8.1 Për të qenë në përputhje me parimet e pranuar në nivel ndërkombëtar për transparencë

dhe efikasitet maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e kategorizimit dhe vlerësimit mjedisor dhe shoqëror, si dhe raportet e vlerësimit *ex post* (pas Projektit)) për Shërbimet e Ekspertit dhe financimin e tyre gjatë negociatave parakontraktuale, ndërsa zbatohet (zbatohen) marrëveshja (marrëveshjet) lidhur me shërbimet e ekspertit dhe në fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “**Periudha e plotë**”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit, për fushën e saj të biznesit, të Bankës për Zhvillim të KfW-së (<http://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/>).

Publikimi i informacionit (ose nga KfW-ja apo palët e treta në përputhje me nenin 8.3 më poshtë), në lidhje me Shërbimet e Ekspertit dhe financimin e tyre nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual, ose informacion të detajuar sensitiv financiar, ose biznesi në lidhje me palët e përfshira në Shërbimet e Ekspertit ose financimin e tyre, të tilla si:

- a) informacion për të dhëna të brendshme financiare;
- b) strategji biznesi;
- c) udhëzime dhe raporte të brendshme të korporatës;
- d) të dhënat personale të personave fizikë;
- e) vlerësimin e brendshëm të KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

8.2 KfW-ja ndan informacione të përzgjedhura mbi Shërbimet e Ekspertit dhe mënyrën sesi janë financuar gjatë Periudhës së Plotë, veçanërisht për të garantuar transparencë dhe efikasitet me subjektet e poshtëshënuara:

- a) filialet e KfW-së;
- b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet e saj kompetente, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet;
- c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;
- d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarëve të tyre, në veçanti, Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;
- e) palët në Kushtet e Përgjithshme të datës 7 nëntor 2006, të Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor (“FPEBP”);



f) institucionet që administrojnë kontribuesit e FPEBP-së dhe KIBP-it; dhe

g) Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij;

8.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Shërbimet e Ekspertit dhe mënyrën sesi financohen gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme, që publikojnë seksionet e lidhura me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Nismës së Transparencës të Ndihmës Ndërkombëtare

(<https://www.bmz.de/de/ministerium/zahlen-fakten/internationale-transparenzstandards-59280>);

b) Tregu & Investimi Gjerman (GTAI) për qëllimet e informacionit për tregun (<https://www.gtai.de/gtai-de/trade>);

c) OECD-ja për qëllimet e raportimit të flukseve financiare në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEVal) për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim, për të garantuar transparencë dhe efikasitet (<http://www.deval.org/de/>);

e) palët në Kushtet e Përgjithshme të datës 7 nëntor 2006, të Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor (“FPEBP”);

f) institucionet që administrojnë kontribuesit e FPEBP-së dhe KIBP-it; dhe

g) Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij.

8.4. KfW-ja, gjithashtu, rezervon të drejtën për të transferuar (duke përfshirë edhe për qëllimet e publikimit) informacion në lidhje me Shërbimet e Ekspertit dhe financimin e tyre gjatë Periudhës së Plotë ndaj palëve të treta, me qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshëm.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja tek palët e treta, nëse interesat e ligjshëm të Marrësit dhe/ose Agjencisë Ekzekutuese të Projektit në informacionin që nuk transferohet i tejkalojnë interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Marrësit dhe/ose të Agjencisë Ekzekutuese të Projektit, në veçanti, përfshijnë konfidencialitetin e informacioneve sensitive të përmendura në nenin 8.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion te palët e treta, nëse kjo është e nevojshme, për shkak të kërkesave ligjore ose

rregullatore, ose për të pohuar, ose mbrojtur pretendimet, ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë apo procedime administrative.

## 9. Dispozita të ndryshme

9.1. Marrësi ndërmerr të përbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në shtojcën 1a (*Angazhimet e Pajtueshmërisë të Marrësit*). Agjencia Ekzekutuese e Projektit ndërmerr të përbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në shtojcën 1b (*Angazhimet e Pajtueshmërisë së Agjencisë Ekzekutuese të Projektit*).

9.2. Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej saj plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3. As Marrësi, as Agjencia Ekzekutuese e Projektit nuk mund të delegojë ose transferojë, rendojë me peng ose hipotekë ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshjeje.

9.4. Kjo Marrëveshjeje rregullohet nga legjislacioni i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i përbushjes është Frankfurt am Main.

9.5. Marrëdhëniet juridike ndërmjet KfW-së, Marrësit dhe Agjencisë Ekzekutuese të Projektit, të krijuara me anë të kësaj Marrëveshjeje, do të përfundojnë gjashtë vjet pas disbursimit përfundimtar.

9.6. Kjo Marrëveshjeje nuk do të hyjë në fuqi derisa KfW-ja të ketë marrë njoftimin me shkrim të Marrësit se procedurat e brendshme ligjore janë përfunduar (data e marrjes në KfW). KfW-ja do ta informojë Marrësin me shkrim për datën e marrjes së një njoftimi të tillë.

Nëse Marrëveshja nuk ka hyrë në fuqi dhe efekt pas gjashtë muajve pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, ose në ndonjë afat tjetër që mund të bihet dakord nga KfW-ja, kjo e fundit, nga ajo datë deri në datën e hyrjes në fuqi, do të ketë të drejtë të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga Marrëveshja dhe, në këtë mënyrë të ndërpresë procesin e saj të mbetur pezull, duke i dërguar njoftim me shkrim Marrësit.

Hartuar në 3 (tri) origjinale në gjuhën angleze.

[Vendi, data]



**KfW**

/Nënshkrimi/

[Nënshkrimi]

Emri: Matthias Grüninger

Funksioni: Drejtor Kryesor

Portofoli

Tiranë, 15.12.2025

[Vendi, data]

**Republika e Shqipërisë****e përfaqësuar nga Ministria e****Financave**

/Nënshkrimi/

[Nënshkrimi]

Emri: PETRIT MALAJ

Funksioni: MINISTËR I

FINANCEVE

**Korporata Elektroenergjetike****Shqiptare (KESH)**

/Nënshkrimi/

[Nënshkrimi]

Emri: Ermal Nuri

Funksioni: Drejtor TD

Shtojcat

1a Angazhimet e Pajtueshmërisë

së Marrësit

1b Angazhimet e Pajtueshmërisë

së Agjencisë Ekzekutuese të

Projektit

/Nënshkrimi/

[Nënshkrimi]

Emri: Mara Drochner

Funksioni: Drejtor

Zyre

Shtojca 1a

## ANGAZHIMET E PAJTUESHMËRISË SË MARRËSIT

### 1. PËRKUFIZIME

**“Praktikë shtrënguese”** është pengimi ose dëmtimi, ose kërcënimi për të penguar, ose dëmtuar drejtpërsëdrejti, ose në mënyrë të tërthortë, ndonjë person ose pronën e ndonjë personi, me qëllim ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një personi.

**“Praktikë e marrëveshjes së fshehtë”** është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, përfshirë ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një personi tjetër.

**“Praktikë korruptive”** është premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja mbi, marrja, pranimi ose kërkesa e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazh i padrejtë i çdo natyre, për dikë ose nga kushdo, me qëllim që të ndikojë në veprimet e dikujt ose të bëjë që një person të mos veprojë.

**“Praktikë mashtrimi”** është çdo veprim ose mungesë veprimi, duke përfshirë një keqinterpretim që, me qëllim ose nga pakujdesia çorienton, ose synon të çorientojë një palë në kuadrin e përfuturit të një përfuturi financiar ose shmangies së një detyrimi.

**“Listë e BE-së”**, lista e BE-së e juridiksioneve tatimore jobashkëpunuese, e përcaktuar dhe përditësuar herë pas here nga Komisioni i BE-së, duke përfshirë shtojcën I dhe shtojcën II përkatëse (për më shumë detaje, ju lutem vizitoni <https://www.consilium.europa.eu/de/policies/eulist-of-non-cooperative-jurisdictions>). Shtojca I përfshin juridiksione që klasifikohen si jobashkëpunuese dhe shtojca II përfshin juridiksione të mëtejshme (“Juridiksionet e shtojcës II” ose “Juridiksionet e Angazhuara”), që kanë marrë angazhime të mjaftueshme për të trajtuar mangësitë e tyre të identifikuar dhe si të tilla nuk janë konsideruar jobashkëpunuese për momentin.

**“Praktikë penguese”**: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja me qëllim e materialit të provave për hetimin, ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar në akuzat për një praktikë korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi i çdo pale për ta parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështje që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii. veprime, me qëllimin për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar me kontratë në lidhje me hetimin zyrtar në akuzat e një praktike korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

**“Person”**, çdo person fizik, juridik, partneritet ose shoqatë e pathemeluar.

**“Praktikë e sanksionueshme”**, secila nga praktikat shtrënguese, të marrëveshjes së fshehtë, korruptive, mashtruese ose penguese (siç përkufizohen dhe këta terma këtu), që është: i. e paligjshme sipas ligjit gjerman ose atij të zbatueshëm; dhe ii. që ka, ose mund të ketë ndikim material ligjor ose reputacional të Marrëveshja ndërmjet Marrësit dhe KfW-së ose në zbatimin e saj.

**“Sanksionet”**, sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot ose masat kufizuese ekonomike, financiare ose tregtare (duke përfshirë mallrat, teknologjitë ose shërbimet dhe ndihmën financiare në lidhje me to), të administruara, miratuara ose zbatuara nga ndonjë Organ Sanksionues.



**“Organ sanksionues”**, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

**“Listë e sanksioneve”**, çdo listë e personave, grupeve ose subjekteve të caktuar posaçërisht që janë objekt i sanksioneve, siç miratohet nga çdo Organ Sanksionues.

**“Praktikë e Shmangies së Tatimeve”**, çdo akt i shfrytëzimit të teknikaliteteve të një sistemi tatimor dhe/ose juridiksioni, ose i mospërputhjeve midis dy ose më shumë sistemeve, dhe/ose juridiksioneve tatimore pa ndonjë arsye bindëse biznesi, përveç qëllimit të vetëm të reduktimit të detyrimit tatimor.

## 2. DHËNIA E INFORMACIONIT

Marrësi, nëpërmjet MIE-s:

a) i vendos menjëherë në dispozicion KfW-së, me kërkesë të KfW-së, të gjithë informacionet përkatëse me “njih klientin tënd”, ose informacione të ngjashme në lidhje me Marrësin;

b) i paraqet menjëherë KfW-së, me kërkesë të KfW-së, të gjitha informacionet dhe dokumentet lidhur me Shërbimet e Ekspertit, të Marrësit dhe (nën)kontraktuesve të tij dhe palëve të tjera të lidhura, të cilat KfW-ja i kërkon për përmbushjen e detyrimeve të saj për parandalimin e Praktikave të Sanksionueshme, pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të punës me Marrësin që nevojitet për këtë qëllim;

c) informon menjëherë KfW-në dhe, me nismën e vet, sapo merr dijeni ose ka dyshime për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash dhe/ose financim terrorizmi, që lidhet me Shërbimet e Ekspertit;

d) i jep KfW-së të gjithë informacionin dhe të dhëna mbi Shërbimin e Ekspertit dhe ecurinë e mëtejshme që KfW-ja mund të kërkojë për qëllimet e kësaj shtojce;

e) u jep mundësinë KfW-së dhe agentëve të tij të inspektojnë kurdoherë të gjithë dokumentacionin e lidhur me Shërbimet e Ekspertit që ka Marrësi dhe (nën)kontraktuesit e tij dhe palët të tjera të lidhura dhe të vizitojnë Shërbimet e Ekspertit dhe të gjitha instalimet përkatëse për qëllimet e kësaj shtojce;

f) Informon KfW-në, menjëherë dhe me nismën e vet, në rast se Marrësi synon të ndajë fondet e ofruara nga KfW-ja për (nën)kontraktuesin dhe/ose palë të tjera të lidhura, të cilët ndodhen dhe/ose janë të regjistruar në çdo vend të listuar në juridiksione

jobashkëpunuese si në shtojcën I të Listës së BE-së; dhe

g) informon KfW-në, menjëherë dhe me nismën e vet, sapo merr dijeni ose të dyshojë për ndonjë Praktikë të Shmangies së Tatimeve, që lidhet me Shërbimet e Ekspertit.

## 3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1. Në lidhje me ligjin gjerman ose ligjin e vendit të Marrësit, Marrësi deklaron dhe garanton se asnjë nga personat që vepron në lidhje me Shërbimet e Ekspertit në emër të Marrësit nuk ka kryer ose nuk është përfshirë në ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash, financim të terrorizmit ose ndonjë Praktikë të Shmangies së Tatimeve.

3.2. Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen bëhen për herë të parë nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje. Ato do të duhet të përsëriten në çdo tërheqje të Grantit dhe në çdo datë pagese të interesit, në çdo rast, referuar rrethanave mbizotëruese të asaj date.

## 4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Marrësi merr përsipër, sapo ai ose KfW-ja merr dijeni ose ka dyshime për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash, financim terrorizmi ose praktikë e shmangies së tatimeve, të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agentët e tij për të përcaktuar nëse ka ndodhur një incident i tillë pajtueshmërie. Në veçanti, Marrësi i përgjigjet menjëherë dhe me hollësitë e pranueshme çdo njoftimi nga KfW-ja dhe dorëzon dokumentet mbështetëse për çdo përgjigje ndaj kërkesave të KfW-së.

## 5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Marrësi merr përsipër:

a) të sigurojë që në lidhje me Shërbimet e Ekspertit aktivitetet e tij nuk do të sjellin ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash ose financim të terrorizmit;

b) të mos hyjë në asnjë transaksion ose të mos angazhohet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë në ndonjë aktivitet tjetër në lidhje me Shërbimet e Ekspertit që do të përbënte shkelje të Sanksioneve; dhe

c) të mos ndajë fonde të ofruara nga KfW-ja për asnjë person të vendosur dhe/ose të regjistruar në ndonjë juridiksion të mbajtur në shtojcën I të listës së BE-së pa pëlqimin paraprak të KfW-së dhe të mos angazhohet në asnjë aktivitet tjetër që do të përbënte një Praktikë të Shmangies së Tatimeve.



## SHTOJCA 1b

ANGAZHIMET E PAJTUESHMËRISË SË  
AGJENCISË EKZEKUTIVESE TË  
PROJEKTTIT

## 1. PËRKUFIZIME

**“Praktikë shtrënguese”** është pengimi ose dëmtimi, ose kërcënimi për të penguar ose dëmtuar drejtpërsëdrejti ose në mënyrë të tërthortë çdo person, ose pronën e çdo personi, me qëllim ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një personi.

**“Praktikë e marrëveshjes së fshehtë”** është një marrëveshje midis dy ose më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, përfshirë ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një personi tjetër.

**“Praktikë korruptive”** është premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja mbi, marrja, pranimi ose kërkesa e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazh i padrejtë i çdo natyre, për dikë ose nga cilido, me qëllim që të ndikojë në veprimet e dikujt ose të marrë masa që një person të mos veprojë.

**“Kategoritë e përcaktuara të shkeljeve”**, kategoritë e mëposhtme të shkeljeve të përcaktuara nga rekomandimet FATF-së dhe shënimet përkatëse interpretuese: pjesëmarrja në grup të organizuar kriminal dhe shantazhi: terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandimin e njerëzve; shfrytëzimin seksual, përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve, trafikimin e jashtëligjshëm të substancave narkotike dhe psikotrope; trafikimin e jashtëligjshëm të armëve; trafikimin e jashtëligjshëm të mallrave të vjedhura dhe të tjera; korrupsionin dhe mitmarrjen; mashtrimin; falsifikimin e parave; falsifikimin dhe piraterinë e produkteve; krimin mjedisor; vrasjen, lëndimin e rëndë trupor; rrëmbimin, mbajtjen e jashtëligjshme dhe pengmarrjen; vjedhjen ose grabitjen; kontrabandimin (duke përfshirë taksat dhe detyrimet tatimore dhe të akcizës); krimet tatimore (në lidhje me taksat direkte dhe indirekte); shantazhin; falsifikimin; piraterinë; tregtinë e brendshme dhe manipulimin e tregut.

**“Listë e BE-së”**, lista e BE-së e juridiksioneve tatimore jobashkëpunuese, siç përcaktohet dhe përditësohet herë pas here nga Komisioni i BE-së, duke përfshirë shtojcën I dhe shtojcën II përkatëse

(për më shumë hollësi, ju lutem vizitoni <https://www.consilium.europa.eu/de/policies/eu-list-of-non-cooperative-jurisdictions>).

Shtojca I përfshin juridiksione që klasifikohen si jobashkëpunuese dhe shtojca II përfshin juridiksione të mëtejshme (“Juridiksionet e shtojcës II” ose “Juridiksionet e Angazhuara”), që kanë marrë angazhime të mjaftueshme për të trajtuar mangësitë e tyre të identifikuar dhe si të tilla nuk janë konsideruar si jobashkëpunuese për momentin.

**“Rekomandimet e FATF-it”** rekomandime të tilla të përkufizuara herë pas here nga Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF). FATF-i është organi ndërqeveritar që synon të zhvillojë dhe nxisë politikat kombëtare dhe ndërkombëtare për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

**“Praktikë mashtrimi”** është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqinterpretim që, me qëllim ose nga pakujdesia, çorienton ose synon të çorientojë një palë në kuadrin e marrjes së një përfitimi financiar ose shmanges së një detyrimi.

**“Natyrë e jashtëligjshme”** është origjina e fondeve të marra nëpërmjet:

a) ndonjë shkeljeje të renditur në kategoritë e përcaktuara të shkeljeve;

b) ndonjë praktike korruptive;

c) ndonjë praktike mashtrimi; ose

d) pastrimit të parave.

**“Praktikë penguese”**: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja, me qëllim të materialit të provave për hetimin, ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar në akuzat për një praktikë korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi i ndonjë pale për ta penguar nga zbulimi i njohurive të saj për çështjet e lidhura me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii. veprime, me qëllimin për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KfW-së në informacionin e kërkuar me kontratë në lidhje me hetimin zyrtar në akuzat e një praktike korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

**“Person”**, çdo person fizik, juridik, partneritet ose shoqatë e pathemeluar.

**“Praktikë e sanksionueshme”**, secila nga praktikat shtrënguese, të marrëveshjes së fshehtë, korruptive, mashtruese ose penguese (siç përkufizohen dhe këta terma këtu) që është: i. e paligjshme sipas ligjit gjerman ose atij të



zbatueshëm; dhe ii. që ka ose mund të ketë efekt material ligjor ose reputacional të Marrëveshja ndërmjet Huamarrësit, Agjencisë Ekzekutuese të Projektit dhe KfW-së ose në zbatimin e saj.

**“Sanksione”** sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot ose masat kufizuese ekonomike, financiare ose tregtare (duke përfshirë mallrat, teknologjitë ose shërbimet dhe ndihmën financiare në lidhje me to), të administruara, miratuara ose zbatuara nga ndonjë Organ Sanksionues.

**“Organ sanksionues”**, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

**“Listë e sanksioneve”**, çdo listë e personave, grupeve ose subjekteve të caktuar posaçërisht që janë objekt i Sanksioneve, siç miratohet nga ndonjë Organ Sanksionues.

**“Praktikë e Shmangies së Tatimeve”**, çdo akt i shfrytëzimit të teknikaliteteve të një sistemi tatimor dhe/ose juridiksioni ose të mospërputhjeve midis dy ose më shumë sistemeve dhe/ose juridiksioneve tatimore pa ndonjë arsye bindëse biznesi, përveç qëllimit të vetëm të reduktimit të detyrimit tatimor.

## 2. DHËNIA E INFORMACIONIT

Agjencia Ekzekutuese e Projektit:

a) i vendos menjëherë në dispozicion KfW-së, me kërkesë të KfW-së, të gjithë informacionet përkatëse me “njih klientin tënd”, ose informacione të ngjashme në lidhje me Agjencinë Ekzekutuese të Projektit dhe secilin prej aksionarëve të saj (të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë), filialeve dhe/ose degëve të tjera (nëse ka), sipas kërkesës së KfW-së;

b) i paraqet menjëherë KfW-së, me kërkesë të KfW-së, të gjitha informacionet dhe dokumentet që lidhen me Projektin, që ka Agjencia Ekzekutuese e Projektit dhe (nën)kontraktuesit dhe palët e tjera të lidhura, për të cilat KfW-ja ka nevojë për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e Praktikave të Sanksionueshme, pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të punës me Agjencinë e Zbatimit të Projektit që nevojitet për këtë qëllim;

c) informon menjëherë dhe me nismën e vet, sapo merr dijeni ose ka dyshime, KfW-në për çdo Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash dhe/ose financim terrorizmi nga Agjencia Ekzekutuese e Projektit, anëtarët e organeve të saj menaxheriale, ose organe të tjera drejtuese, ose aksionarët e saj;

d) i jep KfW-së të gjithë informacionin dhe të dhënat mbi Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme që KfW-ja mund të kërkojë për qëllimet e kësaj shtojce;

e) i jep mundësinë KfW-së dhe agentëve të tij të inspektojnë kurdoherë të gjithë dokumentacionin e lidhur me Projektin që ka Agjencia Ekzekutuese e Projektit dhe (nën)kontraktuesit e saj dhe palët e tjera të lidhura, dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet përkatëse për qëllimet e kësaj shtojce;

f) informon KfW-në menjëherë dhe me nismën e vet, për çdo rast që ndodh dhe e bën ose mund ta bëjë Agjencinë Ekzekutuese të Projektit, anëtarët e organeve të saj menaxheriale, ose organet e tjera drejtuese ose aksionarët e saj, që të jenë ose të bëhen persona, ose subjekte të bllokuara, me emërim të posaçëm kombëtar të përfshirë në Listën e Sanksioneve;

g) informon KfW-në, menjëherë dhe me nismën e vet, në rast se Agjencia Ekzekutuese e Projektit synon të ndajë fondet e ofruara nga KfW-ja për (nën)kontraktim dhe/ose palë të tjera të lidhura, të cilat ndodhen dhe/ose janë të regjistruara në ndonjë vend të listuar në juridiksionet joashkëpunuese si në shtojcën I të Listës së BE-së; dhe

h) informon KfW-në, menjëherë dhe me nismën e vet, sapo merr dijeni ose dyshon për ndonjë Praktikë të Shmangies së Tatimeve nga Agjencia Ekzekutuese e Projektit, çdo anëtar i organeve të saj drejtuese ose organeve të tjera drejtuese ose ndonjë prej aksionarëve të saj.

## 3. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

3.1. Në përputhje me ligjin gjerman ose ligjin e vendit të themelimit të Agjencisë Ekzekutuese të Projektit, Agjencia Ekzekutuese e Projektit përfaqëson dhe garanton vërtetësinë dhe saktësinë e sa më poshtë:

a) Në lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia Ekzekutuese e Projektit vepron në emrin dhe për llogari të saj.

b) Në dijeni të informacioneve që ka dhe vetëm në lidhje me aksionarët që njeh Agjencia Ekzekutuese e Projektit, sipas rregulloreve të zbatueshme mbi tregun e aksioneve, kapitali dhe fondet e investuara nga Agjencia Ekzekutuese e Projektit në këtë Projekt nuk janë të një natyre të paligjshme.

c) Asnjë nga Agjencia Ekzekutuese e Projektit, filialeve ose degëve të saj, ose persona të tjerë që veprojnë personalisht ose në emër të tyre, nuk ka



kryer ose nuk është angazhuar në Praktika të Sanksionueshme, pastrim parash ose financim terrorizmi.

d) Agjencia Ekzekutuese e Projektit nuk: i. ka hyrë në asnjë marrëdhënie pune me persona ose subjekte të bllokuara me emërim të posaçëm kombëtar të përfshirë në Listën e Sanksioneve; ose ii. nuk është angazhuar në asnjë veprimtari tjetër që do të përbënte shkelje të sanksioneve.

e) Agjencia Ekzekutuese e Projektit nuk është dhe nuk ka qenë e angazhuar në asnjë aktivitet që do të përbënte një Praktikë të Shmangies së Tatimeve.

3.2. Përfaqësimet dhe garancitë e përcaktuara në këtë nen bëhen për herë të parë nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje. Ato do të duhet të përsëriten në çdo tërheqje të Huas dhe në çdo datë pagese të interesit, në çdo rast referuar rrethanave mbizotëruese të asaj date.

#### 4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Agjencia Ekzekutuese e Projektit merr përsipër:

a) të respektojë plotësisht standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në përputhje me rekomandimet e FATF-së dhe të zbatojë, ruajë dhe, nëse është e nevojshme, të përmirësojë standardet dhe udhëzimet e saj të brendshme (duke përfshirë dhe jo vetëm, në lidhje me kujdesin e duhur ndaj klientit) të duhura për të shmangur Praktikën e Sanksionueshme, aktet e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit ose ndonjë Praktikë të Shmangies së Tatimeve; dhe

b) sapo Agjencia Ekzekutuese e Projektit ose KfW-ja merr dijeni ose ka dyshime për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash, financim terrorizmi ose Praktikë për Shmangien e Tatimeve, të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e tij, për të përcaktuar nëse ka ndodhur një incident i tillë pajtueshmërie. Në veçanti, Agjencia Ekzekutuese e Projektit i përgjigjet menjëherë dhe me hollësi të pranueshme çdo njoftimi nga KfW-ja dhe dorëzon dokumentet mbështetëse për çdo përgjigje ndaj kërkesave të KfW-së.

#### 5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Agjencia Ekzekutuese e Projektit merr përsipër:

a) të garantojë që kapitali dhe fondet e tjera që investon të mos jenë të një origjine të jashtëligjshme;

b) të garantojë që biznesi i saj nuk do të nxisë Praktika të Sanksionueshme, pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit; dhe

c) nuk do të hyjë ose vijojë asnjë marrëdhënie pune me persona ose subjekte të bllokuara me

emërim të posaçëm kombëtar, të përfshirë në Listën e Sanksioneve, dhe nuk do të angazhohet në asnjë veprimtari tjetër që do të përbënte shkelje të sanksioneve;

d) nuk do të ndajë fondet e dhëna nga KfW-ja asnjë personi të vendosur dhe/ose të regjistruar në ndonjë juridiksion të mbajtur në shtojcën I të listës së BE-së pa pëlqimin paraprak të KfW-së dhe nuk do të angazhohet në ndonjë aktivitet tjetër që do të përbënte Praktikë të Shmangies së Tatimeve.

### VENDIM

Nr. 98, datë 11.2.2026

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES  
SË GRANTIT DHE PROJEKTIT  
NDËRMJET REPUBLIKËS SË  
SHQIPËRISË (MARRËSI), TË  
PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E  
FINANCIVE DHE KORPORATËS  
ELEKTROENERGJETIKE SHQIPTARE  
(KESH) (AGJENCIA E ZBATIMIT TË  
PROJEKTIT), DHE *KfW, FRANKFURT  
AM MAIN (KfW)*, PËR FINANCIMIN E  
PROJEKTIT “REHABILITIMI I  
HIDROCENTRALIT TË FIERZËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19 të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

### VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes së grantit dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), të përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) (agjencia e zbatimit të projektit), dhe *KfW Frankfurt am Main (KfW)*, për financimin e projektit “Rehabilitimi i hidrocentralit të Fierzës”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**



**MARRËVESHJE GRANTI DHE PROJEKTI**  
 E DATËS 15.12.2025, NDËRMJET KfW,  
 FRANKFURT AM MAIN (“KfW”) DHE  
 REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
 (“PËRFITUESI”), TË PËRFAQËSUAR NGA  
 MINISTRIA E FINANCAVE DHE  
 KORPORATËS ELEKTROENERGJETIKE  
 SHQIPTARE (KESH) (“AGJENCIA  
 EKZEKUTUESE E PROJEKTT”),  
 PËR SHUMËN 10,120,000.00 EURO  
 - REHABILITIMI I HIDROCENTRALIT TË  
 FIERZËS -

KIBP-Nr. WB-IG10E-ALB-ENE-02  
 KfW ID: 66260

**PËRMBAJTJA**

Neni

Neni 1- Shuma dhe qëllimi i Grantit

Neni 2 - Kanalizimi i Grantit tek Agjencia

Ekzekutuese e Projektit

Neni 3 - Disbursimi

Neni 4 - Pezullimi i disbursimit dhe shlyerja

Neni 5 - Kostot dhe tarifatat publike

Neni 6 - Deklaratat kontraktuale dhe autoriteti i  
 përfaqësimit

Neni 7 - Projekti

Neni 8 - Publikimi dhe transferimi i  
 informacionit të lidhur me Projektin

Neni 9 - Dispozita të ndryshme

Angazhimet e Pajtueshmërisë së Përfituesit

Angazhimet e Pajtueshmërisë së Agjencisë

Ekzekutuese të Projektit

Kjo marrëveshje granti dhe projekti është pjesë e  
 projektit “Rehabilitimi i Hidrocentralit të Fierzës”.

Kjo rezulton në vijim një marrëveshjeje huaje të  
 lidhur midis KfW-së, Përfituesit dhe Agjencisë  
 Ekzekutuese të Projektit më 23 dhjetor 2021, për  
 shumën 40 milionë euro, për Rehabilitimin e  
 Hidrocentralit të Fierzës (“**Marrëveshja e Parë e  
 Huas**”), dhe një marrëveshjeje shoqëruese të  
 grantit, të datës 28 janar 2022, për shumën 2 milionë  
 euro (“**Marrëveshja e Parë Shoqëruese e  
 Grantit**”).

Së bashku me Marrëveshjen e Parë të Huas,  
 Kuadri i Investimeve në Ballkanin Perëndimor  
 (“KIBP”) ka bashkëfinancuar Rehabilitimin e  
 Hidrocentralit të Fierzës. Këto fonde të KIBP-së i  
 vihen në dispozicion Huamarrësit përmes KfW-së

nëpërmjet marrëveshjeve të veçanta të grantit. Si  
 rrjedhojë, KfW-ja ka lidhur një marrëveshje të  
 veçantë granti me Huamarrësin, të datës 28 janar  
 2022 (“**Marrëveshja e Parë e Grantit KIBP**”).

KfW-ja siguron një marrëveshje shtesë huaje për  
 shumën prej 40 milionë eurosh (BMZ-Nr. 2023 68  
 256) të datës 15.12.2025 (“**Marrëveshja e Dytë e  
 Huas**”), e cila synon të shoqërohet me një  
 marrëveshje shtesë shoqëruese të grantit në shumën  
 prej 1 milion eurosh (BMZ-Nr. 2023 70 245)  
 (“**Marrëveshja e Dytë Shoqëruese e Grantit**”).

KIBP-ja do të bashkëfinancojë përsëri  
 Rehabilitimin e Hidrocentralit të Fierzës dhe për  
 këtë arsye do të lidhë këtë marrëveshje shtesë granti  
 dhe projekti të financuar nga KIBP-ja.

Palët e kësaj marrëveshjeje shtesë granti dhe  
 projekti dakordësohen që kjo marrëveshje  
 konsiderohet të jetë një marrëveshje e veçantë që  
 lidhet me Marrëveshjen e Parë të Grantit të KIBP-  
 së, brenda kuptimit të nenit 4.1 (b) të Marrëveshjes  
 së Parë të Grantit të KIBP-së.

Në bazë të sa më sipër dhe Kushteve të  
 Përgjithshme të Fondit të Përbashkët Evropian të  
 Ballkanit Perëndimor (“FPEBP”), të datës 7 nëntor  
 2006, të ndryshuar herë pas here, dhe formularit të  
 aplikimit për grant (“**GAF**”) për grante investimi për  
 përzjerjen e sektorit publik, të miratuar më 27  
 qershor 2025 (bashkërisht të referuara si  
 “**Dokumentacioni KIBP**”), duke pranuar se  
 respektimi i të drejtave të njeriut dhe zbatimi i  
 legjislacionit mjedisor në fuqi, duke përfshirë  
 marrëveshjet shumëpalëshe mjedisore, si dhe  
 standardet thelbësore të punës të dakordësuara  
 ndërkombëtarisht, përbëjnë element thelbësor të  
 kësaj Marrëveshjeje, Përfituesi, Agjencia  
 Ekzekutuese e Projektit dhe KfW-ja, me anë të kësaj  
 Marrëveshjeje lidhin Marrëveshjen e Grantit dhe  
 Projektit si më poshtë (“**Marrëveshja**”):

**1. Shuma dhe qëllimi i Grantit**

1.1 KfW-ja i ofron Përfituesit një grant që nuk  
 tejkalon 10,120,000.00 euro (me fjalë: dhjetë milionë  
 e njëqind e njëzet mijë euro) (“**Granti**”).

Ky Grant nuk është i shlyeshëm, përveç kur  
 përcaktohet ndryshe në nenin 4.2.

1.2 Përfituesi kanalizon Grantin plotësisht tek  
 Agjencia Ekzekutuese e Projektit, në përputhje me  
 kushtet e përcaktuara në nenin 2. Agjencia  
 Ekzekutuese e Projektit përdor Grantin  
 ekskluzivisht për masa të caktuara të përcaktuara për  
 rehabilitimin e përgjithshëm të Hidrocentralit të



Fierzës, të dakordësuar në Formularin e Aplikimit për Grant, të datës 27 qershor 2025 dhe të përditësuar herë pas here. Këto masa formojnë pjesë të Rehabilitimit të Përgjithshëm të Hidrocentralit të Fierzës (“**Projekti**”). Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (“**MIE**”) është hartuesi i politikave për sektorin e energjisë. Agjencia Ekzekutuese e Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë e Projektit dhe mallrat dhe shërbimet që do të financohen nga Granti me anë të një marrëveshjeje të veçantë (“**Marrëveshja e Veçantë**”).

1.3 KfW-ja mund të zbresë nga Granti çdo kosto për interesin negativ që grumbullohet në llogarinë e saj të Projektit në lidhje me fondet e marra nga KIBP-i për qëllimin e masave të financuara sipas kësaj Marrëveshjeje.

1.4 Taksat dhe detyrimet e tjera publike që duhet të mbulohen nga Përfituesi ose Agjencia Ekzekutuese e Projektit dhe detyrimet e importit nuk do të financohen nga Granti.

## **2. Kanalizimi i Grantit tek Agjencia Ekzekutuese e Projektit**

2.1. Përfituesi kanalizon Grantin tek Agjencia Ekzekutuese e Projektit si një grant jo të shlyeshëm, sipas një marrëveshjeje të veçantë financimi.

2.2. Para fillimit të disbursimit nga Granti, Përfituesi i dërgon KfW-së një përkthim të vërtetuar të marrëveshjes së referuar në nenin 2.1.

2.3. Kanalizimi i Grantit nuk përbën përgjegjësi të Agjencisë Ekzekutuese të Projektit ndaj KfW-së për detyrimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje.

## **3. Disbursimi**

3.1 KfW-ja disburson Grantin në përputhje me ecurinë e Projektit dhe me kërkesë të Agjencisë Ekzekutuese të Projektit. Me anë të një Marrëveshjeje të Veçantë, Agjencia Ekzekutuese e Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë procedurën e disbursimit, në veçanti dëshmitë që vërtetojnë se fondet e disbursuara janë përdorur për qëllimin e caktuar.

3.2 Në bazë të nenit 4, KfW-ja do të jetë e detyruar të kryejë disbursime sipas kësaj Marrëveshjeje, vetëm nëse dhe në masën që: i. KfW-ja ka marrë fondet korresponduese nga FPEBP-ja; ii. objekti i masave që do të financohen nga ky Grant është specifikuar dhe përditësuar me anë të një procedure me shkrim nga KIBP-i dhe, sipas kërkesave të KfW-së, KfW-ja dhe Agjencia Ekzekutuese e Projektit kanë lidhur një ndryshim në Marrëveshjen e Veçantë, e cila merr në konsideratë

këto përditësime dhe specifikime; dhe iv. kushtet e përcaktuara në nenin 2.2 janë përmbushur.

3.3 KfW-ja do të ketë të drejtën që të refuzojë të kryejë disbursime pas datës 30 gusht 2030.

## **4. Pezullimi i disbursimit dhe shlyerja**

4.1. KfW-ja nuk mund të pezullojë disbursimet, nëse:

a) Përfituesi nuk i përmbush detyrimet e tij ndaj KfW-së për pagesat kur kërkohet kryerja e tyre;

b) detyrimet në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje ose sipas marrëveshjeve të veçanta të lidhura me këtë Marrëveshje, janë shkelur;

c) Agjencia Ekzekutuese e Projektit nuk mund të provojë se shumatat e disbursuara janë përdorur të gjitha për qëllimin e caktuar dhe në përputhje me dokumentacionin e KIBP-së;

d) përmbushja e detyrimeve të KfW-së sipas kësaj Marrëveshjeje shkel ligjin e zbatueshëm;

e) disbursimet për KfW-në pezullohen plotësisht ose pjesërisht bazuar në dokumentacionin e KIBP-së, duke përfshirë rastin kur rrethana të jashtëzakonshme e kërkojnë këtë, veçanërisht: i. kur është miratuar një vendim përkatës i BE-së ose KIBP-së që identifikon një shkelje të të drejtave të njeriut; dhe/ose ii. në raste të tilla si kriza që sjell një ndryshim të politikës së BE-së ose KIBP-së;

f) dokumentacioni i KIBP-së pushon së qeni i vlefshëm, efektiv, i zbatueshëm ose pezullohet ose përfundon, ose KIBP-ja ose përfaqësuesit e KIBP-së (BEI dhe BERZH) ose Komisioni Evropian lëshojnë një urdhër rikuperimi ndaj KfW-së;

g) ka ndodhur një arsye për ndërprerje, ose ka ndodhur një incident që do të bëhej shkak për ndërprerje me anë të njoftimit ose skadimit ose konstatimit, ose përmbushjes së një kushti (arsye e mundshme për ndërprerje) sipas Marrëveshjes së Parë të Huas ose Marrëveshjes së Dytë të Huas, ose është bërë e paligjshme që KfW-ja të kryejë ndonjë nga detyrimet e saj siç parashikohet nga Marrëveshja e Parë e Huas ose Marrëveshja e Dytë e Huas ose të financojë ose mbajë ndonjë nga huat sipas saj;

h) ka ndodhur një arsye për pezullimin ose refuzimin e disbursimit sipas Marrëveshjes së Parë të Grantit KIBP-së, Marrëveshjes së Parë Shoqëruese të Grantit ose Marrëveshjes së Dytë Shoqëruese të Grantit;

i) lindin rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë ndjeshëm zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Projektit; ose



j) Marrëveshja e Dytë e Huas ka hyrë në fuqi dhe ka filluar të zbatohet.

4.2. Nëse ndonjë prej situatave të specifikuara në nenin 4.1 (a) deri i) ka ndodhur dhe nuk është eliminuar brenda një periudhe të përcaktuar nga KfW-ja, e cila, megjithatë, duhet të jetë të paktën 30 ditë, KfW-ja:

a) në rastin e përcaktuar në nenin 4.1 (a), (b), (d), (e), (g), (h) ose (i) mund të kërkojë shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara;

b) në rastin e specifikuar në nenin 4.1 c), mund të kërkojë shlyerje të menjëhershme të atyre shumave që Agjencia Ekzekutuese e Projektit nuk mund të provojë se janë përdorur për qëllimin e caktuar dhe në përputhje me dokumentacionin e KIBP-së;

c) në rastin e specifikuar në nenin 4.1 (f), kërkon shlyerjen e menjëhershme të të gjitha shumave të disbursuara të cilat Agjencia Ekzekutuese e Projektit nuk i ka përdorur ose transferuar ende me mirëbesim një përfituesi legjitim në një mënyrë ligjrisht të detyrueshme. Nga ana tjetër, Agjencia Ekzekutuese e Projektit do të përfshijë në të gjitha kontratat që do të financohen ose mbështeten me fonde nga Granti, dispozita që garantojnë se fondet që ende nuk janë përdorur ose shpenzuar me mirëbesim për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, do të transferohen përsëri në Agjencinë Ekzekutuese të Projektit për kthim në KfW dhe së fundi në KIBP.

4.3 Komisioni Evropian dhe përfaqësuesit e KIBP-së do të kenë të drejtë të marrin, sipas të drejtës së tyre, masa të drejtpërdrejta rikuperimi ndaj Përfituesit, në përputhje me ligjet në fuqi të Bashkimit Evropian dhe rregulloret e KIBP-së, çka pranohet me anë të kësaj nga Përfituesi.

### 5. Kostot dhe detyrimet publike

Përfituesi mbulon të gjitha taksat dhe detyrimet e tjera publike që bëhen jashtë Republikës Federale të Gjermanisë, për lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, si dhe të gjitha kostot e transferimit dhe konvertimit që lindin në lidhje me disbursimin e Grantit.

### 6. Deklaratat Kontraktuale dhe autoriteti i përfaqësimit

6.1 Ministri i Financave dhe personat e caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar me anë të nënshkrimeve model të vërtetuara prej tij ose saj do të përfaqësojnë Përfituesin në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Agjencisë Ekzekutuese të Projektit dhe

personat e caktuar prej tij ose saj për KfW-në dhe të autorizuar nga nënshkrime model të vërtetuara prej tij ose saj, do të përfaqësojnë Agjencinë Ekzekutuese të Projektit në ekzekutimin e kësaj Marrëveshjeje. Autoriteti i përfaqësimit nuk do të skadojë deri në marrjen nga ana e KfW-së, të revokimit të tij të shprehur nga përfaqësuesi i autorizuar në atë kohë.

6.2 Ndryshimet ose shtesat e kësaj Marrëveshjeje, si dhe njoftimet dhe deklaratat e lëshuara nga palët kontraktuese në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje, bëhen me shkrim. Çdo njoftim apo deklaratë e tillë konsiderohet e marrë sapo të ketë arritur në adresën e mëposhtme të palës kontraktuese përkatëse ose në atë adresë tjetër të palës kontraktuese përkatëse, siç i është njoftuar palës tjetër kontraktuese:

Për KfW- KfW  
në: Postfach 11 11 41  
60046 Frankfurt am Main  
Federal Republic of Germany (Republika  
Federale e Gjermanisë)  
Faks: +49 7431-2944

Për Ministria e Financave  
Përfituesin: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3  
1001 Tiranë, Shqipëri

Për Agjencinë Korporata Elektroenergjetike  
Ekzekutuese të Projektit: Shqiptare (KESH)  
Blloku "Vasil Shanto"  
1001 Tiranë, Shqipëri

6.3. Ndryshimet e kësaj Marrëveshjeje që cenojnë vetëm marrëdhëniet ligjore ndërmjet KfW-s dhe Përfituesit nuk kërkojnë pëlqimin e Agjencisë Ekzekutuese të Projektit. Ministri i Financave është i autorizuar të nënshkruajë çdo ndryshim i cili para nënshkrimit duhet të miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet në këtë Marrëveshje që ndikojnë vetëm në periudhën e disponueshmërisë (neni 3.2) nuk kërkojnë miratim paraprak nga Këshilli i Ministrave.

### 7. Projekti

#### 7.1 Agjencia Ekzekutuese e Projektit:

a) do të përgatisë, zbatojë, operojë dhe mirëmbajë Projektin në përputhje me praktikat e qëndrueshme financiare dhe inxhinierike, sipas standardeve mjedisore dhe sociale, dhe kryesisht në përputhje me konceptin e dakordësuar të Projektit ndërmjet Agjencisë Ekzekutuese të Projektit dhe KfW-së;

b) do t'i delegojë përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit të Projektit inxhinierëve konsulentë të





pavarur, të kualifikuar dhe zbatimin e Projektit firmave të kualifikuara;

c) do të jetë në përputhje në çdo kohë me dispozitat e prokurimit të përcaktuara në Marrëveshjen e Veçantë, duke përfshirë planin përkatës të prokurimit;

d) do të mbajë ose sigurojë mbajtjen e librave dhe regjistrave që specifikojnë qartë të gjitha kostot e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Projektin dhe që identifikojnë qartë mallrat dhe shërbimet e financuara nga ky Grant, në përputhje me standardet e pranura ndërkombëtarisht;

e) do t'u mundësojë përfaqësuesve të KfW-së, përfaqësuesve të KIBP-së, Komisionit Evropian, Zyrës Evropiane Kundër Mashtrimit ("OLAF"), Gjykatës Evropiane të Audituesve dhe ndonjë organi tjetër kompetent evropian në çdo kohë që të kontrollojnë këto libra dhe regjistra, si dhe çdo dokumentacion tjetër që lidhet me zbatimin e Projektit dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet lidhur me Projektin;

f) do t'i dorëzojë KfW-së çdo dhe të gjitha informacionet dhe raportet e tilla mbi Projektin dhe ecurinë e mëtejshme që mund të kërkojë KfW-ja ose KIBP-ja, duke përfshirë por pa u kufizuar në informacionin dhe raportet e kërkuara për përmbushjen e detyrimeve të raportimit të KIBP-së, në veçanti:

i. raportet vjetore të zbatimit, duke përfshirë një pjesë narrative dhe financiare; si dhe

ii. të dhëna përkatëse për përditësimet gjysmë-vjetore në Sistemin e Informacionit të Menaxhimit të KIBP-së;

7.2. Agjencia Ekzekutuese e Projektit dhe KfW-ja përcaktojnë hollësitë lidhur me nenin 7.1 dhe nenin 7.3 me një Marrëveshje të Veçantë.

7.3. Përfituesi dhe Agjencia Ekzekutuese e Projektit:

a) do të sigurojnë financimin e plotë të Projektit dhe, me kërkesë, i japin KfW-së dëshmi që tregojnë se janë mbuluar kostot e papaguara nga ky Grant;

b) me porosi të tyre do të informojnë menjëherë KfW-në për çdo dhe të gjitha rrethanat që përjashtojnë, vonojnë ose rrezikojnë ndjeshëm zbatimin, funksionimin ose qëllimin e Projektit;

c) do të marrin masa efektive dhe proporcionale për të zbutur rrezikun e shfaqjes së Praktikave të Ndalura (siç përcaktohet më poshtë) ose ndonjë aktiviteti tjetër të paligjshëm në lidhje me përdorimin e Grantit dhe/ose zbatimin e Projektit. Të gjitha

rastet e Praktikave të Ndalura që lidhen me Grantin dhe /ose zbatimin e Projektit, si dhe masat në lidhje me to, të marra nga Përfituesi dhe/ose Agjencia Ekzekutuese e Projektit, duhet t'i raportohen menjëherë KfW-së. Përfituesi dhe/ose Agjencia Ekzekutuese e Projektit, do të ndërmarrin veprime për të ndërprerë kontratat me kontraktuesit, në lidhje me të cilat është përcaktuar që kontraktues të tillë kanë qenë të përfshirë në praktika të tilla të ndaluara mbi zbatimin e Projektit dhe të marrë masat e duhura për të rimarrë Grantin ose pjesën e tij e cila është keqpërdorur.

"Praktikat e Ndalura": nënkupton një ose më shumë nga sa vijon:

i. praktikë shtrënguese siç përcaktohet në Shtojcën 1a (Angazhimet e Pajtueshmërisë së Përfituesit);

ii. praktikë e fshehtë siç përcaktohet në Shtojcën 1a (Angazhimet e Pajtueshmërisë së Përfituesit);

iii. praktikë korruptive siç përcaktohet në Shtojcën 1a (Angazhimet e Pajtueshmërisë së Përfituesit);

iv. praktikë mashtruese siç përcaktohet në Shtojcën 1a (Angazhimet e Pajtueshmërisë së Përfituesit); dhe

v. vjedhje që nënkupton keqpërdorim të pasurisë që i përket një pale tjetër.

d) do t'i mundësojnë Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve, KfW-së ose ndonjë përfaqësuesi të autorizuar të KIBP-së që të kryejnë rishikime analizuese dhe kontrole në vend për përdorimin e Grantit (duke përfshirë procedurat për dhënien e kontratave të financuara nga Granti) mbi bazën e dokumenteve mbështetëse të kontabilitetit dhe ndonjë dokumenti tjetër të lidhur me financimin e Projektit;

e) do t'i mundësojnë OLAF-it që të kryejë hetimet, duke përfshirë kontrollet në vend, në përputhje me dispozitat e përcaktuara nga legjislacioni i BE-së për mbrojtjen e interesave financiare të BE-së nga mashtrimi, korrupsioni dhe çdo aktivitet tjetër i paligjshëm dhe, kur është e zbatueshme, çdo marrëveshje bashkëpunimi administrative kundër mashtrimit, të lidhur ndërmjet OLAF-it dhe organeve të KfW-së;

f) secili do të ndërmarrë t'i ofrojë përfaqësuesve të KIBP-së, Komisionit Evropian, OLAF-it dhe Gjykatës Evropiane të Audituesve dhe agjentëve të tyre të autorizuar, sipas kërkesës, informacion dhe akses në çdo dokument dhe të dhëna të



kompjuterizuara në lidhje me menaxhimin teknik dhe financiar të operacioneve të financuara në bazë të kësaj Marrëveshjeje, si dhe t'u japë atyre akses në vende dhe mjedise ku kryhen operacione të tilla. Dokumentet dhe të dhënat e kompjuterizuara mund të përfshijnë informacione që Agjencia Ekzekutuese e Projektit i konsideron konfidenciale, në përputhje me rregullat dhe rregulloret e tyre të përcaktuara ose siç rregullohen nga marrëveshja kontraktuale. Një informacion i tillë, pasi i jepet Komisionit Evropian, OLAF-it, Gjykatës Evropiane të Audituesve, ose ndonjë përfaqësuesi tjetër të autorizuar të KIBP-së, do të trajtohet në përputhje me rregullat dhe legjislacionin e konfidencialitetit të BE-së. Dokumentet duhet të jenë të aksesueshme dhe të paraqiten në atë mënyrë që lejojnë kryerjen e kontroleve, ndërsa Përfituesi dhe Agjencia Ekzekutuese e Projektit janë të detyruar ligjërisht të informojnë Komisionin Evropian, OLAF-in ose Gjykatën Evropiane të Audituesve për vendndodhjen e saktë ku mbahen. Kur është e nevojshme, palët mund të bien dakord të dërgojnë kopje të këtyre dokumenteve për rishikime analizuese;

g) do të informojnë KfW-në, Komisionin Evropian ose përfaqësuesit e KIBP-së nëse në lidhje me zbatimin e Projektit, ndonjë prej tyre ka konstatuar një situatë përjashtimi të referuar më poshtë ose nëse ka zbuluar një mashtrim dhe /ose parregullsi. Komisioni Evropian do ta përdorë këtë informacion për qëllimet e sistemit të zbulimit dhe përjashtimit të hershëm. Përfituesi dhe AEP-i do të informojnë KfW-në, Komisionin Evropian ose përfaqësuesit e KIBP-së kur secili prej tyre vihet në dijeni se informacioni i transmetuar duhet të korrigjohet, përditësohet ose hiqet. Përfituesi dhe AEP-i sigurojnë që subjekti përkatës të informohet se të dhënat e tij janë transmetuar te KfW-ja, Komisioni Evropian ose përfaqësuesit e KIBP-së dhe mund të përfshihen në sistemin e zbulimit dhe përjashtimit të hershëm dhe të publikohen në faqen e internetit të Komisionit Evropian. Ky nen 7.3 l) zbatohet nëse Përfituesi dhe AEP-ja vihen në dijeni se këto subjekte:

i. ose persona që kanë kompetenca përfaqësimi, vendimmarrjeje ose kontrolli mbi to, kanë qenë objekt i një vendimi të formës së prerë ose i një vendimi administrativ të formës së prerë për mashtrim, korrupsion, përfshirje në një organizatë kriminale, pastrim parash, vepra penale të lidhura

me terrorizmin, punë të fëmijëve ose trafikim të qenieve njerëzore;

ii. ose persona që kanë kompetenca përfaqësimi, vendimmarrjeje ose kontrolli mbi to kanë qenë objekt i një vendimi përfundimtar ose vendimi administrativ përfundimtar për një parregullsi që ndikon në interesin financiar të BE-së;

iii. janë fajtorë për keqinterpretim në dhënien e informacionit të kërkuar si kusht për pjesëmarrje në procedurë ose nëse nuk e japin këtë informacion;

iv. kanë qenë objekt i një vendimi përfundimtar ose vendimi përfundimtar administrativ që përcakton se subjektet kanë krijuar një subjekt nën një juridiksion të ndryshëm me qëllim që të anashkalojnë detyrimet fiskale, sociale ose ndonjë detyrim tjetër ligjor me zbatim të detyrueshëm në juridiksionin e zyrës së tyre të regjistruar, administratës qendrore ose vendit kryesor të biznesit; ose

v. janë krijuar me qëllimin e përshkruar në pikën iv. më sipër, siç është përcaktuar nga një vendim përfundimtar ose vendim përfundimtar administrativ;

h) do të japin, në lidhje me pronësinë, titullin, të drejtat e pronësisë industriale dhe intelektuale në rezultatet e Projektit dhe në raportet, dokumentet dhe materialet e tjera në lidhje me të, dhe do të veprojnë për të siguruar që çdo palë e tretë e interesuar t'i japë: i. KfW-së; dhe/ose ii. përfaqësuesve të KIBP-së (BERZH-i dhe BEI-ja) ose, nëse është e zbatueshme, kontribuesve në KIBP; ose iii. çdo palë tjetër të tretë, siç mund të jetë rënë dakord në Marrëveshjen e Veçantë: a) të drejtat e pronësisë, titullit, të pronësisë industriale dhe intelektuale në rezultatet e Projektit; ose b) të drejtën për të përdorur pa pagesë të gjitha rezultatet, raportet, dokumentet dhe materialet e tilla që rrjedhin nga zbatimi i Projektit, cilado qoftë forma e tyre, të cilat i nënshtrohen të drejtave të pronësisë industriale ose intelektuale, me kusht që kjo të mos shkelë të drejtat ekzistuese të pronësisë industriale dhe intelektuale;

i) do të promovojnë respektimin e të drejtave të njeriut dhe zbatimin e legjislacionit mjedisor në fuqi, duke përfshirë marrëveshjet shumëpalëshe mjedisore, si dhe standardet thelbësore të punës të pranuar ndërkombëtarisht; dhe

j) do të pranojnë dhe bëjnë publik faktin se aktivitete të tilla financohen me burimet e KIBP-së dhe do të garantojnë zbatimin e udhëzimeve të

KIBP-së për komunikim dhe vizibilitet të bashkëlidhura si një Shtojcë e Marrëveshjes së Veçantë të përmendur në vetë Nenin 7.2 dhe do të sigurojnë që palët e saj të drejtpërdrejta kontraktuale gjithashtu të jenë në përputhje me këto udhëzime komunikimi dhe vizibiliteti dhe që ato gjithashtu kuroherë ta pranojnë dhe bëjnë publik faktin se veprimtari të tilla financohen me burimet e KIBP-së.

7.4 Përfituesi, nëpërmjet MIE-s, ndihmon Agjencinë Ekzekutuese të Projektit në përputhje me praktikën e qëndrueshme inxhinierike dhe financiare në zbatimin e Projektit dhe përmbushjen e detyrimeve të Agjencisë Ekzekutuese të Projektit sipas kësaj Marrëveshjeje dhe në veçanti, do t'i japë Agjencisë Ekzekutuese të Projektit të gjitha lejet e nevojshme për zbatimin e Projektit.

7.5 Përfituesi, nëpërmjet MIE-s, dhe /ose Agjencia Ekzekutuese e Projektit mund të marrin parasysh, sipas rastit dhe me përgjegjësinë e vet, informacionin e përfshirë në Sistemin e Zbulimit të Hershëm dhe Përrjashtimit, kur jep kontrata. Aksesin në informacion mund të garantohet nëpërmjet personave të autorizuar ose konsultimit me Komisionin Evropian.

### **8. Publikimi dhe transferimi i informacionit të lidhur me Projektin**

8.1 Për të qenë në përputhje me parimet e pranuar në nivel ndërkombëtar për transparencë dhe efikasitet maksimal në bashkëpunimin për zhvillim, KfW-ja publikon informacionin e përzgjedhur (duke përfshirë rezultatet e kategorizimit dhe vlerësimit mjedisor dhe shoqëror, si dhe raportet e vlerësimit *ex post* (Pas Projektit)) për Projektin dhe mënyrën sesi është financuar gjatë negociatave parakontraktuale, ndërsa zbatohen marrëveshjet lidhur me Projektin dhe me fazën paskontraktuale (në vijim e referuar si “Periudha e Plotë”).

Informacioni publikohet rregullisht në faqen e internetit të Bankës për Zhvillim të KfW-së <http://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/>.

Publikimi i informacionit (ose nga KfW-ja apo palët e treta në përputhje me Nenin 8.3 më poshtë, në lidhje me Projektin dhe mënyrën e financimit të tij nuk përfshin asnjë dokumentacion kontraktual ose informacion të hollësishëm sensitiv financiar ose biznesi në lidhje me palët e përfshira në Projekt ose financimin e tij, të tilla si:

a) informacion për të dhëna të brendshme financiare;

b) strategji biznesi;

c) udhëzime dhe raportet e brendshme të korporatës;

d) të dhënat personale të personave fizikë;

e) vlerësimin e brendshëm të KfW-së për gjendjen financiare të palëve.

8.2 KfW-ja ndan informacione të përzgjedhura mbi Projektin dhe mënyrën sesi është financuar gjatë Periudhës së Plotë, veçanërisht për të garantuar transparencë dhe efikasitet me subjektet e poshtëshënuara:

a) filialet e KfW-së;

b) Republikën Federale të Gjermanisë dhe organet e saj kompetente, autoritetet, institucionet, agjencitë ose subjektet;

c) organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin gjerman dypalësh për zhvillim, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;

d) organizata ndërkombëtare të përfshira në mbledhjen e të dhënave statistikore dhe anëtarëve të tyre, në veçanti, Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD) dhe anëtarët e saj;

e) palët e Kushteve të Përgjithshme të Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor (“FPEBP”), të datës 7 nëntor 2006;

f) institucionet që administrojnë FPEBP-në dhe kontribuesit e KIBP-së; dhe

g) Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij;

8.3 Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacionin e përzgjedhur për Projektin dhe mënyrën sesi financohet gjatë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme që publikojnë seksionet e lidhura me qëllimin:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllimet e Nismës së Transparencës të Ndihmës Ndërkombëtare

([http://www.bmz.de/de/ëas\\_ëir\\_machen/ëege/transparenz-fuer-mehr\\_ëirksamkeit/index.html](http://www.bmz.de/de/ëas_ëir_machen/ëege/transparenz-fuer-mehr_ëirksamkeit/index.html));

b) Tregu & Investimi Gjerman (GTAI) për qëllimet e informacionit për tregun (<http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO>);

c) OECD-ja për qëllimet e raportimit të flukseve financiare në kuadrin e bashkëpunimit për zhvillim (<http://stats.oecd.org/>);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval) për qëllimet e vlerësimit të përgjithshëm të bashkëpunimit gjerman për zhvillim, për të



garantuar transparencë dhe efikasitet (<http://www.deval.org/de/>);

e) palët e Kushteve të Përgjithshme të Fondit të Përbashkët Evropian të Ballkanit Perëndimor (“FPEBP”), të datës 7 nëntor 2006;

f) institucionet që administrojnë FPEBP-në dhe kontribuesit e KIBP-së; dhe

g) Bashkimin Evropian dhe institucionet e tij;

8.4. KfW-ja, gjithashtu, rezervon të drejtën për të transferuar (duke përfshirë edhe për qëllimet e publikimit) informacion në lidhje me Projektin dhe mënyrën se si financohet ai gjatë Periudhës së Plotë ndaj palëve të treta, me qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshëm.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja tek palët e treta, nëse interesat e ligjshëm të Përfituesit ose të Agjencisë Zbatuese të Projektit në informacionin që nuk transferohet i tejkalojnë interesat e KfW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshëm të Përfituesit, në veçanti, përfshijnë konfidencialitetin e informacioneve sensitive të përmendura në Nenin 8.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion te palët e treta, nëse është e nevojshme për shkak të kërkesave ligjore ose rregullatore ose për të pohuar ose mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë apo procedime administrative.

### 9. Dispozita të Ndryshme

9.1. Përfituesi ndërmerr të përbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në Shtojcën 1a (Angazhimet e Pajtuëshmërisë së Përfituesit). Agjencia Ekzekutuese e Projektit ndërmerr të përbushë në çdo kohë detyrimet e përcaktuara në Shtojcën 1 b (Angazhimet e Pajtuëshmërisë së Agjencisë Ekzekutuese të Projektit).

9.2. Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje është e pavlefshme, të gjitha dispozitat e tjera do të mbeten të pacenuara në lidhje me të. Çdo boshllëk ligjor që mund të rrjedhë prej saj plotësohet me një dispozitë në pajtim me qëllimin e kësaj Marrëveshjeje.

9.3. Përfituesi dhe Agjencia Ekzekutuese e Projektit nuk mund të delegojnë ose transferojnë, rendojnë me peng ose hipotekë ndonjë pretendim nga kjo Marrëveshje.

9.4. Kjo Marrëveshje rregullohet nga legjislacioni i Republikës Federale të Gjermanisë. Vendi i përbushjes është Frankfurt am Main.

9.5. Marrëdhëniet juridike të vendosura nga kjo Marrëveshje ndërmjet KfW-së, Përfituesit dhe Agjencisë Ekzekutuese të Projektit do të përfundojnë me mbarimin e kohëzgjatjes së dobishme të Projektit, por jo më vonë se 15 vjet pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

9.6. Kjo Marrëveshje nuk do të hyjë në fuqi derisa KfW-ja të ketë marrë njoftimin me shkrim të Përfituesit se procedurat e brendshme ligjore janë përfunduar (data e marrjes në KfW). KfW-ja informon Përfituesin me shkrim për datën e marrjes së këtij njoftimi.

Nëse Marrëveshja nuk ka hyrë në fuqi dhe efekt pas gjashtë muajve pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, ose në ndonjë afat tjetër që mund të bihet dakord nga KfW-ja, kjo e fundit, nga ajo datë deri në datën e hyrjes në fuqi, do të ketë të drejtë të tërhiqet në mënyrë të njëanshme nga Marrëveshja dhe në këtë mënyrë të ndërpresë procesin e saj të mbetur pezull, duke i dërguar njoftim me shkrim Përfituesit.

Hartuar në 3 (tri) origjinale në gjuhën angleze.

**TIRANË, më 15.12.2025**

[Vendi, data]

**KfW**

/Nënshkrimi/

[Nënshkrimi]

Emri: Matthias Grüninger

Pozicioni: Drejtor Kryesor

Portofoli

/Nënshkrimi/

[Nënshkrimi]

Emri: Mara Drochner

Pozicioni: Drejtore

Zyre

[Vendi, data]

**Republika e Shqipërisë  
e përfaqësuar nga Ministria e  
Financave**

/Nënshkrimi/

Emri: PETRIT MALAJ

Pozicioni: MINISTËR I

FINANCIVE

**Korporata Elektroenergjetike  
Shqiptare (KESH)**

/Nënshkrimi/

[Nënshkrimi]

Emri: Ermal Nuri

Pozicioni: Drejtor TD

Shtojcat

1a Angazhimet e

Pajtuëshmërisë së Përfituesit

1b Angazhimet e

Pajtuëshmërisë së Agjencisë

Ekzekutuese të Projektit



## SHTOJCA 1a

ANGAZHIMET E PAJTUESHMËRISË SË  
PËRFTUESIT

## 1. PËRKUFIZIME

**“Praktikë shtrënguese”** është pengimi ose dëmtimi, ose kërcënimi për të penguar ose dëmtuar drejtpërsëdrejti ose në mënyrë të tërthortë ndonjë person ose pronën e ndonjë personi, me qëllim ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një personi.

**“Praktikë e marrëveshjes së fshehtë”** është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, përfshirë ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një personi tjetër.

**“Praktikë korruptive”** është premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja mbi, marrja, pranimi ose kërkesa e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazh i padrejtë i çdo natyre, për dikë ose nga cilido, me qëllim që të ndikojë në veprimet e dikujt ose të bëjë që një person të mos veprojë.

**“Praktikë mashtrimi”** është çdo veprim ose mungesë veprimi, duke përfshirë një keqinterpretim që me qëllim ose nga pakujdesia çorienton ose synon të çorientojë një palë në kuadrin e përfutimit të një përfutimi financiar ose shmangies së një detyrimi;

**“Listë e BE-së”**, lista e BE-së e juridiksioneve tatimore jobashkëpunuese, e përcaktuar dhe përditësuar herë pas here nga Komisioni i BE-së, duke përfshirë Shtojcën I dhe Shtojcën II përkatëse (për më shumë hollësi, ju lutem vizitoni <https://www.consilium.europa.eu/de/policies/eul-ist-of-non-cooperative-jurisdictions>). Shtojca I përfshin juridiksione që klasifikohen si jobashkëpunuese dhe shtojca II përfshin juridiksione të mëtejshme (“Juridiksionet e shtojcës II” ose “Juridiksionet e Angazhuara”) që kanë marrë angazhime të mjaftueshme për të trajtuar mangësitë e tyre të identifikuara dhe si të tilla nuk janë konsideruar jobashkëpunuese për momentin.

**“Praktikë penguese”**: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja me qëllim e materialit të provave për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar në akuzat për një praktikë korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcënimi, ngacmimi apo frikësimi i çdo

pale për ta parandaluar atë nga zbulimi i njohurive të saj për çështje që lidhen me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii. veprime, me qëllimin për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KFW-së në informacionin e kërkuar me kontratë në lidhje me hetimin zyrtar në akuzat e një praktike korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

**“Person”**, çdo person fizik, juridik, partneritet ose shoqatë e pathemeluar.

**“Praktikë e sanksionueshme”**, secila nga praktikat shtrënguese, të marrëveshjes së fshehtë, korruptive, mashtruese ose penguese (siç përkufizohen dhe këta terma këtu) që është: i. e paligjshme sipas ligjit gjerman ose atij të zbatueshëm; dhe ii. që ka, ose mund të ketë ndikim material ligjor ose reputacional të Marrëveshja ndërmjet Përfutuesit dhe KFW-së ose në zbatimin e saj.

**“Sanksionet”**, sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot ose masat kufizuese ekonomike, financiare ose tregtare (duke përfshirë mallrat, teknologjitë ose shërbimet dhe ndihmën financiare në lidhje me to), të administruara, miratuara ose zbatuara nga ndonjë Organ Sanksionues.

**“Organ sanksionues”**, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

**“Listë e sanksioneve”**, çdo listë e personave, grupeve ose subjekteve të caktuar posaçërisht që janë objekt i Sanksioneve, siç miratohet nga çdo Organ Sanksionues.

**“Praktikë e Shmangies së Tatimeve”**, çdo akt i shfrytëzimit të teknikalliteteve të një sistemi tatimor dhe/ose juridiksioni ose i mospërputhjeve midis dy ose më shumë sistemeve dhe/ose juridiksioneve tatimore pa ndonjë arsye bindëse biznesi, përveç qëllimit të vetëm të reduktimit të detyrimit tatimor.

## 2. DHËNIA E INFORMACIONIT

Përfutuesi, nëpërmjet MIE-s:

a) i vendos menjëherë në dispozicion KFW-së, me kërkesë të KFW-së, të gjithë informacionet përkatëse me “njoh klientin tënd” ose informacione të ngjashme në lidhje me Përfutuesin;

b) i paraqet menjëherë KFW-së, me kërkesë të KFW-së, të gjitha informacionet dhe dokumentet lidhur me Projektin, që ka Përfutuesi dhe (nën)kontraktuesit e tij dhe palët e tjera të lidhura, të cilat KFW-ja i kërkon për përmbushjen e detyrimeve të saj për parandalimin e Praktikave të Sanksionueshme, pastrimin e parave dhe/ose



financimin e terrorizmit, si dhe për monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të punës me Përfituesin që nevojitet për këtë qëllim;

c) informon menjëherë KFW-në dhe me nismën e vet, sapo merr dijeni ose ka dyshime për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash dhe/ose financim terrorizmi që lidhet me Projektin;

d) i jep KFW-së të gjithë informacionin dhe të dhëna mbi Projektin dhe ecurinë e mëtejshme që KFW-ja mund të kërkojë për qëllimet e kësaj shtojce; dhe

e) i jep mundësinë KFW-së dhe agjentëve të tij të inspektojnë kurdoherë të gjithë dokumentacionin e lidhur me Projektin që ka Përfituesi dhe (nën) kontraktuesit e tij dhe palët të tjera të lidhura dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet përkatëse për qëllimet e kësaj shtojce;

f) Informon KFW-në, menjëherë dhe me nismën e vet, në rast se Përfituesi synon të ndajë fondet e ofruara nga KFW-ja për (nën) kontraktuesin dhe/ose palë të tjera të lidhura, të cilët ndodhen dhe/ose janë të regjistruar në çdo vend të listuar në juridiksione jo bashkëpunuese si në Shtojcën I të Listës së BE-së; dhe

g) informon KFW-në, menjëherë dhe me nismën e vet, sapo merr dijeni ose të dyshojë për ndonjë Praktikë të Shmangies së Tatimeve që lidhet me Projektin.

### 3. PËRFAQËSIMI DHE GARANCIA

3.1. Në lidhje me ligjin gjerman ose ligjin e vendit të Përfituesit, Përfituesi deklaron dhe garanton se asnjë nga Personat që vepron në lidhje me Projektin në emër të Përfituesit nuk ka kryer ose nuk është i përfshirë në ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash, financim të terrorizmit ose ndonjë Praktikë të Shmangies së Taksave.

3.2. Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen bëhen për herë të parë nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje. Ato do të duhet të përsëriten në çdo tërheqje të Huas dhe në çdo datë pagese të interesit, në çdo rast referuar rrethanave mbizotëruese të asaj date.

### 4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Përfituesi merr përsipër, sapo ai ose KFW-ja merr dijeni ose ka dyshime për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash, financim terrorizmi ose praktikë e shmangies së tatimeve, të bashkëpunojë plotësisht me KFW-në dhe agjentët e tij për të përcaktuar nëse ka ndodhur një incident i tillë pajtueshmërie. Në veçanti, Përfituesi i përgjigjet

menjëherë dhe me hollësitë e pranueshme çdo njoftimi nga KFW-ja dhe dorëzon dokumentet mbështetëse për çdo përgjigje ndaj kërkesave të KFW-së.

### 5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Përfituesi merr përsipër:

a) të sigurojë që në lidhje me Projektin aktivitetet e tij nuk do të sjellin ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash ose financim të terrorizmit;

b) të mos hyjë në asnjë transaksion ose të mos angazhohet drejtpërdrejt ose në mënyrë të tërthortë në ndonjë aktivitet tjetër në lidhje me Projektin që do të përbënte shkelje të Sanksioneve; dhe

c) të mos ndajë fonde të ofruara nga KFW-ja për asnjë Person të vendosur dhe/ose të regjistruar në ndonjë juridiksion të mbajtur në Shtojcën I të Listës së BE-së pa pëlqimin paraprak të KFW-së dhe të mos angazhohet në asnjë aktivitet tjetër që do të përbënte një Praktikë të Shmangies së Tatimeve.

SHTOJCA 1b

## ANGAZHIMET E PAJTUESHMËRISË SË AGJENCISË EKZEKUTUESE TË PROJEKTTIT

### 1. PËRKUFIZIME

**“Praktikë shtrënguese”** është pengimi ose dëmtimi, ose kërcënimi për të penguar ose dëmtuar drejtpërsëdrejti ose në mënyrë të tërthortë çdo person ose pronën e çdo personi, me qëllim ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një personi.

**“Praktikë e marrëveshjes së fshehtë”** është një marrëveshje midis dy ose më shumë personave, me qëllim arritjen e një synimi të papërshtatshëm, përfshirë ndikimin e papërshtatshëm të veprimeve të një personi tjetër.

**“Praktikë korruptive”** është premtimi, ofrimi, dhënia, kryerja, këmbëngulja mbi, marrja, pranimi ose kërkesa e drejtpërdrejtë ose e tërthortë e ndonjë pagese të jashtëligjshme ose avantazh i padrejtë i çdo natyre, për dikë ose nga cildo, me qëllim që të ndikojë në veprimet e dikujt ose të marrë masa që një person të mos veprojë;

**“Kategoritë e përcaktuara të shkeljeve”**, kategoritë e mëposhtme të shkeljeve të përcaktuara nga Rekomandimet FATF-së dhe shënimet përkatëse interpretuese: pjesëmarrja në grup të



organizuar kriminal dhe shantazhi: terrorizmi, duke përfshirë financimin e terrorizmit; trafikimin e qenieve njerëzore dhe kontrabandimin e njerëzve; shfrytëzimin seksual, përfshirë shfrytëzimin seksual të fëmijëve, trafikimin e jashtëligjshëm të substancave narkotike dhe psikotrope; trafikimin e jashtëligjshëm të armëve; trafikimin e jashtëligjshëm të mallrave të vjedhura dhe të tjera; korrupsionin dhe mitmarrijen; mashtrimin; falsifikimin e parave; falsifikimin dhe piraterinë e produkteve; krimin mjedisor; vrasjen, lëndimin e rëndë trupor; rrëmbimin, mbajtjen e jashtëligjshme dhe pengmarrijen; vjedhjen ose grabitjen; kontrabandimin (duke përfshirë taksat dhe detyrimet tatimore dhe të akcizës); krimet tatimore (në lidhje me taksat direkte dhe indirekte); shantazhin; falsifikimin; piraterinë; tregtinë e brendshme dhe manipulimin e tregut.

**“Listë e BE-së”**, lista e BE-së e juridiksioneve tatimore jobashkëpunuese, siç përcaktohet dhe përditësohet herë pas here nga Komisioni i BE-së, duke përfshirë Shtojcën I dhe Shtojcën II përkatëse (për më shumë hollësi, ju lutem vizitoni <https://www.consilium.europa.eu/de/policies/eul-ist-of-non-cooperative-jurisdictions>). Shtojca I përfshin juridiksione që klasifikohen si jobashkëpunuese dhe shtojca II përfshin juridiksione të mëtejshme (“Juridiksionet e shtojcës II” ose “Juridiksionet e Angazhuara”) që kanë marrë angazhime të mjaftueshme për të trajtuar mangësitë e tyre të identifikuara dhe si të tilla nuk janë konsideruar si jobashkëpunuese për momentin.

**“Rekomandimet e FATF-it”**, rekomandime të tilla të përkufizuara herë pas here nga Grupi i Posaçëm i Veprimit Financiar (FATF). FATF-i është organi ndërqeveritar që synon të zhvillojë dhe nxisë politikat kombëtare dhe ndërkombëtare për luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

**“Praktikë mashtrimi”**, është çdo veprim ose mosveprim, duke përfshirë një keqinterpretim që me qëllim ose nga pakujdesia çorienton ose synon të çorientojë një palë në kuadrin e përfuturit të një përfitimi financiar ose shmangies së një detyrimi;

**“Natyrë e jashtëligjshme”**, është origjina e fondeve të marra nëpërmjet:

- a) ndonjë shkeljeje të renditur në Kategoritë e përcaktuara të shkeljeve;
- b) ndonjëpraktike korruptive;
- c) ndonjë praktike mashtrimi; ose

d) pastrimit të parave.

**“Praktikë penguese”**: i. shkatërrimi, falsifikimi, ndryshimi ose fshehja, me qëllim të materialit të provave për hetimin ose dhënia e deklaratave të rreme hetuesve, në mënyrë që të pengohet materialisht një hetim zyrtar në akuzat për një praktikë korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë, ose kërcënim, ngacmimi apo frikësimi i ndonjë pale për ta penguar nga zbulimi i njohurive të saj për çështjet e lidhura me hetimin apo ndjekjen e hetimit; ose ii. veprime, me qëllimin për të penguar materialisht ushtrimin e aksesit të KFW-së në informacionin e kërkuar me kontratë në lidhje me hetimin zyrtar në akuzat e një praktike korruptive, mashtruese, shtrënguese ose të fshehtë.

**“Person”**, çdo person fizik, juridik, partneritet ose shoqatë e pathemeluar.

**“Praktikë e sanksionueshme”**, secila nga praktikat shtrënguese, të marrëveshjes së fshehtë, korruptive, mashtruese ose penguese (siç përkufizohen dhe këta terma këtu) që është: i. e paligjshme sipas ligjit gjerman ose atij të zbatueshëm; dhe ii. që ka ose mund të ketë, efekt material ligjor ose reputacional të Marrëveshja ndërmjet Huamarrësit, Agjencisë së Ekzekutimit të Projektit dhe KFW-së ose në zbatimin e saj.

**“Sanksione”**, sanksionet, ligjet, rregulloret, embargot ose masat kufizuese ekonomike, financiare ose tregtare (duke përfshirë mallrat, teknologjitë ose shërbimet dhe ndihmën financiare në lidhje me to), të administruara, miratuara ose zbatuara nga ndonjë Organ Sanksionues.

**“Organ sanksionues”**, Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Bashkimi Evropian dhe Republika Federale e Gjermanisë.

**“Listë e sanksioneve”**, çdo listë e personave, grupeve ose subjekteve të caktuar posaçërisht që janë objekt i Sanksioneve, siç miratohet nga ndonjë Organ Sanksionues.

**“Praktikë e Shmangies së Tatimeve”**, çdo akt i shfrytëzimit të teknikalliteteve të një sistemi tatimor dhe/ose juridiksioni ose të mospërputhjeve midis dy ose më shumë sistemeve dhe/ose juridiksioneve tatimore pa ndonjë arsye bindëse biznesi, përveç qëllimit të vetëm të reduktimit të detyrimit tatimor.

## 2. DHËNIA E INFORMACIONIT

Agjencia Ekzekutuese e Projekti:

- a) i vendos menjëherë në dispozicion KFW-së, me kërkesë të KFW-së, të gjithë informacionet përkatëse me “njoh klientin tënd” ose informacione





të ngjashme në lidhje me Agjencinë Ekzekutuese të Projektit dhe secilin prej aksionerëve të saj (të drejtpërdrejtë dhe/ose të tërthortë), filialeve dhe/ose degëve të tjera (nëse ka), sipas kërkesës së KFW-së;

b) i paraqet menjëherë KFW-së, me kërkesë të KFW-së, të gjitha informacionet dhe dokumentet që lidhen me Projektin, të Agjencisë Ekzekutuese të Projektit dhe (nën) kontraktuesve dhe palëve të tjera të lidhura, për të cilat KFW-ja ka nevojë për të përmbushur detyrimet e saj për parandalimin e Praktikave të Sanksionueshme, pastrimin e parave dhe/ose financimin e terrorizmit, si dhe monitorimin e vazhdueshëm të marrëdhënieve të punës me Agjencinë Ekzekutuese të Projektit që nevojitet për këtë qëllim;

c) informon menjëherë dhe me nismën e vet, sapo merr dijeni ose ka dyshime, KFW-në për çdo Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash dhe/ose financim terrorizmi nga Agjencia Ekzekutuese e Projektit, anëtarët e organeve të saj menaxheriale ose organe të tjera drejtuese ose aksionerët e saj;

d) i jep KFW-së të gjithë informacionin dhe raportet mbi Projektin dhe ecurinë e tij të mëtejshme që KFW-ja mund të kërkojë për qëllimet e kësaj Shtojce;

e) i jep mundësinë KFW-së dhe agjentëve të tij të inspektojnë kurdoherë të gjithë dokumentacionin e lidhur me Projektin që ka Agjencia e Ekzekutimit të Projektit dhe (nën) kontraktuesit e saj dhe palët e tjera të lidhura, dhe të vizitojnë Projektin dhe të gjitha instalimet përkatëse për qëllimet e kësaj Shtojce;

f) informon KFW-në menjëherë dhe me nismën e vet, për çdo rast që ndodh dhe e bën ose mund ta bëjë Agjencinë Ekzekutuese të Projektit, anëtarët e organeve të saj menaxheriale ose organet e tjera qeverisëse ose aksionerët e saj, që të jenë ose të bëhen persona ose subjekte të bllokuara me emërim të posaçëm kombëtar të përfshirë në Listën e Sanksioneve.

g) informon KFW-në, menjëherë dhe me nismën e vet, në rast se Agjencia Ekzekutuese e Projektit synon të ndajë fondet e ofruara nga KfW-ja për (nën)kontraktues dhe/ose palë të tjera të lidhura, të cilat ndodhen dhe/ose janë të regjistruara në ndonjë vend të listuar në juridiksionet jo bashkëpunuese si në Shtojcën I të Listës së BE-së; dhe

h) informon KFW-në, menjëherë dhe me nismën e vet, sapo merr dijeni ose të dyshojë për ndonjë Praktikë të Shmangies së Tatimeve nga Agjencia Ekzekutuese e Projektit, çdo anëtar i organeve të saj drejtuese ose organeve të tjera drejtuese ose ndonjë prej aksionarëve të saj.

### 3. PËRFAQËSIMET DHE GARANCITË

3.1. Në përputhje me ligjin gjerman ose ligjin e vendit të themelimit të Agjencisë Ekzekutuese të Projektit, Agjencia Ekzekutuese e Projektit përfaqëson dhe garanton vërtetësinë dhe saktësinë e sa më poshtë:

a) Në lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Agjencia Ekzekutuese e Projektit vepron në emrin dhe për llogari të saj.

b) Në dijeni të informacioneve që ka dhe vetëm në lidhje me aksionerët që njeh Agjencia Ekzekutuese e Projektit sipas rregulloreve të zbatueshme mbi tregun e aksioneve, kapitali dhe fondet e investuara nga Agjencia Ekzekutuese e Projektit në këtë Projekt nuk janë të një natyre të paligjshme.

c) Askush nga Agjencia Ekzekutuese e Projektit, filialeve ose degëve të saj, ose persona të tjerë që veprojnë personalisht ose në emër të tyre nuk kanë kryer ose nuk janë angazhuar në Praktika të Sanksionueshme, pastrim parash ose financim terrorizmi.

d) Agjencia Ekzekutuese e Projektit nuk: i. ka hyrë në asnjë marrëdhënie pune me persona ose subjekte të bllokuara me emërim të posaçëm kombëtar të përfshirë në Listën e Sanksioneve; ose ii. nuk është angazhuar në asnjë veprimtari tjetër që do të përbënte shkelje të Sanksioneve.

e) Agjencia Ekzekutuese e Projektit nuk është dhe nuk ka qenë e angazhuar në asnjë aktivitet që do të përbënte një Praktikë të Shmangies së Tatimeve.

3.2 Përfaqësimi dhe garancia e përcaktuar në këtë nen bëhen për herë të parë nga ekzekutimi i kësaj Marrëveshjeje. Ato do të duhet të përsëriten në çdo tërheqje të Grantit dhe në çdo datë pagese interesi, në çdo rast referuar rrethanave mbizotëruese të asaj date.

### 4. SIPËRMARRJET POZITIVE

Agjencia Ekzekutuese e Projektit merr përsipër:

a) të respektojë plotësisht standardet kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në përputhje me rekomandimet e FATF-it dhe të zbatojë, ruajë, dhe nëse është e nevojshme, të përmirësojë standardet dhe udhëzimet e saj të





brendshme (duke përfshirë dhe jo vetëm, në lidhje me kujdesin e duhur ndaj klientit) të duhura për të shmangur Praktikën e Sanksionueshme, aktet e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit ose Praktikën për Shmangien e Tatimeve; dhe

b) sapo Agjencia Ekzekutuese e Projektit ose KfW-ja merr dijeni ose ka dyshime për ndonjë Praktikë të Sanksionueshme, pastrim parash, financim terrorizmi ose Praktikë për Shmangien e Tatimeve, të bashkëpunojë plotësisht me KfW-në dhe agjentët e tij për të përcaktuar nëse ka ndodhur një incident i tillë pajtueshmërie. Në veçanti, Agjencia Ekzekutuese e Projektit i përgjigjet menjëherë dhe me hollësitë e pranueshme çdo njoftimi nga KfW-ja dhe dorëzon dokumentet mbështetëse për çdo përgjigje ndaj kërkesave të KfW-së.

#### 5. SIPËRMARRJET NEGATIVE

Agjencia Ekzekutuese e Projektit merr përsipër:

a) të garantojë që kapitali dhe fondet e tjera që investon të mos jenë të një origjine të jashtëligjshme;

b) të garantojë që biznesi i saj nuk do të nxisë Praktika të Sanksionueshme, pastrimin e parave ose financimin e terrorizmit; dhe

c) nuk do të hyjë ose vijojë asnjë marrëdhënie pune me persona ose entitete të bllokuara me emërim të posaçëm kombëtar, të përfshirë në Listën e Sanksioneve, dhe nuk do të angazhohet në asnjë veprimtari tjetër që do të përbënte shkelje të Sanksioneve.

d) nuk do t'i ndajë fondet e dhëna nga KfW-ja asnjë Personi të vendosur dhe/ose të regjistruar në ndonjë juridiksion të mbajtur në shtojcën I të listës së BE-së pa pëlqimin paraprak të KfW-së dhe nuk do të angazhohet në ndonjë aktivitet tjetër që do të përbënte Praktikë të Shmangies së Tatimeve.





Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë  
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006



Çmimi 240 lekë